

ISSN 1127-8579

Pubblicato dal 04/02/2010

All'indirizzo <http://www.diritto.it/docs/28877-repubblica-del-kosovo-codice-di-diritto-penale>

Autori:

Repubblica del Kosovo: codice di diritto penale

KODI I PËRKOHSHËM PENAL I KOSOVËS*

* Ribotuar për arsye teknike.

Lista e korrigjimeve në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës: prill 2004

Në nenin 51, par. 1, fjala “caktohet” është zëvendësuar me “përfshihet”.

Në nenin 53, par. 2, pas fjalës “profesional” shtohet “nuk i kryen detyrimet themelore familjare, nuk pranon trajtimin e nevojshëm mjekësor apo rehabilitues apo nuk kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve të tij.”.

Në nenin 56, është shtuar një paragraf i ri si vijon: “Kur shqiptohet dënimi me kusht, gjykata mund të vendosë që dënimi me kusht të revokohet nëse kryerësi nuk i përmbahet ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik”.

Në nenin 193, par. 4, është fshirë fjala “1 ose”.

Në nenin 195, par. 4, është fshirë fjala “1 ose”.

Në nenin 196, par. 4, fjala “1 ose” është fshirë.

Në nenin 198, par. 5 fjala “pesëmbëdhjetë” është zëvendësuar me “njëzet” dhe fjalët “deri në tri” janë zëvendësuar me “deri në pesë”.

KODI I PËRKOHSHËM PENAL I KOSOVËS**Përmbajtja**

PJESA E PËRGJITHSHME.....	155
KAPITULLI I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	155
KAPITULLI II: VEPRAT PENALE DHE PËRGJEGJËSIA PENALE.....	156
KAPITULLI III: DËNIMET.....	164
KAPITULLI IV: VËREJTJA E GJYKATËS.....	180
KAPITULLI V: MASAT E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM.....	180
KAPITULLI VI: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR EKZEKUTIMIN E DËNIMEVE.....	181
KAPITULLI VII: KONFISKIMI I DOBISË PASURORE TË FITUAR ME ANË TË KRYERJES SË VEPRAVE PENALE.....	183
KAPITULLI VIII: REHABILITIMI DHE ZBULIMI I TË DHËNAVE NGA DOSJA PENALE.....	184
KAPITULLI IX: PARASHKRIMI.....	186
KAPITULLI X: AMNISTIA DHE FALJA.....	188
KAPITULLI XI: ZBATIMI I LIGJEVE PENALE TË KOSOVËS SIPAS VENDIT TË KRYERJES SË VEPRËS PENALE.....	189
KAPITULLI XII: DOMETHËNIA E SHPREHJEVE NË KËTË KOD.....	191
PJESA E POSAÇME.....	195
KAPITULLI XIII: VEPRAT PENALE KUNDËR KOSOVËS DHE BANORËVE TË SAJ.....	195
KAPITULLI XIV: VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE.....	199
KAPITULLI XV: VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT.....	220
KAPITULLI XVI: VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT.....	225
KAPITULLI XVII: VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE NË MARRËDHËNIET E PUNËS.....	232
KAPITULLI XVIII: VEPRAT PENALE KUNDËR NDERIT DHE AUTORITETIT....	234
KAPITULLI XIX: VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL.....	235
KAPITULLI XX: VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS DHE FAMILJES.....	244
KAPITULLI XXI: VEPRAT PENALE KUNDËR SHËNDETIT PUBLIK.....	247
KAPITULLI XXII: VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË.....	255
KAPITULLI XXIII: VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË.....	263
KAPITULLI XXIV: VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE.....	271
KAPITULLI XXV: VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË.....	276
KAPITULLI XXVI: VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK.....	279
KAPITULLI XXVII: VEPRAT PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË.....	281
KAPITULLI XXVIII: VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK DHE VEPRIMEVE JURIDIKE.....	286
KAPITULLI XXIX: VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE.....	292
KAPITULLI XXX: DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE.....	296

PJESA E PËRGJITHSHME

KAPITULLI I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

PARIMI I LIGJSHMËRISË

- (1) Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.
- (2) Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një veprë nëse para kryerjes së veprës ligji nuk e përcakton veprën si veprë penale dhe nuk parasheh sanksion penal ose masa të trajtimit të detyrueshëm për atë veprë.
- (3) Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit i cili hetohet, ndiqet ose shpallet fajtor.

Neni 2

ZBATIMI I LIGJIT MË TË FAVORSHËM

- (1) Ndaj kryerësit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.
- (2) Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm.
- (3) Nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryerësi i veprës penale është dënuar me aktgjykim përfundimtar në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar.
- (4) Një ligj i cili shprehimisht ka qenë në fuqi vetëm për një kohëtë caktuar, zbatohet për ato vepra penale që janë kryer gjatë kohës kur ai ligj ka qenë në fuqi edhe në rastin kur nuk është më në fuqi. Por kjo nuk zbatohet nëse vetë ligji shprehimisht e parashikon ndryshe.

Neni 3

SANKSIONET PENALE DHE MASAT E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

- (1) Sanksionet penale janë:
 - 1) Dënimet kryesore;
 - 2) Dënimet alternative;
 - 3) Dënimet plotësuese dhe
 - 4) Vërejtja gjyqësore.

- (2) Masa të trajtimit të detyrueshëm janë:
- 1) Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik për kryerësit e veprës penale të paaftë mendërisht.
 - 2) Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik për kryerësit e veprës penale me aftësi të zvogëluar mendore dhe
 - 3) Trajtimi i detyrueshëm përmes rehabilitimit të kryerësve të veprave penale të varur nga droga dhe alkooli.

Neni 4

KUFIZIMET NË EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE DHE TË MASAVE TË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

Kryerësit të veprës penale me rastin e ekzekutimit të sanksioneve penale ose të trajtimit të detyrueshëm mund t'i mohohen ose t'i kufizohen të drejtat e caktuara vetëm në masën e cila i përgjigjet natyrës a përmbajtjes së atij sanksioni ose mase dhe vetëm në mënyrën me të cilën sigurohet respektimi i dinjitetit njerëzor të individit dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

Neni 5

ZBATIMI I PJESËS SË PËRGJITHSHME TË KËTIJ KODI

Dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi zbatohen për të gjitha veprat penale të përcaktuara në ligjet në fuqi në Kosovë.

KAPITULLI II: VEPRA PENALE DHE PËRGJEGJËSIA PENALE

Neni 6

VEPRA PENALE

Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Neni 7

VEPRA E RËNDËSISË SË VOGËL

Nuk është vepër penale ajo vepër e cila edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj është e rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj nuk është e rëndësishme për shkak të natyrës ose peshës së veprës, të mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; të rrethanave në të cilat është kryer vepra, të shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryerësit të veprës ose për shkak të rrethanave personale të kryerësit.

Neni 8

MBROJTJA E NEVOJSHME

- (1) Nuk është vepër penale vepra e cila është kryer në mbrojtje të nevojshme.
- (2) Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atqasshëm ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.
- (3) Disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.
- (4) Kryerësi i cili i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund të dënohet më lehtë. Nëse kryerësi tejkalon kufijtë për shkak të tronditjes së fortë apo frikës së shkaktuar nga sulmi, ai mund të lirohet nga dënimi.

Neni 9

NEVOJA EKSTREME

- (1) Nuk është vepër penale ajo vepër e cila është kryer në kushtet e nevojës ekstreme.
- (2) Nevoja ekstreme ekziston nëse personi e kryen veprën për të zbrapsur prej vetes ose tjetrit rrezikun e atqasshëm e të paprovokuar, i cili nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër, me kusht që e keqja e shkaktuar nuk është më e madhe se sa e keqja që është kanosur.
- (3) Kur kryerësi e shkakton rrezikun nga pakujdesia apo i tejkalon kufijtë e nevojës ekstreme, dënohet më butë, e nëse tejkalimin e ka bërë në rrethana veçanërisht lehtësuese, ai edhe mund të lirohet nga dënimi.
- (4) Nuk ekziston nevoja ekstreme nëse kryerësi ka qenë i obliguar t'i ekspozohet rrezikut.

Neni 10

URDHËRAT NGA LART

- (1) Fakti që një vepër penale është kryer nga një person në bazë të një urdhri qeveritar ose të një eprori qoftë ushtarak ose civil, nuk e lehtëson kryerësin nga përgjegjësia penale, pos kur:
 - 1) Personi ka qenë i detyruar ligjërisht t'u bindej urdhrave të qeverisë ose të eprorit të tij;
 - 2) Personi nuk e ka ditur se udhri ishte i paligjshëm dhe
 - 3) Urdhri nuk ishte në mënyrë të dukshme i paligjshëm.
- (2) Urdhrat për të kryer gjenocid ose krime të tjera kundër njerëzimit janë gjithëherë qartazi të paligjshme.

Neni 11

PËRGJEGJËSIA PENALE

- (1) Personi konsiderohet penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Personi është fajtor për kryerjen e një vepre penale në rast se ai e kryen veprën penale me dashje apo nga pakujdesia.
- (2) Personi nuk konsiderohet penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë vjet.
- (3) Një person konsiderohet penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e parashikon ligji.

Neni 12

PAAFTËSIA MENDORE DHE AFTËSIA E ZVOGËLUAR MENDORE

- (1) Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet i paaftë mendërisht nëse në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor, që e ka prekur funksionimin e tij mendor, dhe, si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje t'i kuptojë ose t'i kontrollojë veprimet a mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen vepër penale.
- (2) Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar apo për t'i kontrolluar veprimet a mosveprimet e tij ka qenë dukshëm e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masën e trajtimit të detyrueshëm.

Neni 13

KRYERJA E VEPRËS PENALE NË GJENDJE TË DEHUR

Është penalisht përgjegjës kryerësi i veprës penale, i cili duke përdorur alkool, drogë apo me ndonjë mënyrë tjetër e sjell veten në një gjendje të tillë që nuk mund të kuptojë rëndësinë e veprimit apo të mosveprimit të vet ose të kontrollojë sjelljen e vet nëse, para se të ketë sjellë veten në atë gjendje, veprimet ose mosveprimet e tij kanë qenë të përfshira në dashjen e tij apo nëse është i pakujdesshëm ndaj veprës penale dhe ligji parasheh përgjegjësi penale për kryerje të veprës penale nga pakujdesia.

Neni 14

LIDHJA SHKAKORE

Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave mungon lidhja shkasore ose kur nuk ka mundësi të shkaktohen pasojat.

Neni 15

DASHJA

- (1) Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.
- (2) Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.
- (3) Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.

Neni 16

PAKUJDESIA

- (1) Vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme.
- (2) Personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj.
- (3) Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.

Neni 17

PËRGJEGJËSIA PËR PASOJAT MË TË RËNDË

Nëse kryerja e një vepre penale shkakton pasoja të cilat e tejkalojnë qëllimin e kryerësit dhe për këtë ligji parashikon një dënim më të rëndë, dënimi më i rëndë mund të shqiptohet në rast se pasoja i atribuohet pakujdesisë së kryerësit.

Neni 18

LAJTHIMI FAKTIK

- (1) Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë i vetëdijshëm për ndonjë nga tiparet e asaj vepre ose gabimisht ka menduar se ekzistonin rrethanat, të cilat faktikisht po të ekzistonin, kjo vepër do të ishte e lejuar.
- (2) Personi i cili për shkak të pakujdesisë ka qenë në lajthim është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia kur ligji parashikon përgjegjësi penale për vepër të tillë.

Neni 19

LAJTHIMI JURIDIK

- (1) Nuk është penalisht përgjegjës kryerësi i cili për shkaqe të arsyeshme nuk e ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë se vepra është e ndaluar.
- (2) Nëse lajthimi ka qenë i evitueshëm, kryerësi është penalisht përgjegjës, por mund të dënohet më lehtë.
- (3) Lajthimi juridik është i evitueshëm nëse çdokush, pra edhe kryerësi, ka mundur lehtë të dijë se vepra është e kundërligjshme apo nëse është fjala për kryerësin i cili, duke marrë parasysh thirrjen, profesionin apo detyrën e tij ka qenë i obliguar të dijë dispozitën përkatëse.

Neni 20

TENTATIVA

- (1) Kushdo që me dashje ndërmer veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.
- (2) Tentativa për kryerjen e një vepre penale të dënueshme me së paku tre vjet burgim, dënohet, kurse lidhur me veprat e tjera penale tentativa dënohet vetëm nëse ligji e parasheh shprehimisht këtë.
- (3) Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet më butë se sa kryerësi, në pajtim me nenin 65(2) të këtij Kodi.

Neni 21

TENTATIVA E PAPËRSHTATSHME

Gjykata mund ta lirojë nga dënimi personin i cili tenton të kryejë vepër penale me mjete të papërshtatshme ose ndaj objektit të papërshtatshëm.

Neni 22

HEQJA DORË VULLNETARE

- (1) Gjykata e liron personin nga dënimi për tentativë të dënueshme të veprës penale nëse personi i tillë heq dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale të cilën e ka filluar, ndonëse është i vetëdijshëm se në pajtim me të gjitha rrethanat ai mund të vazhdonte veprën ose, nëse pas kryerjes së një vepre të tillë parandalon shkaktimin e pasojave.
- (2) Në rastin e cekur në paragrafin 1 të këtij neni, kryerësi dënohet për ato veprime të cilat përbëjnë vepër tjetër të veçantë penale.

BASHKËPUNIMI NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE

Neni 23

BASHKËKRYERJA

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.

Neni 24

SHTYTJA

Kushdo që me dashje e shtyt tjetrin të kryejë veprë penale dënohet sikurse ai ta kishte kryer atë veprë penale, nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e tij.

Neni 25

NDIHMA

(1) Kushdo që me dashje e ndihmon tjetrin të kryejë veprë penale dënohet sipas nenit 65(2) të këtij Kodi.

(2) Ndhimja për të kryer një veprë penale përfshin këshillimin ose udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dizpozicion të kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale, duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale ose duke i premtuar paraprakisht se do t'i fshehtë provat e veprës së kryer penale, identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

Neni 26

BASHKIMI KRIMINAL

(1) Kushdo që shprehimisht apo në mënyrë të heshtur merret vesh me një apo me më shumë persona për të kryer ose për të nxitur kryerjen e një veprë penale për të cilën ligji parasheh së paku pesë vjet burgim dhe ndërmerr veprime përgatitore për realizimin e marrëveshjes së tillë, si dhe merr pjesë në bashkimin kriminal, dënohet sipas nenit 65(2) të këtij Kodi.

(2) Gjykata mund ta zvogëloj dënimin ose ta liroj nga dënimi personin i cili është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse ai person:

- 1) Vullnetarisht heq dorë nga marrëveshja;
- 2) Vullnetarisht ndërmerr veprime për parandalimin e ekzistencës së vazhdueshme të bashkimit kriminal ose të kryerjes së veprës penale në pajtim me qëllimet e saj ose
- 3) Vullnetarisht ia zbulon policisë njohuritë e marrëveshjes në kohën e duhur kur veprat penale të planifikuara ende mund të parandalohen.

Neni 27

KUFINJTË E PËRGJEGJËSISË PENALE DHE NDËSHKIMI PËR BASHKËPUNIM

(1) Bashkëkryerësi është penalisht i përgjegjshëm brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së vet, ndërsa personi që e shtyt dhe e ndihmon kryerjen e veprës penale është penalisht i përgjegjshëm brenda kufijve të dashjes së tij.

(2) Gjykata e liron nga dënimi bashkëkryerësin ose personin që e shtyt a e ndihmon kryerjen e veprës penale nëse ai person e parandalon vullnetarisht kryerjen e veprës penale.

DISPOZITAT E POSACME MBI PËRGJEGJËSINË PENALE PËR VEPRAT PENALE TË KRYERA ME ANË TË MEDIAVE

Neni 28

PËRGJEGJËSIA PENALE E KRYEREDAKTORËVE, BOTUESVE, SHTYPSHKRONJËSVE OSE PRODHUESVE

(1) Nëse vepra penale është kryer me anë të publikimit të informacionit në gazeta ose në lloje të tjera të shtypit periodik, në radios apo në televizionit, penalisht është përgjegjës autori i informacionit.

(2) Kryeredaktori përgjegjës ose personi i cili e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës është penalisht përgjegjës në rastet kur:

- 1) Autori nuk mund të gjendet ose të gjykohet në gjykatën e Kosovës ose
- 2) Publikimi i informacionit është botuar pa dijen e autorit ose kundër vullnetit të tij.

(3) Botuesi i gazetës ose i llojeve të tjera të shtypit periodikë është përgjegjës, nëse kryeredaktori ose personi që e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatave në gazetë ose në llojet e tjera të shtypit periodik, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund të gjenden ose të gjykohe në gjykatën e Kosovës.

(4) Kur botuesi është penalisht përgjegjës, sipas paragrafit 3 të këtij neni, dhe, për shkak të pengesave ligjore ose faktike nuk është e mundur të dënohet botuesi, atëherë përgjegjës është shtypshkronjësi nëse ai e ka ditur se pengesa e tillë ligjore ose faktike ka ekzistuar.

(5) Prodhuesi është penalisht përgjegjës kur kryeredaktori ose personi që e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informacionit me anë të mjeteve të shiritit manjetik, filmik, diapozitivave, fotografive ose mjeteve të tjera audio dhe video të dedikuara për mediat masive ose për prezentim publik apo për një numër të madh të personave janë penalisht përgjegjës sipas paragrafit 2 të këtij neni e të cilët nuk mund të gjenden ose të gjykohe në gjykatën e Kosovës.

(6) Nëse botuesi, shtypshkronjësi ose prodhuesi si person juridik a organi publik është përgjegjës sipas këtij neni, atëherë personi përgjegjës për shtypjen ose aktivitetin prodhues është penalisht përgjegjës.

(7) Personat e cekur në këtë nen nuk janë penalisht përgjegjës nëse publikimi i informacionit është raport i saktë nga një mbledhje e organit publik ose nga deklarata e një person zyrtar.

Neni 29

MBROJTA E BURIMEVE TË INFORMATAVE

(1) Personi i cili merr pjesë si profesionist në publikimin e informacionit ose si anëtar i këshillit redaktues të mediave dhe ndihmësi i tij nuk janë penalisht përgjegjës nëse refuzojnë ta tregojnë autorin e publikimit ose burimin e informatave.

(2) Personat e cekur në paragrafin 1 të këtij neni nuk janë penalisht përgjegjës nëse gjykata konstaton se:

- 1) Zbulimi i informatave është i domosdoshëm për të parandaluar sulmin që përbën kërcënim të drejtëpërdrejtë ndaj jetës apo integritetit trupor të ndonjë personi ose
- 2) Zbulimi i informatave është i domosdoshëm për të parandaluar veprën penale të dënueshme me burgim prej së paku tre viteve apo për veprën penale të paraparë në nenet 196, 203, 340, 343 ose 344.

Neni 30

ZBATIMI I DISPOZITAVE TË PËRGJITHSHME PËR PËRGJEGJËSINË PENALE

Dispozitat për përgjegjësinë penale të personave të cekur në nenet 28 dhe 29 janë të zbatueshme vetëm nëse ata persona nuk janë penalisht përgjegjës sipas dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale të parapara në këtë Kod.

Neni 31

MËNYRA E KRYERJES SË VEPRAVE PENALE

(1) Vepra penale mund të kryhet me veprim ose me mosveprim.

(2) Vepra penale kryhet me mosveprim vetëm kur kryerësi nuk e ndërmerr veprimin të cilin ka qenë i obliguar ta kryejë.

Neni 32

KOHA E KRYERJES SË VEPRAVE PENALE

Vepra penale është kryer në kohën kur kryerësi ka vepruar apo ka qenë i obliguar të veprojë pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasojja.

Neni 33

VENDI I KRYERJES SË VEPRAVE PENALE

- (1) Vepra penale është kryer në vendin ku kryerësi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprtojë ashtu si dhe në vendin ku është shkaktuar pasoja.
- (2) Vepra penale është tentuar në vendin ku kryerësi ka vepruar si dhe në vendin ku sipas dashjes së kryerësit është dashur të shkaktohet pasoja.

KAPITULLI III: DËNIMET

Neni 34

QËLLIMI I DËNIMIT

Qëllimet e dënimit janë:

- 1) Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij dhe
- 2) Të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Neni 35

LLOJET E DËNIMEVE

Ekzistojnë dënimet kryesore, dënimet alternative dhe plotësuese.

DËNIMET KRYESORE

Neni 36

DËNIMET KRYESORE

Dënimet kryesore janë:

- 1) Dënimi me burgim afatgjatë;
- 2) Dënimi me burgim dhe
- 3) Dënimi me gjobë.

Neni 37

DËNIMI ME BURGIM AFATGJATË

- (1) Ligji mund të parasheh dënim me burgim afatgjatë për veprat më të rënda penale të kryera me dashje ose nën rrethana veçanërisht rënduese ose që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda.
- (2) Burgimi afatgjatë shqiptohet në kohëzgjatje prej njëzet e një deri në dyzet vjet.

- (3) Burgimi afatgjatë nuk mund të parashihet si i vetmi dënim kryesor për një vepër të veçantë penale.
- (4) Nëse është shqiptuar dënimi me burgim afatgjatë, lirimi me kusht mund të jepet vetëm pasi të jenë mbajtur tri të katërtat e këtij dënimi.

Neni 38

DËNIMI ME BURGIM

- (1) Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se pesëmbëdhjetë ditë e as më tepër se njëzet vjet.
- (2) Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe në muaj të plotë, e në rastet kur dënimi është deri në gjashtë muaj, dënimi shqiptohet në ditë të plota.
- (3) Kur gjykata cakton dënimin me burgim deri në tre muaj, gjykata mund të caktojë që dënimi me burgim të zëvendësohet me gjobë ose me punë në dobi të përgjithshme, por me pëlqimin e kryerësit.

Neni 39

DËNIMI ME GJOBË

- (1) Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se 50 euro evropiane (në tekstin e mëtejme euro). Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më i lartë se 25.000 euro ose për vepra penale të kryera me qëllim të fitimit të dobisë pasurore nuk mund të jetë më i lartë se 500.000 euro.
- (2) Në aktgjykim caktohet afati i pagimit të dënimit me gjobë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë ditë e as më i gjatë se tre muaj, mirëpo në rrethana të arsyetueshme gjykata mund të lejojë që i dënuari ta paguajë dënimin me gjobë edhe me këste, por afati i pagesës nuk mund të jetë më i gjatë se dy vjet.
- (3) Nëse personi i dënuar refuzon të paguajë gjobën ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, gjykata mund të lejojë që gjoba të paguhet në këste gjatë një periudhe e cila nuk i tejkalon dy vjet. Pas kësaj, nëse personi i dënuar vazhdon të refuzojë pagesën e gjobës ose nuk është në gjendje ta bëjë këtë, gjykata, me pajtimin e personit të dënuar, mund ta zëvendësojë gjobën me një urdhër për punë në dobi të përgjithshme, e cila, sa të jetë e mundur, nuk e pengon në aktivitetet e tij të rregullta të punës.
- (4) Nëse personi i dënuar nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, gjykata cakton një ditë burgim për çdo 15 euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos tejkalojë gjashtë muaj.
- (5) Dënimi me gjobë mund të shqiptohet edhe si dënim plotësues (neni 54 i këtij Kodi).
- (6) Dënimi me gjobë nuk ekzekutohet pas vdekjes së të dënuarit.

Neni 40

ZËVENDËSIMI I DËNIMIT ME URDRIN PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

- (1) Gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund caktojë urdhrin për punë në dobi të përgjithshme si zëvendësim të dënimit me burgim ose me gjobë sipas nenit 38(3) ose nenit 39(3).
- (2) Nëse e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhron personin e dënuar të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një periudhë të caktuar kohe prej 30 deri në 240 orë. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.
- (3) Puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet brenda kohës së caktuar nga gjykata dhe kjo kohë nuk duhet të kalojë një vit.
- (4) Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose vetëm pjesërisht e ka kryer punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata mund të caktojë një afat të burgimit në proporcion me kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që nuk është kryer. Afati i burgimit nuk duhet të tejkalojë afatin e parë të burgimit në rastin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme të lëshuar sipas nenit 38(3) ose nuk duhet t'i tejkalojë gjashtë muaj në rastin e urdhrin për punë në dobi të përgjithshme të lëshuar sipas nenit 39(3).

DËNIMET ALTERNATIVE

Neni 41

DËNIMET ALTERNATIVE

- (1) Dënimet alternative janë:
 - 1) Dënimi me kusht dhe
 - 2) Gjysmëliria.
- (2) Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:
 - 1) Urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues;
 - 2) Urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues dhe
 - 3) Urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

Neni 42

QËLLIMI I DËNIMIT ME KUSHT

Qëllimi i dënimit me kusht është që kryerësit t'i jep qortimin, i cili e arrin qëllimin e dënimit përmes shpalljes së dënimit pa ekzekutimin e dënimit.

Neni 43

DËNIMI ME KUSHT

(1) Gjykata mund t'ia shqiptojë dënimin me kusht kryerësit sipas kushteve të parapara me këtë Kod.

(2) Me rastin e caktimit të dënimit me kusht, gjykata ia shpall personit të dënuar dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar për kohën të cilën e cakton gjykata (koha e verifikimit), e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit dhe as më e gjatë se pesë vjet, nuk kryen vepër tjetër penale.

(3) Në dënimin me kusht, gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet nëse në afatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen përfitimin pasuror të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenzon dëmin që e ka shkaktuar me vepër penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me dispozitat e ligjit penal. Afati për përmbushjen e këtyre detyrimeve caktohet nga gjykata në kuadrin e kohës së verifikimit.

Neni 44

KUSHTET PËR SHQIPTIMIN E DËNIMEVE ME KUSHT

(1) Kryerësit mund t'i shqiptohet dënim me kusht për veprën penale e cila dënohet me burgim deri në pesë vjet dhe për kryerësin e veprës penale për të cilën është paraparë dënimi deri në dhjetë vjet burgim, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit.

(2) Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryerësit ashtu siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni kur gjykata e shqipton dënim me gjobë ose me burgim deri në dy vjet qoftë për një vepër penale, qoftë për bashkim të veprave penale.

(3) Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryerësit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera sipas të cilave është kryer vepra penale.

(4) Nëse kryerësit i është shqiptuar dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy dënimet apo vetëm për dënimin me burgim.

Neni 45

REVOKIMI I DËNIMIT ME KUSHT PËR SHKAK TË VEPRAVE TË REJA PENALE

(1) Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej së paku dy apo më tepër vjet.

(2) Gjykata mund ta revokojë dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim me më pak se dy vjet ose dënimi me gjobë pasi t'i ketë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera si dhe personit të dënuar dhe sidomos ngjashmëritë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale.

(3) Nëse e revokon dënimin me kusht, gjykata shqipton dënimin unik për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale, në pajtim me nenin 71 të këtij Kodi dhe duke i konsideruar dënimet e revokuara me kusht si të përcaktuara.

(4) Nëse gjykata nuk e revokon dënimin me kusht, ajo mund ta shqiptojë dënimin me kusht a me burgim ose dënimin me gjobë për veprën e re penale. Nëse gjykata shqipton dënim me kusht për veprën e re penale, ajo i zbaton dispozitat e nenit 71 të këtij Kodi për ta shqiptuar dënimin e bashkuar me kusht për veprën penale të kryer më parë dhe për veprën e re penale dhe po ashtu e cakton një periudhë të bashkuar të verifikimit e cila nuk mund të jetë më pak se një vit dhe më shumë se pesë vjet, duke filluar prej ditës kur ka hyrë në fuqi vendimi. Nëse gjykata shqipton dënim me kusht për veprën e re penale, periudha kohore që kalohet në mbajtjen e dënimit me burgim nuk hiqet nga koha e verifikimit e vendosur me dënimin me kusht për veprën penale të kryer më parë.

Neni 46

REVOKIMI I DËNIMIT ME KUSHT PËR SHKAK TË VEPRAVE PENALE TË KRYERA MË PARË

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me vendim të formës së prerë konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër penale tjetër para se të jetë dënuar me kusht dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër. Në rastin e këtyllë, zbatohen dispozitat e nenit 45(3) të këtij Kodi.

Neni 47

REVOKIMI I DËNIMIT ME KUSHT PËR SHKAK TË MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE TË CAKTUARA

Nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përmbushjen e një detyrimi të paraparë me nenin 43(3) të këtij Kodi dhe personi i dënuar nuk e përmbush këtë detyrim në afatin e caktuar nga gjykata, gjykata mund ta vazhdojë afatin e përmbushjes së detyrimit brenda afatit të verifikimit apo mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta ekzekutojë dënimin i cili është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se i dënuari për shkaqe të arsyeshme nuk ka mund tai përmbushë detyrimin e caktuar më parë, gjykata e heq përmbushjen e atij detyrimi ose e zëvendëson atë me një detyrim tjetër përkatës të paraparë me ligj.

Neni 48

AFATET PËR REVOKIMIN E DËNIMIT ME KUSHT

(1) Dënimi me kusht mund të revokohet gjatë kohës së verifikimit. Nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe kryen veprë penale për të cilën kërkohet revokimi i dënimit me kusht, mirëpo kjo është konstatuar me aktgjykim vetëm pas skadimit të kohës së verifikimit, dënimi me kusht mund të revokohet jo më vonë se brenda një viti nga dita kur skadon koha e verifikimit.

(2) Nëse personi i dënuar nuk e përmbush brenda afatit të caktuar nga gjykata njërin detyrim të paraparë në nenin 43(3) të këtij Kodi, gjykata mund të revokojë dënimin me kusht më së voni brenda një viti nga dita kur ka skaduar koha e verifikimit dhe të caktojë që të ekzekutohet dënimi i caktuar në dënimin me kusht.

Neni 49

DËNIMI ME KUSHT I REVOKUAR ME URDRIN PËR TRAJTIM TË DETYRUESHËM REHABILITUES

(1) Gjkata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata konsideron se faktori kryesor që ka ndikuar në kryerjen e veprës penale është alkooli ose droga dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues.

(2) Programi i trajtimit mbikëqyret nga shërbimi sprovues.

(3) Dënimi konsiderohet se është mbajtur me kryerjen e suksesshme të programit të trajtimit rehabilitues.

(4) Nëse personi i dënuar largohet nga programi i trajtimit rehabilitues apo nuk i përmbush detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, munda ta shtyjë kohëzgjatjen e urdhrin për trajtim ose ta revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Neni 50

DËNIMI ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKËQYRJE NGA SHËRBIMI SPROVUES

(1) Gjkata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues pas shqyrtimit të dosjes së shërbimit sprovues.

(2) Kur shqipton dënimin me kusht me urdhër të mbikëqyrjes nga shërbimi sprovues, gjykata e urdhëron personin e dënuar për të mbajtur kontaktin me shërbimin sprovues. Gjkata po ashtu mund t'i urdhërojë personit të dënuar të kryejë një ose më shumë detyrime të parapara me nenin 43(3) ose nenin 51 të këtij Kodi. Kohëzgjatja e një detyrimi të paraparë me nenin 51 nuk mund të jetë më pak se gjashtë muaj ose më shumë se tri vjet.

(3) Me rastin e zgjedhjes midis detyrimeve të parapara me nenin 51 të këtij Kodi, gjykata merr parasysh në veçanti moshën e personit të dënuar, gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën, motivet për kryerjen e veprës penale, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, sjelljen e tij të kaluar, rrethanat e tij të tjera personale dhe ato në lidhje me familjen që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit të mbikëqyrjes dhe të kohëzgjatjes së saj.

(4) Nëse personi i dënuar nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 51 të këtij Kodi, siç është caktuar nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.

Neni 51

LLOJET E DETYRIMEVE TË PËRFSHIRA NË DËNIMIN ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKËQYRJE NGA SHËRBIMI SPROVUES

Me qëllim të kryerjes së një ose më shumë nga detyrimet e mëposhtme, me dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues po ashtu mund të përfshihet:

- 1) Mjekimi ose rehabilitimin në entin shëndetësor;
- 2) Nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;
- 3) Vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;
- 4) Aftësimi profesional në një profesion të caktuar;
- 5) Kryerja e aktiviteteve punuese;
- 6) Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve familjare;
- 7) Mosdërrimi i vendbanimit pa autorizimin e shërbimit sprovues;
- 8) Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;
- 9) Heqja dorë nga frekuentimi në vende apo lokale ku shërbehen pije alkoolike;
- 10) Heqja dorë nga shoqërimi me persona të caktuar ose
- 11) Heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve.

Neni 52

DËNIMI ME KUSHT ME URDHËR PËR PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME

(1) Pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues, gjykata mund t'ia shqiptojë kryerësit dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme të paraparë në paragrafin 1 të

nenit 44 nëse gjykata e shpall dënimin me gjobë deri në 2.500 euro ose me burgim deri në një vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar.

(2) Nëse e shqipton dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej 30 deri në 240 orë pune. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe mbikqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

(3) Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon një vit.

(4) Nëse e shqipton dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata, po ashtu, mund t'i urdhërojë personit të dënuar të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues ose kryerjen e një a më shumë prej detyrimeve të parapara me nenin 43(3), ose nenin 51 të këtij Kodi. Kohëzgjatja e detyrimit të paraparë me nenin 51 nuk duhet të jetë më e shkurtër se gjashtë muaj ose më e gjatë se sa tri vjet. Neni 50(3) zbatohet përshtatshmërisht për detyrimin e urdhëruar me këtë paragraf.

(5) Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e kryen detyrimin nga neni 51 të urdhëruar nga gjykata, atëherë gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, mund ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.

Neni 53

GJYSMËLIRIA

(1) Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në një vit, mund të urdhërojë ekzekutimin e dënimit me gjysmëliri për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë esenciale familjare apo me nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor. Kur e vuan dënimin në gjysmëliri, personi i dënuar detyrohet që të kthehet në burg pas kryerjeve të detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata.

(2) Nëse i dënuari nuk i përmbush detyrimet që lidhen me punën, arsimin ose aftësimin profesional, nuk i kryen detyrimet themelore familjare, nuk pranon trajtimin e nevojshëm mjekësor apo rehabilitues apo nuk kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve të tij, gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg.

DËNIMET PLOTËSUESE

Neni 54

DËNIMET PLOTËSUESE

- (1) Dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose alternativ.
- (2) Dënimet plotësuese janë:
 - 1) Gjoba;
 - 2) Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur;
 - 3) Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik;
 - 4) Ndalimi i ushtrimit të profesionit, i aktiviteteve ose detyrës;
 - 5) Ndalimi për të drejtuar automjetin;
 - 6) Marrja e lejes së vozitjes;
 - 7) Marrja e sendit;
 - 8) Urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe
 - 9) Dëbimi i të huajit nga territori i Kosovës.
- (3) Dënimi plotësues me ndalimin e drejtimit të automjetit, me marrje të lejes së vozitjes dhe të sendit mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht me vërejtjen e gjykatës ose me lirimin nga dënimi.

Neni 55

HEQJA E TË DREJTËS PËR T'U ZGJEDHUR

Gjykata ia heq kryerësit të drejtën për t'u zgjedhur prej një deri në tre vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjedhet shërbehet me kërcënim, falsifikon listat e votimit ose kryen ndonjë veprë tjetër penale për të cilën i është shqiptuar dënimi me së paku 5 vjet burgim.

Neni 56

NDALIMI I USHTRIMIT TË FUNKSIONEVE NË ADMINISTRATËN PUBLIKE OSE NË SHËRBIMIN PUBLIK

- (1) Gjykata ia ndalon kryerësit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një deri në pesë vjet pas mbajtjes së dënimin me burgim, nëse ai person i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim jo më pak se dhjetë vjet.

(2) Gjykata mund t'ia ndalojë kryerësit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një deri në tre vjet pas mbajtjes së dënimit me burg, nëse ai person i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim deri në dhjetë vjet.

(3) Kur shqiptohet dënim me kusht, gjykata mund të vendosë që dënimi me kusht të revokohet nëse kryerësi nuk i përmbahet ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike apo në shërbimin publik.

Neni 57

NDALIMI I USHTRIMIT TË PROFESIONIT, VEPRIMTARISË OSE DETYRËS

(1) Kryerësit të veprës penale gjykata mund t'ia ndalojë ushtrimin e profesionit të caktuar, veprimtarinë e pavarur, detyrën menaxhuese a administrative ose të detyrave që janë të lidhura me sistemimin, menaxhimin a shfrytëzimin e pasurisë në pronësi shoqërore apo mbrojtjen e pasurisë së tillë, nëse ai person e ka keqpërdoruar pozitën e tij, veprimtarinë apo detyrën e tij me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse me arsye mund të pritët se ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale.

(2) Gjykata e cakton kohëzgjatjen e dënimit të caktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një vit as më i gjatë se pesë vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit, me ç'rast koha e kaluar në burg, përkatësisht në entin shëndetësor, nuk i llogaritet në kohëzgjatje të këtij dënimi.

(3) Me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, gjykata mund të vendosë që ky dënim me kusht të revokohet nëse kryerësi nuk e respekton ndalesën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Neni 58

NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT

(1) Kryerësit të veprës penale, i cili e rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar.

(2) Gjykata e cakton kohëzgjatjen e dënimit nga paragrafi 1 i këtij neni dhe ajo nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit dhe më e gjatë se pesë vjet, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me kusht që koha e kaluar në burg apo në entin shëndetësor të mos llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

(3) Në rastet kur është shqiptuar dënim me kusht, gjykata mund të vendosë që dënimi i tillë të revokohet nëse kryerësi e shkel ndalesën e drejtimit të automjetit.

(4) Nëse dënimi nga paragrafi 1 i këtij neni i është shqiptuar personit, i cili e ka lejen e huaj për drejtimin e automjetit, ky dënim do të konsistojë në ndalimin për përdorimin e kësaj leje në territorin e Kosovës.

Neni 59

MARRJA E LEJES SË VOZITJES

(1) Kryerësit të veprës penale që e rrezikon sigurinë në trafikun publik gjykata mund t'ia marrë lejen e vozitjes për llojin apo kategorinë e caktuar të automjetit dhe t'ia ndalojë kryerësit marrjen e lejes së re gjatë periudhës prej një deri në pesë vjet. Nëse kryerësi nuk ka leje të vozitjes, gjykata ia ndalon kryerësit marrjen e lejes së vozitjes brenda afatit të sipërpërmendur.

(2) Gjkata mund të shqiptojë dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni nëse kryerësi ka kryer veprë penale duke shkaktuar plagosjen e rëndë trupore a vdekjen e personit ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e tij në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë në trafikun publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit.

(3) Leja e vozitjes merret me vendim të formës së prerë të gjykatës. Koha e kaluar në burg apo në entin shëndetësor nuk i llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

(4) Pas skadimit të afatit, të cilin ia ka caktuar gjykata, kryerësi mund ta marrë lejen e re të vozitjes sipas kushteve të përgjithshme të parapara për marrjen e lejes përkatëse të vozitjes.

Neni 60

MARRJA E SENDIT

(1) Sendet të cilat janë përdorur apo janë dedikuar për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale mund të merren nëse janë pronë e kryerësit.

(2) Sendet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të merren edhe kur nuk janë pronë e kryerësit nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme, por nëse marrja e tillë nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e personave të tretë për të marrë kompensimin e dëmit nga kryerësi.

(3) Me ligj mund të përcaktohet marrja e obligueshme e sendit.

Neni 61

URDHRI PËR PUBLIKIMIN E AKTGJYKIMEVE

(1) Gjkata mund të urdhërojë publikimin e aktgjykimit kur çmon se publikimi është në interes të përgjithshëm të të dëmtuarit ose të personave të tjerë.

(2) Urdhri për publikimin e aktgjykimit kërkon që aktgjykimi të publikohet tërësisht ose pjesërisht në gazetë, të transmetohet në radio ose në televizion me shpenzimet e të dënuarit.

(3) Data e publikimit dhe kohëzgjatja caktohen nga gjykata.

(4) Gazeta, radiostacioni ose stacioni televiziv e publikojnë aktgjykimin të cilin ua ka dërguar gjykata.

(5) Publikimi i aktgjykimit nuk urdhërohet nëse e rrezikon fshehtësinë zyrtare, jetën private të personave ose moralin e shoqërisë.

Neni 62

DËBIMI I TË HUAJVE NGA TERRITORI I KOSOVËS

- (1) Gjykata mund të urdhërojë dëbimin e të huajit nga territori i Kosovës në kohëzgjatje prej një deri në dhjetë vjet.
- (2) Kur gjykata vendos për shqiptimin e dënimit nga paragrafi 1 i këtij neni dhe kohëzgjatjen e këtij dënimi, ajo duhet të merr parasysh llojin dhe peshën e veprës penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe lidhjen e kryerësit me Kosovën.
- (3) Dënimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk shqiptohet nëse ekzekutimi i dënimit është në kundërshtim me nenin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Fundamentale të 4 nëntorit 1950 dhe Protokolleve gjithashtu dhe me Konventën lidhur me Statusin e Refugjatëve të 28 korrikut 1951 dhe Protokollit të saj të 31 janarit 1967 ose Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit tjetër të Vrazhdë, Çnjerëzor dhe Poshtëruar të 17 dhjetorit 1984.
- (4) Kohëzgjatja e dëbimit llogaritet nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit të gjykatës, me kusht që koha e kaluar në burg ose në entin shëndetësor të mos i llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

Neni 63

EKZEKUTIMI I DËNIMEVE PLOTËSUESE

- (1) Ekzekutimi i dënimeve plotësuese sipas paragrafit 2 të nenit 54 të këtij Kodi fillon së bashku me ekzekutimin e dënimit kryesor ose të dënimit alternativ.
- (2) Ekzekutimi i dënimit plotësues nga pikat 2, 3, 4, 5, 6 dhe 9 e nenit 54(2) të këtij Kodi fillon pas mbajtjes së dënimit me burgim. Gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, personi i dënuar nuk mund t'i ushtrojë të drejtat e kufizuara nga dënimet plotësuese.

MATJA E DËNIMIT

Neni 64

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR MATJEN E DËNIMIT

- (1) Gjykata e cakton dënimin për veprë penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë veprë penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat letësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit.
- (2) Nëse gjykata cakton dënimin për veprën penale të kryer nga recidivisti posaçërisht merr parasysh nëse personi më parë ka kryer veprë penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe sa kohë ka kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm ose nga dënimi i mbajtur ose i falur.

(3) Me rastin e matjes së dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryerësit dhe posaçërisht shumën e të ardhurave personale dhe të ardhurat e tjera të tij, pasurinë dhe detyrimet e tij.

Neni 65

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR ZBUTJEN OSE ASHPËRSIMIN E DËNIMEVE

(1) Kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi i paraparë për veprën e kryer penale, ndërsa dënimi më i butë ose më i rëndë mund të shqiptohet vetëm në pajtim me kushtet e parapara me këtë Kod.

(2) Dënimi i shqiptuar për tentativë, për ndihmë dhe për bashkim kriminal nuk duhet të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për veprën penale. Në rastet e dënimit me gjobë e njëjta do të zbatohet edhe për maksimumin e gjobës të paraparë me ligj.

Neni 66

ZBUTJA E DËNIMEVE

Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit:

- 1) Kur ligji parasheh se dënimi i kryerësit mund të zbutet ose
- 2) Kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se edhe me dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Neni 67

KUFIJTË E ZBUTJES SË DËNIMEVE

(1) Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 66 i këtij Kodi, gjykata e zbut dënimin brenda këtyre kufijve:

- 1) Nëse për veprën penale është paraparë dënimi me burgim afatgjatë, dënimi mund të zbutet deri në dhjet vjet burgim;
- 2) Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët e dënimit me burgimi prej së paku tri vjet, dënimi mund të zbutet deri në një vit burgim;
- 3) Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët e dënimit me burgimi prej dy vjet, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë muaj burgim;
- 4) Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët e dënimit me burgimi prej një viti, dënimi mund të zbutet deri në tre muaj burgim;
- 5) Nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët e dënimit dënimi me më pak se një vit burg, dënimi mund të zbutet deri në pesëmbëdhjetë ditë burgim;

- 6) Nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim;
- 7) Nëse për veprën penale nuk është paraparë shuma më e ulët e gjobës, gjoba mund të zbutet deri në 50 euro.

(2) Me rastin e vendosjes së shkallës së zbutjes së dënimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, gjykata merr posaçërisht parasysh shkallën më të ulët dhe më të lartë të dënimit të paraparë për vepër penale.

Neni 68

LIRIMI NGA DËNIMI

- (1) Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale vetëm kur kjo shprehimisht parashihet me ligj.
- (2) Kur gjykata është e autorizuar me ligj që kryerësin e veprës penale ta lirojë nga dënimi, ajo mund t'ia zbusë dënimin pa marrë parasysh kufizimet e parapara për zbutjen e dënimit.

Neni 69

BAZAT E POSAÇME TË LIRIMIT NGA DËNIMI PËR VEPRA PENALE TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale të kryer nga pakujdesia në rastet e mëposhtme:

- 1) Kur pasojat e asaj vepre penale aq rëndë e godasin kryerësin sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij ose
- 2) Kur kryerësi menjëherë pas kryerjes së veprës penale ka bërë përpjekje për evitimin ose zvogëlimin e pasojave të asaj vepre dhe nëse në tërësi apo në një masë të madhe e ka kompenzuar dëmin i cili është shkaktuar nga ajo vepër.

Neni 70

ASHPËRSIMI I DËNIMIT PËR RECIDIVIZËM TË SHUMËFISHTË

- (1) Për veprën penale të kryer me dashje, për të cilën është paraparë dënimi me burgim, gjykata mund të shqiptojë dënim më të rëndë nga sa është paraparë në këtë rast:
 - 1) Nëse kryerësi është dënuar më parë dy apo më shumë herë për vepra penale të kryera me dashje me së paku një vit burgim dhe
 - 2) Nëse nga dita e lirimit të kryerësit nga mbajtja ose e përfundimit të dënimit të shqiptuar të mëparshëm deri në kryerjen e veprës së re penale kanë kaluar më paku se pesë vjet.

- (2) Gjykata mund të shqiptojë dënim më të rëndë duke ia shtuar maksimumit të dënimit jo më shumë se gjysmën e atij maksimumi.
- (3) Me rastin e vlerësimit për shqiptimin e dënimit më të rëndë, gjykata merr parasysh veçanërisht pranimin e fajit, ngjashmërinë e veprave penale të kryera, motivet nga të cilat janë kryer, rrethanat në të cilat janë kryer si dhe nevojën për shqiptim të dënimit të tillë për ta realizuar qëllimin e dënimit.
- (4) Ky nen nuk zbatohet për dënimin me burgim afatgjatë.

Neni 71

DËNIMI PËR BASHKIM TË VEPRAVE PENALE

- (1) Nëse kryerësi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpallë dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.
- (2) Dënimin unik gjykata e shqipton sipas këtyre rregullave:
- 1) Nëse për ndonjërin prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim afatgjatë, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim;
 - 2) Nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet vjetësh;
 - 3) Nëse gjykata e ka shpallur dënimin me burgim deri në tri vjet për secilën prej veprave penale, dënimi unik me burgim nuk mund të jetë më i madh se tetë vjet;
 - 4) Nëse gjykata ka caktuar dënime me gjobë për secilën nga veprat penale, dënimi unik me gjobë nuk duhet të tejkalojë shumën prej 25.000 euro, përkatësisht 50.000 euro kur një apo shumë vepra penale janë kryer me qëllim të përfitimit material;
 - 5) Nëse gjykata për disa vepra penale ka shpallur dënime me burgim, ndërsa për vepra të tjera ka shpallur dënimin me gjobë, ajo shqipton dënim unik me burgim dhe një dënim me gjobë në pajtim me pikat 2 deri 4 të të paragrafit 2 të këtij neni.
- (3) Dënimin plotësues gjykata e shqipton nëse është paraparë së paku për një nga veprat penale ose nëse gjykata ka shpallur dënime me gjobë për shumë vepra penale, atëherë ajo e shqipton një dënim unik me gjobë sipas pikës 4 të paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 72

LLOGARITJA E DËNIMIT TË PERSONAVE TË DËNUAR

(1) Nëse personi i dënuar gjykohet për vepër penale të kryer para se të ketë filluar mbajtjen e dënimit të shqiptuar me një dënim të mëparshëm, apo për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim apo burgim afatgjatë, gjykata shqipton dënimin unik për të gjitha veprat penale (neni 71 të këtij Kodi), duke marrë parasysh dënimin e mëparshëm të shqiptuar. Dënimi ose pjesa e dënimit të cilën i dënuari e ka mbajtur llogaritet në dënimin e shqiptuar unik.

(2) Për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë, gjykata ia cakton dënimin kryerësit pavarësisht nga dënimi i shqiptuar më herët nëse zbatimi i dispozitave të nenit 71 të këtij Kodi nuk do ta arrinte qëllimin e dënimit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e pjesës së pambajtur të dënimit të shqiptuar më parë.

Neni 73

LLOGARITJA E PARABURGIMIT DHE E DËNIMIT TË MËPARSHËM

(1) Koha e kaluar në paraburgim si dhe çdo periudhë e heqjes nga liria lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, me burgim afatgjatë dhe me dënim me gjobë.

(2) Burgimi ose dënimi me gjobë të cilin i dënuari e ka mbajtur, përkatësisht e ka paguar për kundërvajtje apo për delikt ekonomik, përfshihen në dënimin e shqiptuar për vepër penale, tiparet e së cilës përfshijnë edhe tiparet e kundërvajtjes apo të deliktit ekonomik.

(3) Masa mbrojtëse e cila është shqiptuar për kundërvajtje ose për delikt ekonomik përfshihet në dënimin plotësues për vepër penale, tiparet e së cilës i përfshijnë edhe tiparet e kundërvajtjes apo të deliktit ekonomik.

(4) Një ditë paraburgim, një ditë të heqjes së lirisë, një ditë burgim, një ditë burgim afatgjatë dhe 15 euro të dënimit me gjobë barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni.

KAPITULLI IV: VËREJTJA E GJYKATËS

Neni 74

QËLLIMI I VËREJTJES SË GJYKATËS

Qëllimi i vërejtjes së gjykatës është që t'i jepet kryerësit qortimi kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryerësin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit.

Neni 75

VËREJTJA E GJYKATËS

(1) Me vërejtje të gjykatës, kryerësit i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale për të cilën nëse ai sërish kryen veprë të tillë gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

(2) Vërejtja e gjykatës mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një vit ose dënimi me gjobë, në rastet kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat penale veçanërisht të lehta.

(3) Për vepra penale të caktuara dhe në kushtet e parapara me ligj, vërejtja e gjykatës mund të shqiptohet edhe kur është paraparë dënimi me burgim deri në tre vjet.

(4) Gjykata mund të shqiptojë vërejtjen e gjykatës për më shumë se një veprë penale të kryer në bashkim, nëse për çdonjërin nga këto vepra ekzistojnë kushtet nga paragrafet 2 ose 3 të këtij neni.

(5) Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, gjykata veçanërisht merr parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, sjelljen e kryerësit në të kaluarën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale dhe pjesëmarrjen vullnetare të kryerësit në programin e trajtimit.

KAPITULLI V: MASAT E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

Neni 76

DISPOZITAT E VEÇANTA PËR MASAT E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK

Procedurat për urdhërimin e masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik për kryerësin me paaftësi mendore ose me aftësi të zvogëluar mendore do të parashihen veçan me anë të ligjit.

Neni 77

TRAJTIMI ME ANË TË REHABILITIMIT TË DETYRUESHËM I PERSONAVE TË VARUR NGA DROGA OSE ALKOOLI

(1) Gjykata mund t'ia urdhërojë trajtimin e rehabilitimit të detyrueshëm në një ent shëndetësor secilit person i cili e ka kryer veprën penale nën ndikimin e drogës apo alkoolit, nëse gjykata ka shqiptuar dënimin, vërejtjen e gjykatës ose kryerësin e ka liruar nga dënimi dhe nëse konstaton se faktori kryesor që ka e ka motivuar kryerjen e veprës penale ishte varësia nga alkooli apo droga dhe nëse ka gjasa për mjekimin e tij të suksesshëm. Koha e kaluar në entin shëndetësor i llogaritet në masën e dënimit.

(2) Nëse shqiptohet masa nga paragrafi 1 i këtij neni, krahas dënimit me gjobë, vërejtjes së gjykatës apo lirimit nga dënimi, gjykata mund të vendosë, me pëlqimin e të dënuarit, që masa e tillë e trajtimit të ekzekutohet në liri. Nëse kryerësi pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet trajtimit në liri ose arbitrarisht e braktis trajtimin, gjykata mund të urdhërojë që trajtimi të ekzekutohet në entin shëndetësor.

(3) Nëse masa nga paragrafi 1 i këtij neni është shqiptuar krahas dënimit me burg, ajo mund të zgjasë derisa të kryhet dënimi. Nëse masa nga paragrafi 1 i këtij neni është shqiptuar krahas dënimit me gjobë, vërejtjes gjyqësore apo lirimit nga dënimi, trajtimi nuk mund të zgjasë më tepër se dy vjet. Gjykata duhet të shqyrtojë ekzekutimin e kësaj mase çdo dy muaj për të vendosur nëse është e nevojshme të vazhdohet masa.

KAPITULLI VI: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR EKZEKUTIMIN E DËNIMEVE

Neni 78

EKZEKUTIMI I DËNIMEVE ME BURGIM DHE ME BURGIM AFATGJATË

(1) Dënimi me burgim mbahet në objekte të mbyllura, gjysëm të mbyllura apo të hapura të enteve të caktuara për zbatimin e dënimeve.

(2) Burgimi afatgjatë mbahet në entet e mbyllura të caktuara për zbatimin e dënimeve.

(3) Gjatë zbatimit të një dënimi, personi i dënuar nuk duhet t'i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës dhe as dënimit që përfshin mundime të panevojshme mendore dhe fizike, si dhe privimin nga nevojat elementare, duke përfshirë edhe trajtimin adekuat mjekësor.

Neni 79

KUFIJTË NË EKZEKUTIMIN E DËNIMEVE

Gjatë ekzekutimit të dënimit, të drejtat themelore të personit të dënuar duhet të respektohen gjithmonë. Të drejtat e personit të dënuar mund të kufizohen aq sa është e nevojshme dhe në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Neni 80

LIRIMI ME KUSHT

- (1) Personi i dënuar mund të lirohet me kusht nëse ekziton baza e arsyeshme se ai nuk do të kryejë veprë të re penale. Kur merret vendimi për lirimin me kusht të personit të dënuar duhet të merret parasysh sjellja e tij gjatë mbajtjes së dënimit.
- (2) Personi i dënuar i cili e ka mbajtur gjysmën e dënimit me burgim mund të lirohet me kusht dhe të lirohet nga burgu me kusht seai nuk do të kryejë veprë tjetër penale para skadimit të dënimit.
- (3) Personi i dënuar i cili ka mbajtur një të tretën e dënimit me burgim përjashtimisht mund të lirohet me kusht kur rrethanat e veçanta që lidhen me personin e dënuar tregojnë se ai nuk do të kryejë veprë të re penale.
- (4) I dënuari i cili ka mbajtur tri të katërtat e dënimit me burgim afatgjatë mund të lirohet me kusht.
- (5) Për lirimin me kusht vendos trupi gjykues i themeluar nga organi kompetent publik në fushën e çështjeve gjyqësore në pajtim me ligjin.

Neni 81

REVOKIMI I LIRIMIT ME KUSHT

- (1) Gjykata e revokon lirimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë lirimit me kusht kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me më tepër se një vit burgim.
- (2) Gjykata mund ta revokojë lirimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë lirimit me kusht kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim deri në një vit. Me rastin e vlerësimit se a duhet revokuar lirimin me kusht, gjykata merr parasysh posaçërisht ngjashmërinë e veprave penale të kryera, motivet për të cilat janë kryer dhe rrethanat e tjera të cilat tregojnë arsyeshmërinë e revokimit të lirimit me kusht.
- (3) Kur gjykata e revokon lirimin me kusht, ajo e shqipton dënimin në bazë të dispozitave nga neni 71 dhe 72(2) i këtij Kodi, duke e konsideruar dënimin e mëparshëm të shqiptuar si të përcaktuar. Pjesa e dënimit të shqiptuar më parë, të cilin personi i dënuar e ka mbajtur në bazë të dënimit të mëparshëm, do t'i llogaritet në dënimin e ri, ndërsa koha gjatë lirimit me kusht nuk llogaritet.
- (4) Dispozitat nga paragrafët 1 deri 3 të këtij neni vlejnë edhe kur personi i liruar me kusht dënohet për veprën penale të cilën e ka kryer para lirimit me kusht.
- (5) Kur personi i dënuar i liruar me kusht dënohet me jo më shumë se një vit burgim, ndërsa gjykata nuk e urdhëron revokimin e lirimit me kusht, lirimi me kusht vazhdohet për atë kohë sa i dënuari e ka mbajtur dënimin e tillë me burgim.

KAPITULLI VII: KONFISKIMI I DOBISË PASURORE TË FITUAR ME ANË TË KRYERJES SË VEPRËS PENALE

Neni 82

BAZA E KONFISKIMIT TË DOBISË PASURORE

- (1) Askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale.
- (2) Dobia pasurore nga paragrafi 1 i këtij neni konfiskohet me aktgjykim të gjykatës me të cilin është konstatuar kryerja e veprës penale sipas kushteve të parapara me këtë Kod.

Neni 83

MËNYRA E KONFISKIMIT TË DOBISË PASURORE

- (1) Kryerësit i konfiskohen të gjitha të hollat, sendet me vlerë dhe çdo dobi tjetër pasurore që është fituar me kryerjen e veprës penale, ndërsa në rastet kur konfiskimi nuk është i mundshëm, kryerësi detyrohet të paguajë shumën e të hollave e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore. Sipas nevojës, gjykata mund të lejojë që të hollat të paguhen në këste gjatë një periudhe e cila nuk i tejkalon dy vite.
- (2) Çfarëdo dobie pasurore e fituar me anë të kryerjes së veprës penale mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompenzim ose me kompenzim që nuk i përgjigjet vlerës reale nëse ai e ka ditur apo ka mund ta dijë se dobia pasurore është fituar me anë të kryerjes së veprës penale. Nëse dobia pasurore është bartur te të afërmit e ngushtë, ajo konfiskohet prej tyre nëse nuk ofrojnë prova se si kompenzim e kanë dhënë vlerën e plotë.

Neni 84

KËRKESAT PASURORE JURDIKE TË TË DËMTUARËVE

- (1) Kur me procedurë penale i caktohet dëmi pasuror palës së dëmtuar, gjykata urdhëron konfiskimin e dobisë pasurore, nëse ajo e tejkalon shumën e dëmeve pasurore, që i është caktuar palës së dëmtuar.
- (2) Pala e dëmtuar, e cila gjatë procedurës penale është udhëzuar të fillojë procedurën e kontestit civil për kërkesën pasurore juridike mund të kërkojë kompensim nga dobia pasurore e konfiskuar, nëse e fillon procedurën e kontestit civil brenda afatit prej gjashtë muaj nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është udhëzuar ngritja e procedurës së kontestit civil dhe nëse kërkon kompenzim nga dobia pasurore e konfiskuar brenda afatit prej tre muajve nga dita kur vendimi gjyqësor për vendosjen e kërkesës pasurore juridike është bërë i plotfuqishëm.
- (3) Pala e dëmtuar, e cila gjatë procedurës penale nuk e ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, mund të kërkojë kompenzim nga vlera e dobisë pasurore të konfiskuar nëse e ka ngritur procedurën e kontestit civil në afatin prej tre muajve nga dita kur ai ka mësuar për aktgjykimin se i konfiskohet dobia pasurore dhe më së voni në afatin prej dy vjetësh nga plotfuqishmëria e vendimit mbi konfiskimin e dobisë pasurore, dhe nëse ajo ka kërkuar kompenzim nga vlera e dobisë pasurore të konfiskuar brenda afatit prej tre muaj nga dita kur vendimi për caktimin e dobisë pasurore është bërë i plotfuqishëm.

Neni 85

KONFISKIMI I DOBISË PASURORE NGA PERSONAT JURIDIKË

Nëse me anë të kryerjes së veprës penale të kryerë nga ana e kryerësit përfiton dobi pasurore një organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik, kjo dobi pasurore e organizatës së biznesit ose e personi juridik konfiskohet.

KAPITULLI VIII: REHABILITIMI DHE ZBULIMI I TË DHËNAVE NGA DOSJA PENALE

Neni 86

POZITA JURIDIKE E PERSONAVE TË DËNUAR PAS MBAJTJES SË DËNIMIT, LIRIMIT OSE PARASHKRIMIT TË DËNIMIT

(1) Pas mbajtjes së dënimit me burgim, në varësi të faljes ose amnistisë së parashkrimit të dënimit, personi i dënuar i gëzon dhe i fiton të gjitha të drejtat e përcaktuara me ligj dhe me dispozita të tjera, duke përfshirë të drejtat e parapara me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, pos rasteve kur me këtë Kod është përcaktuar ndryshe.

(2) Ky nen gjithashtu zbatohet për personin e dënuar i cili është liruar me kusht.

Neni 87

REHABILITIMI LIGJOR

(1) Me rehabilitimin ligjor shlyhet dënimi nga evidenca e personit të dënuar dhe personi i tillë nuk konsiderohet i dënuar.

(2) Dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar pas skadimit të periudhave kohore vijuese, duke vepruar sipas ligjit, nëse personi i dënuar brenda afateve vijuese nuk kryen ndonjë veprë të re penale:

- 1) Një vit nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit në rastin e vërejtjes gjyqësore ose të lirimit nga dënimi;
- 2) Një vit pas ditës së skadimit të periudhës së verifikimit në rastin e dënimit me kusht;
- 3) Një vit nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me amnesti, me falje ose me ndryshim në ligjin penal në rast të dënimit me gjysmëliri;
- 4) Tri vjet pas mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me amnesti, me falje ose me ndryshim të ligjit penal në rastin e dënimit me burgim deri në një vit, dënimit me gjobë ose dënimit plotësues;
- 5) Pesë vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me amnesti, me falje ose me ndryshim të ligjit penal në rastin e dënimit me burgim deri në tri vjet;

- 6) Tetë vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me amnesti, me falje ose me ndryshim të ligjit penal në rastin e dënimit me burgim prej tre deri në pesë vjet;
 - 7) Dhjetë vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me amnesti, me falje ose me ndryshim të ligjit penal në rastin e dënimit me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet;
 - 8) Pesëmbëdhjetë vjet nga dita e mbajtjes së dënimit, parashkrimit ose përfundimit me amnesti, me falje ose me ndryshim të ligjit penal në rastin e dënimit me burgim prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- (3) Dënimi me burgim mbi pesëmbëdhjetë vjet ose me burgimi afatgjatë nuk mund të shlyhet.
- (4) Dënimi nuk mund të shlyhet gjatë kohëzgjatjes së masava të trajtimit të detyrueshëm.

Neni 88

REHABILITIMI GJYQËSOR

Gjykata, me kërkesën e personit të dënuar, mund të vendosë që dënimi t'i shlyhet nga evidenca e personit të dënuar dhe ai konsiderohet i padënuar nëse ka kaluar gjysma e afatit përkatës të paraparë me nenin 87(2) dhe nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe nuk ka kryer veprë të re penale. Me rastin e vendosjes për shlyerjen e dënimit, gjykata merr parasysh sjelljen e personit të dënuar pas mbajtjes së dënimit, natyrën e veprës penale dhe rrethanat e tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin nëse shlyerja e dënimit është me vend.

Neni 89

ZBULIMI I TË DHËNAVE NGA DOSJA PENALE

- (1) Në dosjen penale përfshihet informacioni i mëposhtëm: të dhënat personale mbi kryerësin e veprës penale, informacioni mbi dënimin, vërejtja e gjykatës, masa e trajtimit të detyrueshëm ose lirimi i kryerësit nga dënimi i shqiptuar, ndryshimet në informacionin mbi dënimet që janë futur në dosjen penale dhe informacioni mbi dënimet e mbajtura si dhe mbi shlyerjen e dënimeve të gabueshme.
- (2) Të dhënat nga dosja penale mund të zbulohen vetëm në lidhje me dënimet të cilat janë shlyer dhe mund t'i zbulohen gjykatës, prokurorisë dhe policisë lidhur me procedurën penale e cila është zhvilluar kundër personit i cili më parë ka qenë i dënuar, organeve kompetente përgjegjëse për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe organeve kompetente që marrin pjesë në procedurën e dhënies së amnistisë, faljes apo shlyerjen e dënimeve.
- (3) Të dhënat nga dosja penale, në bazë të kërkesës së arsyetuar, mund t'u zbulohen organeve publike nëse ende janë në fuqi dënimet plotësuese (neni 63(2)) ose masat e trajtimit të detyrueshëm.

- (4) Në rastet kur është shlyer dënimi, të dhënat lidhur me atë dënim mund t'i zbulohen gjykatës, prokurorisë dhe policisë lidhur me procedurën penale e cila është zhvilluar kundër personit të cilit i është shlyer dënimi i përparshëm.
- (5) Askush nuk ka të drejtë të kërkojë nga personi tjetër që t'i ofrojë të dhëna nëse ai ka qenë apo nuk kanë qenë i dënuar.
- (6) Çdo personi, me kërkesën e tij, mund t'i jepen të dhëna për dosjen e tij penale nëse këto të dhëna i nevojiten për realizimin e të drejtave të tij.

KAPITULLI IX: PARASHKRIMI

Neni 90

PARASHKRIMI I NDJEKJES PENALE

- (1) Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme:
- 1) Tridhjetë e pesë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim afatgjatë;
 - 2) Pesëmbëdhjetë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë vjet burgim;
 - 3) Dhjetë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë vjet burgim;
 - 4) Pesë vjet nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se tre vjet burgim;
 - 5) Tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim dhe
 - 6) Dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim ose dënim me gjobë.
- (2) Nëse për veprën penale është paraparë më shumë se një dënim, afati i parashkrimit për ndjekjen penale caktohet sipas dënimit më të rëndë.

Neni 91

FILLIMI DHE NDËRPRERJA E AFATEVE TË PARASHKRIMIT TË NDJEKJES PENALE

- (1) Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale.
- (2) Afati i parashkrimit nuk rrjedh për kohën gjatë të cilës ndjekja nuk mund të fillohet apo të vazhdohet sipas ligjit.
- (3) Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer.

- (4) Afati i parashkrimit ndërpritet po ashtu kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit.
- (5) Pas çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.
- (6) Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Neni 92

PARASHKRIMI I EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE

Përveç rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet kur të kenë kaluar:

- 1) Tridhjetë e pesë vjet nga dënimi me burgim afatgjatë;
- 2) Pesëmbëdhjetë vjet nga dënimi me mbi dhjetë vjet burgim;
- 3) Dhjetë vjet nga dënimi me mbi pesë vjet burgim;
- 4) Pesë vjet nga dënimi me mbi tri vjet burgim;
- 5) Tri vjet nga dënimi me mbi një vit burgim dhe
- 6) Dy vjet nga dënimi me burgim deri në një vit apo dënimi me gjobë.

Neni 93

PARASHKRIMI I EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE PLOTËSUESE DHE I MASAVE TË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM

- (1) Ndalohet ekzekutimi i dënimit me gjobë si dënim plotësues kur të kenë kaluar dy vjet nga dita e aktgjykimit me të cilin ky dënim bëhet i plotfuqishëm.
- (2) Ndalohet ekzekutimi i dënimeve të tjera plotësuese kur të kenë kaluar pesë vite nga dita e aktgjykimit me të cilin ky dënim bëhet i plotfuqishëm.
- (3) Ndalohet ekzekutimi i masës së trajtimit të detyrueshëm kur të kenë kaluar trçji vjet nga dita e aktgjykimit me të cilin kjo masë bëhet e plotfuqishme.

Neni 94

FILLIMI DHE NDËRPRERJA E AFATEVE TË PARASHKRIMIT TË EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT

- (1) Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm, e nëse dënimi alternativ është revokuar, parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin është bërë i plotfuqishëm.
- (2) Afati i parashkrimit nuk rrjedh gjatë kohës kur sipas ligjit ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet.
- (3) Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit.
- (4) Pas çdo ndërprerjeje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.
- (5) Ekzekutimi i dënimit ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës që kërkohet nga ligji për afatin e parashkrimit (ndalimi absolut i ekzekutimit të dënimit).
- (6) Dispozitat nga paragrafi 2 deri te paragrafi 5 i këtij neni zbatohen për ndalimin e ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm.

Neni 95

MOSZBATUESHMËRIA E PARASHKRIMIT TË GJENOCIDIT DHE TË KRIMEVE TË LUFTËS

Nuk zbatohet asnjë afat i parashkrimit mbi ekzekutimin e dënimit për gjenocid, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, si dhe për vepra të tjera penale për të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk mund të zbatohet parashkrimi.

KAPITULLI X: AMNISTIA DHE FALJA

Neni 96

AMNISTIA

- (1) Personave të përfshirë në aktin e amnistisë u jepet lirimi nga ndjekja penale, lirimi i plotë ose i pjesërishtëm nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimi i dënimit të shqiptuar me një dënim më të butë ose shlyerja e dënimit.
- (2) Amnistia përfshin ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, me përjashtim të rasteve kur me aktin e amnistisë është vendosur ndryshe.

Neni 97

FALJA

Me falje, personave të caktuar emrat e të cilëve saktësisht caktohen, u jepet lirimi nga ndjekja penale, lirimi i plotë ose i pjesërishtëm nga ekzekutimi i dënimit, zëvendësimi i dënimit të shqiptuar me një dënim më të butë ose dënimi me kusht a me shlyerje të dënimit.

Neni 98

EFEKTI I AMNISTISË DHE I FALJES NË PERSONAT E TRETË

Me dhënien e amnistisë apo të faljes nuk preken të drejtat e personave të tretë, të cilat bazohen në aktgjykim.

KAPITULLI XI: ZBATIMI I LIGJEVE PENALE TË KOSOVËS SIPAS VENDIT TË KRYERJES SË VEPRËS PENALE

Neni 99

ZBATIMI I LIGJEVE PENALE TË KOSOVËS NDAJ PERSONAVE QË KRYEJNË VEPËR PENALE NË TERRITORIN E KOSOVËS

- (1) Legjislacioni penal i Kosovës zbatohet për secilin person i cili kryen veprë penale në territorin e Kosovës.
- (2) Legjislacioni penal i Kosovës zbatohet ndaj secilit person i cili kryen veprë penale në aeroplan të regjistruar në Kosovë, pavarësisht nga vendi ku ndodhet aeroplani në kohën kur kryhet vepra penale.

Neni 100

ZBATIMI I LIGJEVE PENALE TË KOSOVËS PËR VEPRAT PENALE TË CAKTUARA QË JANË KRYER JASHTË TERRITORIT TË KOSOVËS

- (1) Ligjet penale të Kosovës zbatohen ndaj cilitdo person që kryen jashtë territorit të Kosovës veprë penale të paraparë në nenet 116 – 121, 125 – 128, 132, 133(1), 134 – 137, 139(1), (2) dhe (3), 141 – 143 dhe 244 të këtij Kodi.
- (2) Ligjet penale të Kosovës zbatohen ndaj cilitdo person që kryen veprë penale nga nenet 110 - 113 të këtij Kodi jashtë territorit të Kosovës ku vepra e tillë paraqet tërësisht ose pjesërisht rrezik për sigurinë e Kosovës ose popullsinë e saj.

Neni 101

ZBATIMI I LIGJEVE PENALE TË KOSOVËS NDAJ BANORËVE TË KOSOVËS DHE PERSONAVE TË TJERË TË CILËT KRYEJNË VEPRA PENALE JASHTË TERRITORIT TË KOSOVËS

- (1) Ligjet penale të Kosovës zbatohen ndaj secilit person i cili është banor i Kosovës, nëse personi i tillë kryen veprë penale jashtë territorit të Kosovës dhe nëse kjo veprë po ashtu është e dënueshme në vendin ku është kryer ajo veprë.
- (2) Ligjet penale të Kosovës zbatohen po ashtu ndaj cilitdo person i cili nuk është i një shtetësie të huaj nëse personi i tillë kryen veprë penale jashtë territorit të Kosovës dhe kjo veprë është po ashtu e dënueshme në vendin ku është kryer ajo veprë.
- (3) Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet po ashtu ndaj cilitdo personi i cili pas kryerjes së veprës penale bëhet banor i Kosovës.

Neni 102

ZBATIMI I LIGJEVE PENALE TË KOSOVËS NDAJ TË HUAJVE PËR VEPRAT PENALE TË CILAT I KANË KRYER JASHTË TERRITORIT TË KOSOVËS

Ligjet penale të Kosovës zbatohen ndaj cilitdo personi të një shtetësie të huaj nëse:

- 1) Personi i tillë ka kryer veprë penale jashtë territorit të Kosovës kundër banorit të Kosovës madje edhe atëherë kur vepra e tillë penale nuk është cekur në nenin 100 të këtij Kodi;
- 2) Kjo veprë penale është po ashtu e dënueshme në vendin ku është kryer dhe
- 3) Kryerësi është gjendur në territorin e Kosovës ose ka qenë transferuar në Kosovë.

Neni 103

KUSHTET E POSAÇME PËR NDJEKJE

(1) Për rastet e parapara me nenin 99 të këtij Kodi, nëse është filluar por nuk është përfunduar procedura penale në një juridiksion tjetër, procedura penale në Kosovë do të fillohet vetëm me miratimin e prokurorisë publike të Kosovës.

(2) Për rastet e parapara me nenin 101 dhe nenin 102 të këtij Kodi procedura penale nuk do të fillohet nëse:

- 1) Kryerësi në tërësi e ka mbajtur dënimin e shqiptuar në një juridiksion tjetër;
- 2) Kryerësi në një juridiksion tjetër është liruar me aktgjykim të plotfuqishëm apo është liruar nga dënimi ose dënimi është parashkrirë dhe
- 3) Procedura penale për veprën penale të kryer në një juridiksion tjetër mund të fillohet vetëm sipas kërkesës së të dëmtuarit dhe një kërkesë e tillë nuk është paraqitur.

(3) Vetëm me lejen e prokurorisë publike të Kosovës mund të fillohet procedura penale në Kosovë në pajtim me nenin 105.

(4) Në rastet e parapara në nenin 99, ndjekja penale për një të huaj mund t' i transferohet juridiksionit të huaj sipas kushteve të reciprocitetit.

Neni 104

LLOGARITJA E PARABURGIMIT DHE E DËNIMEVE TË MBAJTURA NË JURIDIKSIONE TË TJERA

Paraburgimi, heqja nga liria gjatë procedurës së transferimit të personit në një juridiksion tjetër dhe pjesa e dënimit të cilin e ka mbajtur kryerësi sipas aktgjykimit të gjykatës së huaj do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar nga gjykata në Kosovë për të njëjtën veprë, e nëse dënimi i shqiptuar jashtë Kosovës nuk është i llojit të njëjtë, llogaritja do të bëhet sipas vlerësimit të gjykatës.

Neni 105

DISPOZITAT E POSAÇME PËR FËMIJËT

Ky Kod zbatohet për personat nën moshën 18-vjeçare vetëm nëse ligji në fuqi për të miturit nuk parasheh ndryshe.

Neni 106

DISPOZITAT E POSAÇME PËR PERSONAT JURIDIKË

Veprat penale për të cilat personi juridik mund të jetë penalisht përgjegjës, përgjegjësia penale e personit juridik, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personit juridik dhe dispozitat e posaçme që e rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik parashihen veçant me ligj.

KAPITULLI XII: DOMETHËNIA E SHPREHJEVE NË KËTË KOD

Neni 107

(1) Shprehja “person zyrtar” do të thotë:

- 1) Personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ publik;
- 2) Personi i autorizuar në një organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit a ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligjin ushtron autoritet publik dhe brenda këtij autoriteti ushtron detyra të posaçme;
- 3) Personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj;
- 4) Personi i cili është anëtar i personelit të UNMIK-ut ose i KFOR-it pa cenuar imunitetin dhe privilegjet e zbatueshme që i janë dhënë atij personi;
- 5) Personi i cili është anëtar i personelit të zyrave të ndërlidhjes në Kosovë;
- 6) Personi në një organizatë publike ndërkombëtare ose mbinacionale i cili njihet si zyrtar ose punonjës tjetër i kontraktuar sipas rregulloreve të personelit të organizatës së tillë;
- 7) Gjykatësi, prokurori ose zyrtari tjetër në gjykatën ndërkombëtare që ushtron juridiksion në Kosovë.

(2) Shprehja “person përgjegjës” do të thotë një individ në një organizatë biznesi ose një person juridik, të cilit, për shkak të funksionit apo autorizimit të posaçëm, i janë besuar detyrat që lidhen me zbatimin e ligjit ose të dispozitave të tjera të nxjerra në bazë të ligjit apo të rregullave të përgjithshme të organizatës së biznesit, ose personat e tjerë juridikë në qeverisjen apo administrimin e pronës, ose në lidhje me udhëheqjen e prodhimit apo ndonjë proces tjetër ekonomik ose mbikëqyrjen e procesit të tillë. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, person zyrtar konsiderohet edhe personi përgjegjës, kur është në pyetje veprimi i cili nuk

është paraparë me dispozitat e kapitullit mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe kundër detyrës tjetër ose me dispozitat e veprave penale të personit zyrtar të parapara në ndonjë kapitull tjetër të këtij Kodi.

(3) Kur një person zyrtar ose person përgjegjës përshkruhet si kryerës i një vepre penale, të gjithë personat e cekur në paragrafët 1 ose 2 të këtij neni mund të jenë kryerës të veprës së tillë penale me kusht që ajo nuk pason nga elementet e veprës penale ku kryerësi mund të jetë vetëm njëri nga ata persona.

(4) Shprehja “person juridik” do të thotë shoqëri aksionare, kompani me përgjegjësi të kufizuar, me partneritet të kufizuar, fond, institucion, organizatë politike ose shoqërore, shoqatë njerëzish si dhe ndonjë organ tjetër ligjor i cili në suaza të punës së tij të rregulltë prodhon ose siguron burime dhe ushtron kontroll mbi ato.

(5) Shprehja “organizatë biznesi” do të thotë person fizik a juridik ose grup i tillë personash që merren me tregti.

(6) Shprehja “dokument” do të thotë çdo send i përshtatshëm ose i caktuar që shërben si provë e ndonjë fakti përkatës për marrëdhëniet juridike.

(7) Shprehja “para” do të thotë monedhë metalike dhe e letrës, e cila në bazë të ligjit është në qarkullim në Kosovë ose në ndonjë juridiksion tjetër.

(8) Shprehja “shenja me vlerë” përfshin edhe shenjat e huaja me vlerë.

(9) Shprehja “send i luajtshëm” përfshin edhe energjinë e prodhuar apo të grumbulluar për ndriçim, ngrohje, qarkullim si dhe impulset telefonike dhe impulset tjera.

(10) Shprehja “dhunë” përfshin edhe zbatimin e hipnozës ose të mjeteve të tjera dehëse me qëllim të vënies së personit kundër dëshirës së vet në gjendje të pavetëdijshme apo të paaftësohet për rezistencë.

(11) Shprehja “mjet motorik” do të thotë çdo mjet transportues i pajisur me motor për përdorim në transportin rrugor, ujor ose ajror.

(12) Shprehja “zyrë e ndërlidhjes” do të thotë zyrë e një qeverie të huajë në Kosovë, që kontribuon në përmbushjen e mandatit që u është dhënë pranive civile dhe të sigurisë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

(13) Shprehja “personel i zyrës së ndërlidhjes” do të thotë personeli i caktuar nga qeveritë e huaja për të shërbyer në zyrat e ndërlidhjes për të kontribuar në përmbushjen e mandatit që u është dhënë pranisë civile dhe të sigurisë sipas Rezolutës. Personeli i tillë, emrat e të cilëve duhet t’i komunikohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm nuk përfshin personelin e punësuar vendor.

(14) Shprehja “personel i UNMIK-ut” do të thotë zyrtarët e Kombeve të Bashkuara, ekspertët dhe personat e tjerë të caktuar për të shërbyer në cilëndo prej komponenteve të UNMIK-ut të cilët posedojnë dokumentin e identifikimit (ID), që tregon se bartësi është anëtar i UNMIK-ut i lëshuar nga ose nën autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

- (15) Shprehja “UNMIK” do të thotë prani ndërkombëtare civile e vendosur në territorin e Kosovës sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, e cila përfshin komponentet e policisë dhe gjyqësisë, komponentet administratës së përkohshme civile (Kombet e Bashkuara), ndërtimit të instucioneve (OSBE) dhe rindërtimin (BE).
- (16) Shprehja “organ publik” do të thotë organ i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ose i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes.
- (17) Shprehja “Kornizë Kushtetuese” do të thotë Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.
- (18) Shprehja “KFOR” do të thotë prani ndërkombëtare e sigurisë e vendosur në territorin e Kosovës në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit që përbëhet nga Pakti i Organizatës së Veriatlantikut, NATO, duke përfshirë shtetet e saj anëtare, organet e saj ndihmëse, Shtabet e saj ushtarake dhe elementet ose njësitet kombëtare si dhe vendet kontribuese që nuk janë në NATO.
- (19) Shprehja “polici” do të thotë Policia Civile e UNMIK-ut, e njohur edhe si Polici e UNMIK-ut dhe si Shërbim Policor i Kosovës.
- (20) Shprehja “banor i Kosovës” do të thotë personi i cili është regjistruar ose ka të drejtë të regjistrohet si banor i përhershëm i Kosovës në Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Regjistrimin Qendror Civil të datës 17 mars 2000.
- (21) Shprehja “fëmijë” do të thotë personi i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet.
- (22) Shprehja “i mitur” do të thotë personi i cili është ndërmjet moshës katërmëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet.
- (23) Shprehja “madhor” do të thotë personi i cili i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet.
- (24) Shprehja “marrëdhënie familiare” do të thotë marrëdhënie mes dy personave:
- 1) Që janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin ose që bashkëjetojnë me njëri-tjetrin pa martesë;
 - 2) Që e kanë të përbashkët shtëpinë kryesore dhe që janë të afërmë të gjakut, martesës, adoptimit ose janë në marrëdhënie të kujdestarit, duke përfshirë prindërit, gjyshin e gjyshen, fëmijët, nipat e mbesat nga vajza dhe djali, vëllezërit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajët dhe axhallarët, mbesat dhe nipat nga vëllai dhe motra, kushërinjtë ose
 - 3) Që janë prindër të fëmijës së përbashkët.
- (25) Shprehja “territor i Kosovës” do të thotë sipërfaqja tokësore dhe sipërfaqet ujore brenda kufijve dhe vijës kufitare si dhe hapësira ajrore mbi Kosovë.

- (26) Shprehja “vijë kufitare e Kosovës” do të thotë vija e ndarjes ndërmjet Kosovës e Serbisë si dhe ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi.
- (27) Shprehja “kufi i Kosovës” do të thotë pjesa e kufirit ndërkombëtarisht e pranuar ndërmjet Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) dhe ndërmjet Republikës Federative të Jugosllavisë dhe Republikës së Shqipërisë.
- (28) Shprehja “armë” do të thotë një mjet i prodhuar që përdoret ose është i përshtatshëm të përdoret për të shkaktuar lëndime trupore. Në mes tjerash, përfshin të gjitha llojet e municionit, shigjetat automatike, harqet, shigjetat, sprejin, gazin lotsjellës, armët me qorrfishkë, armët imituese, armët alivanosëse, taserët (mjetet që punojnë në bazë të elektrohokut) dhe të gjitha kategoritë e armëve të paraqitura në Tabelën A të bashkëngjitur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7 mbi Autorizimin e Posedimit të Armëve në Kosovë ose armë të ngjashme, por nuk kufizohet vetëm me to.
- (29) Shprehja “narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotropike” do të thotë ato substanca të cekura në “Gazetën zyrtare të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë”, nr. 70/78, 14/81, 39/82, 28/85, 10/87, 53/88, 2/89.
- (30) Shprehja “ent shëndetësor” do të thotë spital, spital i autorizuar psikiatrik ose ndonjë ent tjetër i autorizuar për të ofruar trajtim shëndetësor, trajtim psikiatrik dhe trajtim rehabilitimi për narkomani dhe alkoolizëm.

PJESA E POSAÇME**KAPITULLI XIII: VEPRAT PENALE KUNDËR KOSOVËS DHE BANORËVE TË SAJ**

Neni 108

SULMI KUNDËR RENDIT JURIDIK TË KOSOVËS

Kushdo që tenton të ndryshojë rendin juridikë të vendosur në Kosovë me anë të përdorimit të dhunës ose të kanosjes në fushën legjislative, ekzekutive a gjyqësore ose për të përmbysur një organ publik, dënohet me burgim së paku pesë vjet.

Neni 109

PËRKUFIZIMI I TERRORIZMIT

Sipas neneve 110 – 113 të këtij Kodi:

(1) Shprehja “terrorizëm” do të thotë kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullatës, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer çfarëdo vepre apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, ekonomike o sociale të Kosovës, të një vendi ose të një organizate ndërkombëtare, siç janë:

- 1) Vrasja;
- 2) Lëndim i rëndë trupor;
- 3) Marrja peng;
- 4) Rrëmbimi;
- 5) Heqja e paligjshme e lirisë;
- 6) Ndotja e ujit të pijshëm ose e produkteve ushqimore;
- 7) Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm;
- 8) Shkatërrimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike;
- 9) Furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve;
- 10) Mbajtja e paautorizuar e armëve në pronësi, në kontroll, në posedim ose në përdorim;
- 11) Rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht;
- 12) Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to;

- 13) Rrëmbimi i fluturakes;
 - 14) Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil;
 - 15) Rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar;
 - 16) Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental;
 - 17) Përvetësimi, përdormi, transferimi ose deponimi i paautorizuar i materialeve nukleare ose
 - 18) Kërcënimet për përdorimin, për kryerjen e vjedhjes ose të grabitjes së materialeve nukleare.
- (2) Shprehja “fonde” përfshin pasurinë e çfarëdo lloji qoftë e prekshme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që të jetë fituar dhe dokumentet apo instrumentet ligjore të çfarëdo forme, siç janë mjetet elektronike ose digjitale, të dëshmuarit e pronësisë ose të interesit për ato mjete, duke përfshirë në mes të tjerash kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet dhe letërkreditë.
- (3) Shprehja “burime finaciare” përfshin dhënien me qira, objektet e trezorëve, dokumentacionin ose identifikimin e rrejtshëm, shërbimet financiare, pajisjet, personelin, mjetet e transportit, pajisjet e komunikimeve dhe pasurinë tjetër fizike përveç medikamenteve të domosdoshme.
- (4) Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e një veprë dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role zyrtarisht të përcaktuara për anëtarët e tij, kohëzgjatjen e anëtarësisë ose të organizimit të zhvilluar.
- (5) Shprehja “grup terrorist” do të thotë grup i strukturuar prej më shumë se dy personave i themeluar gjatë një periudhe kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit.
- (6) Shprehja “përkrahje grupit terrorist” do të thotë rekrutimi i anëtarëve për një grup terrorist, fshehja e grupit terrorist ose e anëtarëve të tij, pengimi i zbulimit dhe i kapjes së grupit terrorist ose e anëtarëve të tij, sigurimi a mbledhja e fondeve ose e mjeteve të tjera financiare me qëllim, dijeni ose arsye të bazuar për të besuar se ato do të përdoren tërësisht ose pjesërisht nga një grup terrorist.

Neni 110

KRYERJA E VEPRAVE TERRORISTE

- (1) Kushdo që kryen një veprë terroriste dënohet me burgim prej dhjetë deri në njëzet vjet.
- (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore, kryerësi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet.

(3) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekje, kryerësi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim afatgjatë.

Neni 111

NDIHMJA NË KRYERJEN E VEPRAVE TERRORISTE

(1) Nëse vepra nga neni 303 ose 304 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra nga neni 305 i këtij Kodi kryhet në lidhje me terrorizmin, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

(3) Kushdo që e ndihmon kryerësin ose bashkëpjesëmarrësin pas kryerjes së një veprë terroriste, duke i siguruar fonde ose burime të tjera financiare personit të tillë, dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Neni 112

LEHTËSIMI I KRYERJES SË TERRORIZMIT

(1) Kushdo që siguron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde a mjete të tjera materiale që përdoren pjesërisht ose tërësisht me qëllim të kryerjes së terrorizmit dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

(2) Kushdo që nga pakujdesia kryen vepër nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

(3) Kushdo që rekruton një ose më shumë persona me qëllim të kryerjes së terrorizmit dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

(4) Kushdo që me qëllim të kryerjes së terrorizmit siguron a pranon udhëzime ose aftësohet, duke përfshirë aftësimin për ndërtimin, prodhimin ose përdorimin e armëve dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

(5) Kushdo që me qëllim të kryerjes së terrorizmit dërgon ose transferon grupe të armatosura, pajisje, armë ose mjete materiale të tjera në Kosovë ose jashtë saj dënohet me burgim prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 113

ORGANIZIMI, PËRKRAHJA DHE PJESËMARRJA NË GRUPET TERRORISTE

(1) Kushdo që organizon ose udhëheq një grup terrorist dënohet me gjobë deri në 500,000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

(2) Kushdo që i siguron përkrahje një grupi terrorist dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

(3) Kushdo që merr pjesë aktivisht në një grup terrorist dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 114

KALIMI I PAAUTORIZUAR I VENDKALIMEVE KUFITARE OSE I VIJËS KUFITARE

(1) Kushdo që kalon kufirin shtetëror ose atë administrativ të Kosovës në cilindo vend përveç në vendkalimet e autorizuara kufitare dënohet me gjobë prej 250 euro ose me burgim prej tre muajsh.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryerësi i shoqëruar me një fëmijë ose me ndonjë person tjetër, kryerësi dënohet me gjobë prej 2,500 euro ose me burgim deri në një vit.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në njërën apo në më shumë rrethana të mëposhtme kryerësi dënohet me burgim deri në dy vjet nëse:

- 1) Kryerësi ka qenë më parë i dënuar për vepër penale nga ky nen;
- 2) Gjatë kohës së arrestimit fajtori ikën, përpiqet të ikën ose në ndonjë formë i reziston arrestimit nga policia ose KFOR-i;
- 3) Kalimi është bërë ndërmjet orës 8:00 në mbrëmje dhe orës 6:00 në mëngjes gjatë periudhës prej 1 prillit deri më 30 shtator, ose ndërmjet orës 6:00 në mbrëmje deri në orën 6:00 në mëngjes gjatë periudhës prej 1 tetorit deri më 31 mars ose
- 4) Kryerësi posedon armë, municion, rroba ushtarake, furnizime apo pajisje.

(4) Personi nuk përgjigjet penalisht sipas këtij neni për kalimin në një pikë kufitare të paaautorizuar të kufirit shtetëror ose administrativ nëse kalimi ka ndodhur në një vendkalim i cili është hapur përkohësisht nga Komandanti i KFOR-it.

(5) Kurrfarë procedure penale që përfshin veprën penale nga ky nen nuk mund të fillohet apo të vazhdohet kundër asnjë refugjati në mirëbesim ose kundër personit të zhvendosur brenda vendit që vjen nga territori ku jeta e tij, trupi a liritë fundamentale ose të drejtat janë të rrezikuara, me kusht që ai t'i jetë paraqitur policisë së KFOR-it brenda një kohe të arsyeshme dhe të tregojë arsye bindëse për kalimin e vendkalimit të paaautorizuar të kufirit shtetëror ose administrativ.

Neni 115

NXITJA E URREJTJES, E PËRÇARJES OSE E MOSDURIMIT KOMBËTAR, RACOR, FETAR A ETNIK

(1) Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike a çfarëdo grupesh të tjera të tilla që jetojnë në Kosovë në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që në mënyrë sistematike kryen vepër nga paragrafi 1 i këtij neni ose keqpërdorur pozitën a autorizimet apo shkakton trazira, dhunë a pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë dënohet me burgim deri në tetë vjet.

(3) Kushdo që kryen veprë nga paragrafi 1 përmes detyrimit, rrezikimit të sigurisë duke i përqeshur simbolet kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(4) Kushdo që në mënyrë sistematike kryen veprë nga paragrafi 3 i këtij neni ose keqpërdor pozitën, autoritetin e tij apo shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

KAPITULLI XIV: VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

Neni 116

GJENOCIDI

Kushdo që me qëllim të asgjësimit të tërësishëm apo të pjesërishëm të ndonjë grupi nacional, etnik, racor apo fetar si të tillë kryen njërin ose më shumë nga veprimet e mëposhtme, si:

- 1) Vrasjen e anëtarëve të grupit;
- 2) Shkaktimin e dëmeve të rënda trupore apo mendore të anëtarëve të grupit;
- 3) Vënien e qëllimshme të grupit në kushte të tilla të jetës të cilat shpiejnë në shfarosje të plotë apo të pjesërishme fizike;
- 4) Vënien e masave me qëllim që të pengohen lindjet brenda grupit;
- 5) Transferimin me dhunë të fëmijëve të grupit në një grup tjetër

dënohet me së paku 5 vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

Neni 117

KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT

(1) Kushdo që kryen një ose më shumë nga veprat e mëposhtme duke e ditur se ato janë pjesë të një sulmi të gjerë apo sistematik drejtuar kundër popullsisë civile, si:

- 1) Vrasje;
- 2) Shfarosje;
- 3) Skllavërim;
- 4) Deportim ose përzënie me dhunë të popullsisë;
- 5) Burgosje ose privime të tjera të rënda të lirisë fizike në kundërshtim me rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare;
- 6) Torturë;

- 7) Dhunim, skllavëri seksuale, prostitucion të detyruar, shtatzëni me dhunë, sterilizim të detyruar ose cilëndo formë tjetër po aq të rëndë të dhunës seksuale;
- 8) Persekutim të një grupi ose kolektivi të identifikuar për arsye politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore, fetare, gjinore apo në ndonjë baze tjetër e cila është universalisht e njohur si e palejueshme sipas të drejtës ndërkombëtare në lidhje me veprat nga ky nen dhe nenet 116, 118 – 121;
- 9) Zhdukja e detyruar e personave;
- 10) Krimin e apartheidit;
- 11) Vepra të tjera çnjerëzore të karakterit të ngjashëm që shkaktojnë qëllimisht vuajtje të rënda, lëndime të rënda të trupit ose të shëndetit fizik apo mendor

dënohet me së paku 5 vjet burgim ose burgim afatgjatë.

(2) Sipas këtij neni,

- 1) Shprehja “sulm i drejtuar kundër cilësdo popullsie civile” do të thotë një mënyrë veprimi që përfshin kryerjen e shumëfishtë të veprave kundër cilësdo popullate civile të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, në pajtim apo me përkrahje të një shteti apo politike të organizuar për të kryer një sulm të tillë.
- 2) Shprehja “shfarosje” përfshin shkaktimin me qëllim të kushteve jetësore, ndër të tjera privimin e qasjes në ushqim dhe barna si pasojë e të cilave llogaritet se do të sjellin zhdukjen e një pjese të popullsisë.
- 3) Shprehja “skllavërim” do të thotë ushtrimi i një kompetence ose i të gjitha kompetencave që lidhen me të drejtën e pronësisë mbi një person, duke përfshirë ushtrimin e një kompetence të tillë në trafikimin e njerëzve, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve.
- 4) Shprehja “deportim apo transferim me dhunë i popullsisë” do të thotë zhvendosje me dhunë të personave të caktuar me anë të dëbimit apo të akteve të tjera detyruese nga zona ku ata banojnë në mënyrë të ligjshme, pa arsye të cilat lejohen sipas të drejtës ndërkombëtare.
- 5) Shprehja “torturë” do të thotë shkaktimi i qëllimshëm i dhembjes apo i vuajtjes së rëndë fizike apo mendore mbi një person i cili është i ndaluar ose është nën kontrollin e kryerësit, me përjashtim të rastve kur tortura nuk përfshin dhembjen dhe vuajtjen që rezulton vetëm nga sanksionet e ligjshme, karakteristike ose aksidentale për to.
- 6) Shprehja “shtatzani e detyruar” do të thotë mbyllje e paligjshme e gruas të lënë shtatzënë me dhunë, me qëllim që të ndikojë në përbërjen etnike të çfarëdo popullate ose duke kryer shkelje të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare.

- 7) Shprehja “persekutim” do të thotë privimi i rëndë dhe me dashje i të drejtave themelore për shkak të identitetit të grupit apo kolektivitetit në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.
- 8) Shprehja “krim i apartheidit” do të thotë akte çnjerëzore që kanë karakter të ngjashëm me ato të parapara në paragrafin 1 të këtij neni të kryera në kontekstin e një regjimi të institucionalizuar të shtypjes dhe sundimit sistematik nga një grup racial mbi një grup tjetër racial ose grupe të tjera dhe që kryhen me qëllim të mbajtjes së atij regjimi.
- 9) Shprehja “Zhdukja e detyruar e personave” do të thotë arrestim, paraburgim ose rrëmbim i personave me përkrahjen apo me autorizimin ose me pajtimin e shtetit apo të një organizate politike, shoqëruar me refuzimin e atij autoriteti ose organizate për të pranuar atë privim të lirisë ose për të dhënë informacione mbi fatin apo mbi të dhënat e personave të tillë me qëllim që këta persona të mos gëzojnë mbrojtje për një periudhë të zgjatur kohore të paraparë me ligj.
- 10) Shprehja “gjini” i referohet të dy gjinive, mashkullit dhe femrës, brenda kontekstit të shoqërisë.

Neni 118

KRIMET E LUFTËS NË KUNDËRSHTIM TË RËNDË ME KONVENTAT E GJENEVËS

(1) Kushdo që shkel rëndë Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dënohet me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë për veprat penale nga pikat 4, 5 ose 7 të paragrafit 2 të këtij neni, apo me burgim prej së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë për veprat penale nga pikat 1, 2, 3, 6 ose 8 të paragrafit 2 të këtij neni.

(2) Shkelje e rëndë e Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 do të thotë një a më shumë prej veprimeve vijuese të kryera gjatë kohës së luftës apo konfliktit të armatosur kundër njerëzve ose pronës që janë të mbrojtura me dispozita përkatëse të Konventave të Gjenevës, si:

- 1) Vrasja me qëllim;
- 2) Tortura ose trajtimi çnjerëzor, duke përfshirë eksperimentet biologjike;
- 2) Shkaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha ose i dëmtimeve të rënda trupore apo shëndetësore;
- 4) Shkatërrimi masiv dhe marrja e pajustificueshme e pronës për nevojat ushtarake e kryer në mënyrë të paligjshme dhe me dashje;
- 5) Detyrimi i një robi lufte ose një personi tjetër të mbrojtur për të shërbyer në forcat e armikut;
- 6) Privimi i qëllimshëm i të drejtës për gjykim të drejtë dhe të rregullt për robërit e luftës apo personat e tjerë të mbrojtur;

- 7) Deportimi i paligjshëm, transferimi ose mbyllja e paligjshme;
- 8) Marrja e pengjeve.

Neni 119

KRIMET E LUFTËS SI SHKELJE E RËNDË E LIGJEVE DHE E ZAKONEVE QË ZBATOHEN NË KONFLIKTIN E ARMATOSUR NDËRKOMBËTAR

(1) Kushdo që i shkel rëndë ligjet dhe zakonet që zbatohen në konfliktet e armatosura ndërkombëtare brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare dënohet me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë për veprat penale nga pikat 9, 13, 14, 15, 16, 26, 29, 30 ose 31 të paragrafit 2 të këtij neni, ose me burgim së paku dhjetë vjet apo me burgim afatgjatë për veprat penale nga pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 27 ose 28 të paragrafit 2 të këtij neni.

(2) Shkelja e rëndë e ligjeve dhe e zakoneve që zbatohen për konfliktet e armatosura ndërkombëtare, brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare nënkupton një ose më shumë nga veprimet vijuese:

- 1) Sulmet e drejtuara me qëllim kundër popullatës civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në armiqësi;
- 2) Sulmet e drejtuara me qëllim kundër objekteve civile që nuk janë objektiva ushtarake;
- 3) Sulmet e drejtuara me qëllim kundër personelit, instalimeve, materialeve, njërive ose automjeteve të përfshira në misionet e ndihmës humanitare ose paqeruajtëse në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara për aq kohë sa gëzojnë të drejtën për mbrojtjen e atyre civilëve ose objekteve civile sipas të drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura;
- 4) Fillimi i sulmit të qëllimshëm, duke ditur se sulmi i tillë do të shkaktojë humbje aksidentale të jetës ose plagosje të civilëve, dëme të objekteve civile apo dëme masive, dëme afatgjate dhe të rënda ndaj mjedisit natyror, që do të ishte haptazi tejkallim sa i përket përparësisë së gjithmbarshme konkrete dhe të drejtpërdrejtë të parashikuar ushtarake;
- 5) Sulme ose bombardime të qyteteve, fshatrave, banesave ose ndërtesave të pambrojtura me çfarëdo lloj mjetes dhe që nuk janë objektiva ushtarake;
- 6) Vrasja ose plagosja e luftëtarit i cili është dorëzuar në mëshirë pasi ka dorëzuar armët ose që nuk ka më mjete mbrojtëse;
- 7) Përdorimi i papërshtatshëm i flamurit të armëpushimit, i flamurit apo i shenjave dhe i uniformave ushtarake të armikut apo të Kombeve të Bashkuara ose i emblemave dalluese të Konventave të Gjenevës, që kanë si pasojë vdekjet ose plagosjet e rënda;

- 8) Transferimi direkt ose indirekt nga forcat pushtuese i pjesëve të popullatës së vet civile në territorin që e pushton, ose deportimi a transferimi i tërësishëm apo i pjesërishtëm i popullatës së territorit të pushtuar brenda a jashtë këtij territori;
- 9) Drejtimi me qëllim i sulmeve kundër ndërtesave fetare, shkollore, artistike, shkencore, me qëllime bëmirese, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku janë mbledhur të sëmurët dhe të plagosurit me kusht që të mos jenë objektiva ushtarake;
- 10) Nënshtrimi i personave nën autoritetin e një pale kundërshtare ndaj të cilëve kryhen gjymtime fizike ose eksperimente të ndryshme mjekësore apo shkencore, të cilat nuk arsyetohen në aspektin e trajtimit mjekësor, dental apo spitalor ndaj personit përkatës dhe nuk janë në dobi të tij e që shkaktojnë vdekje apo rrezik serioz ndaj shëndetit të një apo shumë personave të tillë;
- 11) Vrasja apo plagosja dinake e individëve që i përkasin vendit apo ushtrisë armike;
- 12) Deklarimi se nuk do të ketë mëshirë;
- 13) Shkatërrimi apo marrja e pasurisë së armikut përveç rasteve kur kjo kërkohet domosdoshmërisht për nevojat e luftës;
- 14) Deklarimi se abrogohen, suspendohen apo nuk pranohen nga gjykata të drejtat dhe veprimet e pjesëtarëve të kombit që është palë e armikut;
- 15) Detyrimi i qytetarëve të palës armike për të marrë pjesë në operacionet e luftës të drejtuara kundër vendit të tyre, madje edhe nëse kanë qenë palë ndërluftuese para fillimit të luftës;
- 16) Plaçkitja e një qyteti ose e një vendi edhe kur merret me anë të sulmit;
- 17) Përdorimi i helmeve ose i armëve helmuese;
- 18) Përdorimi i gazrave asfiksuese, helmuese ose i llojeve të tjera të gazrave dhe i të gjitha analogeve të lëngshme, materialeve ose mjeteve;
- 19) Përdorimi i plumbave që përhapen apo rrafshohen lehtë në trupin e njeriut, siç janë plumbat me mbulesë të fortë që nuk e mbulojnë plotësisht bërthamën ose janë të çarë me prerje;
- 20) Përdorimi i armëve, projektilave, materialeve dhe metodave të luftimit të një natyre të tillë që shkaktojnë plagosje të tepërta apo vuajtje të panevojshme ose të cilat nuk bëjnë dallim në shkaktimin e këtyrë vuajtjeve, në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për konfliktet e armatosura, duke përfshirë këtu armët kimike, armët biologjike, copëzat e padetektueshme, armët verbuese laserike ose minat mashtruese të përkufizuara në Protokollin II të Konventës mbi Ndalimin ose Kufizimin e Disa Armëve Konvencionale të datës 10 tetor 1980 të cilat konsiderohen se janë jashtëzakonisht dëmtoese ose kanë efekte pa i zgjedhur caqet;

- 21) Kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit personal, veçanërisht trajtimi nënçmues dhe degradues;
- 22) Kryerja e dhunimeve, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzania e dhunshme, steriliteti i detyruar ose ndonjë formë tjetër e dhunës seksuale, e cila përbën gjithashtu shkelje të rëndë të Konventave së Gjenevës;
- 23) Përdorimi i qëllimshëm i prezencës së civilëve ose i personave të tjerë që gëzojnë mbrojtje me qëllim të mbajtjes së disa pikave, zonave apo forcave ushtarake të mbrojtura nga operacionet ushtarake;
- 24) Drejtimi me qëllim i sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportit dhe kundër personelit që përdorin shenjën dalluese të Konventave të Gjenevës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;
- 25) Vënia me qëllim e popullatës civile në gjendje të urisë si metodë lufte, duke privuar ata nga mjetet e domosdoshme për ekzistencën e tyre, duke përfshirë këtu edhe pengimin e qëllimshëm të furnizimeve të parapara me Konventat e Gjenevës;
- 26) Rekrutimi apo mobilizimi i fëmijëve nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare në forcat e armatosura kombëtare ose duke i përdorur ata të marrin pjesë aktivisht në armiqësi;
- 27) Drejtimi me qëllim i sulmeve kundër punimeve ose instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme duke e ditur se sulmi i tillë do të shkaktojë humbje të jashtëzakonshme të jetës, lëndime të civilëve ose dëmtime të objekteve civile;
- 28) Drejtimi me qëllim i sulmeve pa dallim kur sulmi i tillë nuk drejtohet në një objektiv specifik ushtarak, shfrytëzon metoda dhe mjete të luftës të cilat nuk mund të drejtohen në objekte specifike ushtarake ose metoda a mjete të luftës efekti i të cilave nuk mund të kufizohet ashtu siç kërkohet me Protolollin I të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe që, për pasojë, është i një natyre të tillë që godet objektivat ushtarake dhe civile ose objektet civile pa dallim;
- 29) Skllavëria dhe tregtia me robërit;
- 30) Shqiptimi i i dënimeve kolektive;
- 31) Ushtrimi i trysnisë mbi popullatën e një territori të pushtuar për të ndërruar kombësinë e saj ose të bëjnë betimin kundër forcave armike.

Neni 120

KRIMET E LUFTËS PËR SHKELJE TË RËNDË TË NENIT 3 TË PËRBASHKËT ME KONVENTAT E GJENEVËS

(1) Kushdo që shkel rëndë nenin 3, që është i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dënohet me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

(2) Shkelje e rëndë e nenit 3, i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 Gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:

- 1) Dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;
- 2) Kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi degradues;
- 3) Marrja e pengjeve;
- 4) Shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykime paraprake të shpallura nga një gjykatë e rregullt që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat njihen në përgjithësi si të domosdoshme.

(3) Ky nen zbatohet për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar dhe nuk zbatohet për situatat e çrregullimeve dhe tensioneve të brendshme, siç janë për shembull trazirat, veprat sporadike dhe të izoluara të dhunës ose vepra të tjera të natyrës së ngjashme.

Neni 121

KRIMET E LUFTËS TË CILAT PARAQESIN SHKELJE TË RËNDË TË LIGJEVE DHE ZAKONEVE QË ZBATOHEN NË KONFLIKTET E ARMATOSURA QË NUK JANË TË KARAKTERIT NDËRKOMBËTAR

(1) Kushdo që kryen shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve në fuqi gjatë konflikteve të armatosura jo të një karakteri ndërkombëtar brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare dënohet me burgim në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet ose me burgim afatgjatë për veprat penale nga pikat 4, 5, 7, 12, 23 ose 24 të paragrafit 2 të këtij neni dhe me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë për veprat penale nga pikat 1, 2, 3, 6, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 ose 22 të paragrafit 2 të këtij neni.

(2) Shkelje e rëndë e ligjeve dhe e zakoneve në fuqi në konfliktet e armatosura jo të një karakteri ndërkombëtar brenda kornizës së përcaktuar të së drejtës ndërkombëtare do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme:

- 1) Drejtimi i qëllimshëm i sulmeve kundër popullatës civile si të tillë ose kundër civilëve të caktuar që nuk marrin pjesë drejtëpërdrejt në armiqësi;

- 2) Drejtimi i qëllimshëm i sulmeve kundër ndërtesave, materialit, njësive mjekësore dhe transportit, personelit fetar dhe personelit që përdor emblema të dukshme të Konventave së Gjenevës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;
- 3) Drejtim i qëllimshëm i sulmeve kundër personelit, instalimeve, materialeve, njësive ose automjeteve të përfshira në një mision të ndihmës humanitare ose në misionin paqeruajtës në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara për sa kohë që ato përfitojnë mbrojtjen që iu jepet civilëve ose objekteve civile sipas të drejtës ndërkombëtare për konflikte të armatosura;
- 4) Drejtim i qëllimshëm i sulmeve kundër ndërtesave fetare, shkollore, artistike, shkencore ose me qëllime mirëbërëse, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku janë mbledhur të sëmurët dhe të plagosurit, me kusht që të mos jenë objektiva ushtarake;
- 5) Plaçkitja e qytetit ose e një vendi, madje edhe pasi që është pushtuar;
- 6) Kryerja e dhunimeve, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzania e dhunshme, sterilizimi i dhunshëm dhe çdo formë tjetër e dhunës seksuale që po ashtu përbën shkelje të rëndë sipas nenit 3 i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës;
- 7) Rekrutimi ose përfshirja e fëmijëve nën moshën 15 vjet në forcat e armatosura ose në grupe apo shfrytëzimi i tyre për pjesëmarrje në armiqësi të ndryshme;
- 8) Urdhërimi për zhvendosja e popullatës civile për shkaqet që lidhen me konfliktin, përveç kur kjo kërkohet për shkak të sigurisë civile ose për shkaqe imperative ushtarake;
- 9) Vrasja ose plagosja tradhtisht e luftëtarit kundërshtar;
- 10) Deklarimi se nuk do të ketë aspak mëshirë;
- 11) Shkaktimi i gjymtimeve fizike ose i eksperimenteve mjekësore a shkencore të çdo lloji ndaj personave nën autoritetin e palës tjetër në konflikt, të cilat as nuk justifikohen si trajtim mjekësor, dentar apo spitalor ndaj personit përkatës e as nuk bëhen në interes të tij dhe që shkaktojnë vdekje apo rrezikojnë rëndë shëndetin e personit apo personave të tillë;
- 12) Shkatërrimi ose e marrja e pasurisë së armikut, pos kur kjo kërkohet domosdoshmërisht nga nevojat e konfliktit;
- 13) Sulmi ose bombardimi me çfarëdo mjete i qyteteve, fshatrave, vendbanimeve ose ndërtesave që janë të pambrojtura dhe të cilat nuk janë objektiva ushtarake;
- 14) Drejtimi i qëllimshëm i sulmeve kundër objekteve civile, objekteve të cilat nuk janë objektiva ushtarake;
- 15) Fillimi i qëllimshëm i sulmit, duke ditur se sulmi i tillë do të shkaktojë humbje aksidentale të jetës ose plagosje të civilëve apo dëme të objekteve civile a dëme

massive afatgjata dhe të rënda ndaj mjedisit natyror, që do të ishte qartazi tejkalim në lidhje me përparësinë e gjithmbarshme konkrete dhe të drejtpërdrejtë ushtarake të parashikuar;

- 16) Fillimi i qëllimshëm i sulmeve pa dallim kur sulmi i tillë nuk drejtohet në një objektiv specifik ushtarak shfrytëzon metoda dhe mjete të luftës të cilat nuk mund të drejtohen në objekte specifike ushtarake ose metoda a mjete të luftës efekti i të cilave nuk mund të kufizohet dhe që për pasojë janë të një natyre të tillë që godasin objektivat ushtarake dhe civilët ose objektet civile pa dallim;
- 17) Shfrytëzimi i pranisë së civilit ose të një personi tjetër të mbrojtur për të siguruar pikat, zonat ose forcat e caktuara ushtarake imune ndaj operacioneve ushtarake;
- 18) Shfrytëzimi i qëllimshëm i urisë së civilëve si metodë lufte përmes privimit të tyre nga mjetet e domosdoshme për ekzistencën e tyre, duke përfshirë këtu edhe pengimin e qëllimshëm të furnizimeve me ndihmë, siç parashihet me Konventat e Gjenevës;
- 19) Përdorimi i helmeve apo i armëve helmuese;
- 20) Përdorimi i gazrave asfiksuese, helmuese ose i llojeve të tjera të gazrave dhe i të gjitha analogeve të lëngshme, materialeve ose mjeteve;
- 21) Përdorimi i plumbave që përhapen apo rrafshohen lehtësisht në trupin e njeriut, siç janë plumbat me mbulesë të fortë që nuk e mbulojnë plotësisht bërthamën ose që thërmohen me copëza;
- 22) Përdorimi i armëve, projekteve, materialeve dhe metodave të luftimit të një natyre të tillë që shkaktojnë plagosje të tepërta apo vuajtje të panevojshme ose që nuk bëjnë dallim në shkaktimin e këtyrë vuajtjeve në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për konfliktet e armatosura, ku përfshihen armët kimike, armët biologjike, fragmentet e padetektueshme, armët verbuese laserike, minat e këmbësoresë të përkufizuara në Protokollin II të Konventës mbi Ndalesat dhe Kufizimet e Përdorimit të Disa Armëve Konvencionale të datës 10 tetor 1980, që mund të vlerësohen si jashtëzakonisht dëmtoese apo që kanë efekt pa dallim;
- 23) Skllavëria dhe tregtia me skllavër dhe
- 24) Shqiptimi i dënimeve kolektive.

(3) Ky nen vlen për konfliktet e armatosura të një karakteri jondërkombëtar dhe nuk vlen për situatat e turbullirave dhe të tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, aktet sporadike dhe të izoluar të dhunës ose aktet e tjera të natyrës së ngjashme. Neni vlen për konfliktet e armatosura që ndodhin në territorin e një shteti kur ekziston një konflikt i armatosur i zgjatur midis organeve të pushtetit dhe grupeve të organizuara të armatosura ose midis grupeve të tilla.

Neni 122

SULMET NË KONFLIKTET E ARMATOSURA TË NJË KARAKTERI JONDËRKOMBËTAR KUNDËR INSTALIMEVE QË PËRMBAJNË FORCA TË RREZIKSHME

Kushdo që në kundërshtim me ligjet dhe me zakonet në fuqi në konfliktet e armatosura të një karakteri jondërkombëtar, me qëllim kryen sulm kundër punimeve ose instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme me dijeninë se një sulm i tillë do të shkaktojë humbje të mëdha jetësh, lëndime për civilët ose dëme në objektet civile dënohet me burgim prej së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë.

Neni 123

REKRUTIMI DHE REGJISTRIMI I PERSONAVE MIDIS MOSHËS PESËMBËDHJETË DHE TETËMBËDHJETË VJET NË KONFLIKTIN E ARMATOSUR

Kushdo që rekruton ose regjistron personat midis moshave pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet në forcat e armatosura ose në grupe apo i shfrytëzon ata për pjesëmarrje aktive armiqësore në një konflikt të armatosur të një karakteri ndërkombëtar ose në ndonjë konflikt të armatosur të një karakteri jondërkombëtar dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Neni 124

PËRDORIMI I MJETEVE OSE I METODAVE TË NDALUARA TË LUFTIMIT

(1) Kushdo që gjatë konfliktit të armatosur përdor armë, projektila dhe material e metoda të luftimit të cilat nuk parashihen me nenin 119(2)(20) ose nenin 121(2)(22) të këtij Kodi dhe që janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për konfliktet e armatosura dënohet me burgim prej së paku pesë vjetësh.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej së paku pesë vjetësh ose me burgim afatgjatë.

Neni 125

SHTYRJA E PAARSYESHME E RIATDHESIMIT TË ROBËRVE TË LUFTËS OSE E CIVILËVE

Kushdo që shkel rregullat e së drejtës ndërkombëtare, urdhëron apo shqipton shtyrjen e paarsyeshme për riatdhësimin e robërve të luftës apo të civilëve pas përfundimit të luftës ose të konfliktit të armatosur dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Neni 126

PËRVETËSIMI I KUNDËRLIGJSHËM I SENDEVE NGA TË VDEKURIT OSE TË PLAGOSURIT NË FUSHËBETEJË

(1) Kushdo që urdhëron të përvetësohen në mënyrë të paligjshme sendet nga të vrarët apo të plagosurit në fushëbetejë apo kushdo që kryen marrje të tillë dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në mënyrë barbare, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 127

RREZIKIMI I NEGOCIATORËVE

Kushdo që, duke e shkelur të drejtën ndërkombëtare gjatë kohës së luftës apo të konfliktit të armatosur, e ofendon, e keqtrajton ose e ndalon negociatorin apo përcjelljen e tij ose ua pengon kthimin apo në mënyrë tjetër e cenon paprekshmërinë e tyre, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 128

ORGANIZIMI I GRUPEVE PËR KRYERJEN E GJENOCIDIT, KRIMEVE KUNDËR NJERËZIMIT DHE KRIMEVE TË LUFTËS

(1) Kushdo që organizon një grup me qëllim të kryerjes të cilësdo vepër penale të paraparë në nenet prej 116 deri 124 të këtij Kodi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Kushdo që bëhet anëtar i grupit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(3) Anëtari i grupit nga paragrafi 1 i këtij neni që e paraqet grupin para se të ketë kryer vepër penale në llogari të grupit ose e ka ndihmuar grupin për kryerjen e veprës penale dënohet me burgim deri në tri vjet, por gjykata edhe mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 129

PËRGJEGJËSIA E KOMANDËS

(1) Komandanti ushtarak ose personi i cili realisht vepron si komandant ushtarak është penalisht përgjegjës për krimet e cekura në nenet 116 deri 124 të këtij Kodi të kryera nga forcat nën komandën dhe kontrollin e tij të vërtetë ose nën autoritetin dhe kontrollin e vërtetë si rezultat i dështimit të tij për të ushtruar kontrollin e duhur mbi forcat e tilla ku:

- 1) Ai komandant ushtarak a person ose e ka ditur ose për shkak të rrethanave të asaj kohe është dashur të dijë se ato forca kanë kryer ose janë përgatitë të kryejnë krime të tilla dhe
- 2) Ai komandant ushtarak ose person nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij për të parandaluar ose për të ndaluar kryerjen e tyre apo për të dorëzuar çështjen te organeve kompetente për hetim dhe ndjekje.

(2) Në lidhje me marrëdhëniet e eprorëve dhe të vartësve të tyre që nuk janë përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni, eprori është penalisht përgjegjës për krimet e cekura në nenet 116 deri 127 të këtij Kodi të kryera nga vartësit nën autoritetin dhe kontrollin e vërtetë të tij si rezultat i dështimit të tij për të ushtruar kontrollin e duhur mbi vartësit e tillë ku:

- 1) Eprori ose e ka ditur ose me vetëdije nuk e ka përfillur informacionin i cili ka treguar qartë se vartësit e tij kanë kryer ose kanë dashur të kryejnë krime të tilla;
- 2) Krimet kanë pasur të bëjnë me aktivitetet që kanë qenë brenda përgjegjësisë dhe kontrollit të vërtetë të vartësit dhe
- 3) Eprori nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij për të parandaluar a për të ndaluar kryerjen e tyre ose t'ia dorëzoi çështjen organeve kompetente për hetim dhe ndjekje.

Neni 130

SHTYTJA PËR LUFTË AGRESIVE OSE KONFLIKT TË ARMATOSUR

Kushdo që në mënyrë publike, në tubim ose me anë të shkrimeve, inçizimeve audiovizuale, ose në ndonjë mënyrë tjetër thërret ose nxit për luftë agresive apo konflikt të armatosur, dënohet me burgim prej një deri në tre vjet.

Neni 131

KEQPËRDORIMI I EMBLEMAVE NDËRKOMBËTARE

Kushdo që keqpërdor ose mban pa autorizim flamurin a emblemën e Kombeve të Bashkuara, të Kryqit të Kuq ose të Shoqërisë së Hënës së Kuqe apo simbolet që korrespondojnë me to, madje çfarëdo embleme tjetër ndërkombëtare që njihet si mbrojtje e objekteve të caktuara nga operacionet ushtarake, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 132

RRËMBIMI I FLURURAKES

(1) Kushdo që në kundërshtim me Konventën mbi ndalimin e rrëmbimit të kundërligjshëm të fluturakes të datës 16 dhjetor 1970 në fluturake përvetëson ose kontrollon në mënyrë të paligjshme fluturaken me dhunë ose me kanosje a në ndonjë mënyrë tjetër kërcënuese dënohet me së paku një vit burgim.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni shkakton vdekjen e një apo më shumë personave ose bën shkatërrimin e fluturakes, kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(3) Kushdo i cili me dashje privon personin tjetër nga jeta me kryerjen e veprës nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

Neni 133

RREZIKIMI I SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL

(1) Kushdo i cili në kundërshtim me Konventën mbi ndalimin e akteve të kundërligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil të datës 23 shtator 1971 kryen një veprë e cila rrezikon sigurinë e aviacionit civil dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Akt i rrezikimit të sigurisë së aviacionit civil do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme:

- 1) Kryerja e një akti të dhunës kundër personit drejtues të aeroplanit në fluturim nëse ajo vepër ka gjasë të rrezikojë sigurinë e aeroplanit;
- 2) Shkatërrimi i fluturakes në funksionim e sipër ose shkaktimi i dëmit i cili e bën fluturaken të paaftë për fluturim apo që ka gjasë të rrezikojë sigurinë e tij të fluturimit;
- 3) Vendosja ose shkaktimi i vendosjes në aeroplan i çfarëdo mjeteve a substance që ka gjasë për ta shkatërruar aeroplanin ose për t'i shkaktuar dëm që e bën atë të paaftë për fluturim ose i shkakton dëm që ka gjasë të rrezikojë sigurinë e tij gjatë fluturimit;
- 4) Shkatërrimi ose dëmtimi i pajimeve të navigacionit ajror ose ndërhyja në punën e tyre nëse cilido nga aktet e tilla ka gjasë të rrezikojë sigurinë e fluturakes gjatë fluturimit;
- 5) Kumbimi i informacionit për të cilin kryerësi e di se është i rrejshëm me çka rrezikon sigurinë e fluturakes gjatë fluturimit;
- 6) Kryerja e një akti të dhunës kundër personit në aeroport në shërbim të aviacionit civil ndërkombëtar, që shkakton ose ka gjasë të shkaktojë lëndime të rënda ose vdekje;
- 7) Shkatërrimi ose dëmtimi i rëndë i pajimeve të aeroportit që i shërben aviacionit civil ndërkombëtar ose fluturakes që nuk është në shërbim, i vendosur aty ose ndërpreja e shërbimeve të aeroportit, nëse akti i tillë rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë sigurinë në atë aeroport.

(3) Kushdo që e drejton fluturaken në një mënyrë jo të rregullt ose nuk i kryen detyrat dhe nuk e bën mbikëqyrjen në lidhje me sigurinë e aviacionit civil dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(4) Kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave ose me shkatërrimin e fluturakes, kryerësi dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.

(5) Kushdo i cili me qëllim e privon personin tjetër nga jeta duke kryer vepër nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni, dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

(6) Kushdo që nga pakujdesia kryen vepër penale nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni dënohet me burgim deri në tre vjet.

(7) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave ose me shkatërrimin e fluturakes, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 134

RREZIKIMI I SIGURISË SË LUNDRIMIT DETAR

- (1) Kushdo i cili në kundërshtim me Konventën mbi ndalimin e akteve të kundërligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar të datës 10 mars 1988 kryen një akt të rrezikimit të sigurisë së lundrimit detar, dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (2) Akt i rrezikimit të sigurisë së lundrimit detar do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme:
- 1) Pushtimi i anijes ose ushtrimi i kontrolli mbi të me dhunë a me kërcënim apo me çfarëdo forme të frikësimit;
 - 2) Kryerja e një akti të dhunës kundër një personi drejtues të anijes nëse ai akt ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të asaj anijeje;
 - 3) Shkatërrimi i anijes ose shkaktimi i dëmit anijes ose i ngarkesës që ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të asaj anijeje;
 - 4) Vendosja ose mundësimi i vendosjes në anije të çfarëdo mjeti a substancës që ka gjasë për ta shkatërruar atë anije ose për të shkaktuar dëm asaj a ngarkesës së saj që rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të asaj anijeje;
 - 5) Shkatërrimi ose dëmtimi i rëndë i pajimeve të navigacionit detar apo ndërhyrja e rëndë në operimin e tyre nëse një akt i tillë ka gjasë të rrezikojë lundrimin e sigurt të anijes;
 - 6) Komunikimi i informacionit për të cilin kryerësi e di se është i rrejtshëm me çka rrezikon lundrimin e sigurt të anijes.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave ose me shkatërrimin e anijes, kryerësi dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.
- (4) Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin tjetër duke kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.
- (5) Kushdo që nga pakujdesia kryen vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim deri në tre vjet.
- (6) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni ka pasojë vdekjen e një ose më shumë personave ose shkatërrimin e anijes, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 135

RREZIKIMI I SIGURISË SË PLATFORMAVE FIKSE TË VENDOSURA NË PRAGUN KONTINENTAL

(1) Kushdo që duke shkelur Protokollin mbi ndalimin e akteve të kundërligjshme ndaj sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental të 10 marsit 1988 kryen një veprë me të cilën rrezikon sigurinë e platformave fikse të vendosura në pragun kontinental dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Akt i rrezikimit të sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme:

- 1) Pushtimi ose ushtrimi i kontrollit mbi platformat fikse të vendosura në pragun kontinental ose çfarëdo forme tjetër e frikësimit;
- 2) Kryerja e një akti të dhunës kundër personit drejtues të platformës fikse nëse ai akt ka gjasë të rrezikojë sigurinë e saj;
- 3) Shkatërrimi i platformës fikse ose shkaktimi i dëmit i cili ka gjasë të rrezikojë sigurinë e saj;
- 4) Vendosja ose mundësimi i vendosjes në platformën fikse, me çfarëdo mjeti qoftë të mjetit ose të substancës që ka gjasë për të shkatërruar atë platformë fikse ose që ka gjasë të rrezikojë sigurinë e saj.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave a me shkatërrimin e platformës fikse, kryerësi dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.

(4) Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin tjetër duke kryer veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

(5) Kushdo që nga pakujdesia kryen veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim deri në tre vjet.

(6) Kur vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni shkakton vdekjen e një ose më shumë personave ose shkatërron platformën fikse, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(7) Kushdo i cili me qëllim të detyrimit të personit juridik ose fizik për të kryer ose për të moskryer ndonjë veprim, kanoset se do të kryejë veprë penale nga pika 2 ose 3 e paragrafit 2 të këtij neni, dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(8) Sipas këtij neni shprehja “platformë fikse” do të thotë ishull artificial, instalim ose godinë përherë e ngjitur për fundin e detit me qëllim të hulumtimit dhe të shfrytëzimit të pasurive ose për qëllime të tjera ekonomike.

Neni 136

PIRATËRIA

- (1) Anëtari i ekuipazhit ose udhëtari i anijes ose fluturakes, pos për anijen apo fluturaken ushtarake apo publike, i cili, duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare, me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjell pëfitime materiale a jomateriale ose të plagosjes serioze të personit tjetër, kryen dhunë të kundërligjshme ndaj anijes a fluturakes tjetër ose kundër personit ose kundër një sendi në anije a në fluturake në det të hapur apo në territorin i cili nuk është nën juridiksion të ndonjë shteti, dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (2) Veprimi i kryer nga anëtari i ekuipazhit të anijes ose i fluturakes ushtarake a publike i cili është rebeluar dhe ka uzurpuar autoritetet e anijes a të fluturakes është po ashtu vepër penale sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 137

VENDOSJA E SKLLAVËRISË, KUSHTEVE TË NGJASHME ME SKLLAVËRINË DHE E PUNËS SË DETYRUAR

- (1) Kushdo që duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare, mban, ruan, vendos, blen apo shet një person tjetër në skllavëri apo në kushte të ngjashme me skllavërinë ose në punë të detyruar, që përfshin mbajtjen e personit në pronësi, mohimin e fryteve të punës së tij ose mohimin e lirisë së një personi për të ndryshuar statusin e tij apo kushteve të punës, dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet dhe me gjobë.
- (2) Kushdo që duke shkelur rregullat e të drejtës ndërkombëtare, me qëllim të kryerjes së veprës nga paragrafi 1 i këtij neni nxit një person tjetër të heqë dorë nga liria e tij ose ndërmjetëson në shitjen apo blerjen e një personi tjetër dënohet me dënimin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet kundër personit me të cilin kryerësi është në marrëdhënie familjare, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.
- (4) Nëse kryen veprë penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kundër fëmijës, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- (5) Kur vepra nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij, kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në dymbëdhjetë vjet për veprën nga paragrafi 1, 2 ose 3 ose me burgim prej pesë deri në njëzet vjet për veprën nga paragrafi 4.

Neni 138

KONTRABANDIMI ME MIGRANTË

- (1) Kushdo që merret me trafikimin të migrantëve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.
- (2) Kushdo që prodhon, prokuron, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimin të marrjes me trafikimin me migrantë

dhe për të fituar drejtëpërdrejt ose tërthorazi dobi pasurore a financiare dënohet me burgim deri në pesë vjet.

(3) Kushdo që personit i cili nuk është banor i Kosovës i mundëson të qëndrojë në Kosovë ose personit i cili nuk është banor vendor a i përhershëm për të qëndruar në shtetin në fjalë pa i respektuar kushtet e domosdoshme ligjore për të mbetur sipas mjeteve nga paragrafi 2 i këtij neni ose me çfarëdo mjeteve të tjera joligjore dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(4) Tentativa për të kryer veprë nga paragrafi 3 i këtij neni është e dënueshme.

(5) Kushdo që organizon ose urdhëron personat e tjerë për të kryerë veprë penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet nga kryerësi si anëtar i grupit ose në një mënyrë e cila rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë jetërat a sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin çnjerëzor a degradues, duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë, ai dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

(7) Sipas këtij neni,

1) Shprehja "kontrabandim me migrantët" do të thotë prokurim me qëllim të fitimit të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi të një dobie pasurore a financiare i një hyrjeje të paligjshme të personit në Kosovë, i cili nuk është banor i Kosovës ose në shtetin në të cilin personi nuk është banor i përhershëm apo shtetas i huaj.

2) Shprehja "hyrje e paligjshme" do të thotë kalim i kufirit ose i kufirit administrativ të Kosovës pa i respektuar kushtet e domosdoshme për hyrje të ligjshme në Kosovë ose kalim i kufinjve të shtetit pa i respektuar kushtet e domosdoshme për hyrjen e ligjshme në atë shtet.

3) Shprehja "dokument i rrejshëm i udhëtimit ose i identifikimit" do të thotë çfarëdo dokumenti i udhëtimit ose i identifikimit:

(i) Që është falsifikuar ose ndryshuar në ndonjë mënyrë të caktuar nga cilido person pos nga personi ose organi i autorizuar në bazë të ligjit për të prodhuar ose lëshuar dokument udhëtimi ose identifikimi;

(ii) Që është lëshuar ose është siguruar në mënyrë jo të duhur përmes keqinterpretimit, korrupsionit ose trysnisë apo në çfarëdo mënyre tjetër të kundërligjshme ose

(iii) Që shfrytëzohet nga personi i cili nuk është mbajtësi i tij i vërtetë.

(8) Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është migrant që është objekt i veprës penale nga ky nen.

Neni 139

TRAFIKIMI ME NJERËZ

- (1) Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18-vjeçare, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- (3) Kushdo që organizon një grup personash për të kryer veprë nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.
- (4) Kushdo që nga pakujdesia lehtëson kryerjen e trafikimit me njerëz dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (5) Kushdo që përdor ose siguron shërbime seksuale të një personi për të cilin e dinë se personi i tillë është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (6) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18-vjeçare, kryerësi dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.
- (7) Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafet 1 ose 2, me burgim prej së paku dhjetë vjetësh për veprën penale nga paragrafi 3, me burgim prej dy deri në shtatë vjet për veprën penale nga paragrafet 4 ose 5 ose me burgim prej pesë vjetësh deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 6.
- (8) Sipas këtij neni dhe nenit 140,
 - 1) Shprehja "trafikim me njerëzit" do të thotë rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.
 - 2) Shprehja "shfrytëzim" ashtu siç është përdorur në pikën 1 të këtij paragrafi, përfshin ndër të tjera shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.
 - 3) Pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur cilado prej mjeteve të parashtruara më lart në pikën 1 të këtij paragrafi është përdorur kundër viktimës së tillë.
 - 4) Rekrutimi, transportimi, transferi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit konsiderohet "trafikim me njerëz", madje edhe nëse kjo nuk përfshin asnjërën nga mjetet e parashtruara në pikën 1 të këtij paragrafi.

Neni 140

FSHEHJA E DOKUMENTEVE TË IDENTIFIKIMIT TË VIKTIMAVE TË SKLLAVËRISË OSE TRAFIKIMIT ME NJERËZ

(1) Kushdo që duke vepruar ose duke u paraqitur rrjeshëm vepron si punëdhënës, drejtor, kontraktor apo si organ punësimi i personit tjetër, fsheh dokumentet personale të identifikimit apo pasaportën e personit për të cilin e din se është viktimë e veprës penale të paraparë në nenin 137 dhe 139, dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në shatë vjet.

Neni 141

RREZIKIMI I PERSONAVE NË MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

(1) Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personin nën mbrojtje ndërkombëtare dënohet me burgim prej së paku shtatë vitesh.

(2) Kushdo që kryen rrëmbimin ose sulmin mbi personin ose mbi lirinë e personit nën mbrojtje ndërkombëtare dënohet me burgim prej një deri në dhjet vjet.

(3) Kushdo që kryen një akt të dhunshëm mbi objektet zyrtare, në vend privat ose në mjetet e transportit të një personi nën mbrojtje ndërkombëtare, kur akti i tillë ka gjasë të rrezikojë personin ose lirinë e tij, dënohet me burgim prej një deri në dhjet vjet.

(4) Kushdo që kërcënohet seriozisht se do të kryejë vepër penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(5) Kushdo që organizon ose urdhëron personin të kryejë vepër nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni dënohet me burgim prej tre deri në pesë vjet.

(6) Nëse vepra nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(7) Sipas këtij neni shprehja “person në mbrojtje ndërkombëtare” do të thotë:

1) Kryetar i shtetit duke përfshirë edhe cilindo person i cili kryen funksionet e kryetarit të shtetit sipas kushtetutës së shtetit në fjalë, kryeministrin ose ministrin e punëve të jashtme kurdo që personi i tillë është në një shtet të huaj si dhe anëtarët e familjes së tij apo saj të cilët e shoqërojnë ate;

2) Cilido përfaqësues a zyrtar i shtetit ose cilido zyrtar a organ i organizatës ndërkombëtare të një karakteri ndërqeveritar i cili në kohën dhe në vendin ku kryhet krimi kundër tij apo saj, objektit të tij apo saj zyrtar ose vendbanimit të tij apo saj privat ose mjeteve të transportit të tij apo saj ka të drejtë, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare në mbrojtje të veçantë nga çfarëdo sulmi mbi personin, lirinë ose dinjitetin e tij apo saj si dhe anëtarët e familjes së tij apo saj që janë pjesë e shtëpisë së tij apo saj.

Neni 142

RREZIKIMI I PERSONELIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA DHE I PERSONELIT NË MARRËDHËNIE ME TO

- (1) Kushdo që me qëllim e privon nga jeta personelin e Kombeve të Bashkuara ose personelin në marrëdhënie me to dënohet me burgim prej së paku shtatë vjetësh.
- (2) Kushdo që kryen rrëmbimin a sulmin mbi personin ose lirinë e personelit të Kombeve të Bashkuara apo mbi personelin në marrëdhënie me to dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (3) Kushdo që kryen një sulm me dhunë mbi objektet, vendbanimin privat apo mjetet e transportit të Kombeve të Bashkuara apo personelin në marrëdhënie me to kur sulmi i tillë ka gjasë të rrezikojë personin ose lirinë e tij dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (4) Kushdo që kërcënon seriozisht se do të kryejë veprë penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 të këtij neni dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (5) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 ose 3 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej së paku pesë vjetësh.
- (6) Sipas këtij neni,

1) Shprehja “personel i Kombeve të Bashkuara” do të thotë:

- (i) Persona të angazhuar dhe të vendosur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara si pjesëtarë të komponentës ushtarake, policore ose civile të operacionit të Kombeve të Bashkuara ose
- (ii) Zyrtarë të tjerë dhe ekspertë të misionit të Kombeve të Bashkuara, agjenci të specializuara të saj ose të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike të cilët janë të pranishëm në cilësi zyrtare në zonën ku operacioni i Kombeve të Bashkuara është duke u zhvilluar.

2) Shprehja “personel në marrëdhënie me to” do të thotë:

- (i) Persona të caktuar nga Qeveria ose nga një organizatë ndërqeveritare me marrëveshjen e organit kompetent të Kombevetë Bashkuara;
- (ii) Persona të angazhuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ose nga një agjenci e specializuar a nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike;
- (iii) Personel i vendosur nga një organizatë humanitare joqeveritare ose agjenci sipas një marrëveshjeje me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ose me një agjenci të specializuar apo me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për kryerjen e aktiviteteve në mbështetje të përmbushjes së mandatit të operacionit të Kombeve të Bashkuara.

- 3) Shprehja “Operacion i Kombeve të Bashkuara” do të thotë operacion i themeluar nga organi kompetent i Kombeve të Bashkuara në pajtim Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe i udhëhequr nga autoriteti dhe kontrolli i Kombeve të Bashkuara:
- (i) Nëse operacioni ka për qëllim mbajtjen dhe rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare ose
 - (ii) Nëse Këshilli i Sigurimit ose Asambleja e Përgjithshme ka deklaruar për qëllimet e Konventës mbi Sigurinë e Personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të Personelit në Marrëdhënie me to të datës 9 dhjetor 1994 se ekziston rreziku i jashtëzakonshëm për sigurinë e personelit që merr pjesë në operacion.

Neni 143

MARRJA E PENGJEVE

- (1) Kushdo që zë, arreston dhe e kërcënon se do ta vrasë, do ta plagosë ose se do të vazhdojë ta mbajë në arrest personin e tillë me qëllim që ta detyrojë personin fizik ose juridik ose një grup personash për të kryer a për të mos kryer vepër si kusht eksplicit o implicit për lirin e personit tjetër dënohet me burgim së paku tre vjetësh.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të zënë peng, kryerësi dënohet me burgim së paku pesë vjet.
- (3) Kushdo i cili me qëllim e privon nga jeta personin e zënë peng duke kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë.

Neni 144

PËRVETËSIMI I PALIGJSHËM, SHFRYTËZIMI, TRANSFERI DHE VENDOSJA E MATERIALEVE NUKLEARE

- (1) Kushdo që pa autorizim pranon, posedon, shfrytëzon, transferon, ndryshon, vendos ose shpërndan material nuklear dhe shkakton ose ka gjasë të shkaktojë vdekjen a lëndimin e rendë të personit ose dëm të madh ndaj pronës dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.
- (2) Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave ose me dëmin e madh material, kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.
- (3) Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni nga pakujdesia dënohet me burim deri në shtatë vjet, nëse kryen vepër penale nga paragrafi 1 dhe me së paku tre vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 2.
- (4) Kushdo që kryen vjedhje, plaçkitje ose përvetësim të materialit nuklear ose bën kërkesë për material nuklear me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës apo me çfarëdo forme tjetër të frikësimit dënohet me burgim së paku pesë vjet.

Neni 145

KËRCËNIMI PËR PËRDORIMIN OSE KRYERJEN E VJEDHJES A TË PLAÇKITJES SË MATERIALIT NUKLEAR

- (1) Kushdo që kërcënon me përdorim të materialit nuklear shkaktimin e vdekjes ose të lëndimeve të rënda ndaj personit ose dëmit të madh material dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.
- (2) Kushdo që me qëllim të detyrimit të personit fizik ose juridik për të kryer ose për të mos kryer një veprë kërcënon të kryejë vjedhje ose plaçkitje të materialit nuklear dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e një ose të më shumë personave ose dëmit të madh material kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim ose me burgim afatgjatë.

KAPITULLI XV: VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

Neni 146

VRASJA

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me së paku pesë vjet burgim.

Neni 147

VRASJA E RËNDË

Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili:

- 1) Privon nga jeta fëmijën;
- 2) Privon nga jeta femrën për të cilën e di se ajo është shtatzënë;
- 3) Privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;
- 4) Privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave;
- 5) Privon nga jeta personin tjetër duke vepruar mizorisht e dhunshëm;
- 6) Privon nga jeta personin tjetër nga motivet racore, nacionale apo fetare,
- 7) Privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore;
- 8) Privon nga jeta me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale;
- 9) Privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta;

- 10) Privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo të pasurisë, zbulimit të veprave penale, arrestimit të kryerësit të veprës penale, ruajtjes së personave të privuar nga liria ose ruajtjes së rendit dhe të paqes publike;
- 11) Me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenet 148 dhe 150 të këtij Kodi ose
- 12) Privon nga jeta personin dhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 148 dhe 150 të këtij Kodi.

Neni 148

VRASJA E KRYER NË GJENDJE TË AFEKTIT MENDOR

Kushdo që tjetrin e privon nga jeta në gjendje të afektit mendor, i vënë pa fajin e tij në gjendje të tronditjes së fortë mendore të shkaktuar nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 149

VRASJA NGA PAKUJDESIA

Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta prej pakujdesisë dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Neni 150

VRASJA E FOSHNJEVERE GJATË LINDJES

Nëna që e privon nga jeta foshnjen e vet gjatë lindjes apo menjëherë pas lindjes, derisa te ajo vazhdon çrregullimi i shkaktuar nga lindja, dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Neni 151

SHTYTJA NË VETËVRASJE DHE DHËNIA E NDIHMËS NË VETËVRASJE

- (1) Kushdo që shtyt personin tjetër ose e ndihmon për të bërë vetëvrasje dhe vetëvrasja kryhet dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (2) Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni ndaj të miturit ose ndaj personit aftësia e të cilit për të kuptuar peshën e veprës së vet ose për t'i kontrolluar sjelljet e veta ka qenë thelbësisht e zvogëluar dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (3) Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni ndaj personit nën moshën katërmëdhjetë vjeçare i cili nuk ka qenë i aftë për të kuptuar peshën e veprës së tij apo saj ose për të kontrolluar sjelljet e tij apo saj dënohet sipas nenit 146 të këtij Kodi.

- (4) Kushdo që mizorisht ose në mënyrë çnjerëzore trajton personin tjetër, i cili ndodhet në pozitë të nënshtuar dhe me këtë e shtin personin të bëjë vetëvrasje dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- (5) Nëse si rezultat i veprës penale nga paragrafi 1 deri në 4 të këtij neni vetëm është tentuar vetëvrasja, gjykata kryerësin mund ta dënojë më butë.

Neni 152

NDËRPRERJA E PALEJUAR E SHTATZËNËSISË

- (1) Kushdo që në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi ndërprerjen e shtatzënësise dhe me pëlqimin e gruas shtatzënë ndërpret shtatzaninë, fillon ta kryejë ndërprerjen e shtatzanisë ose i ndihmon që ta ndërprejë shtatzaninë dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.
- (2) Kushdo që e ndërpreu ose fillon ta ndërprejë shtatzaninë pa pëlqimin e gruas shtatzënë dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni rezulton në lëndim të rëndë trupor, me dëmtim të rëndë të shëndetit ose me vdekje të gruas shtatzënë, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose më së paku tre vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 2.

Neni 153

LËNDIMI I LEHTË TRUPOR

- (1) Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim trupor i cili rezulton në:
- 1) Dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi a pjese të trupit të personit tjetër;
 - 2) Zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar;
 - 3) Shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër ose
 - 4) Dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër

dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer me armë, me ndonjë mjet të rrezikshëm, me ndonjë send tjetër të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim deri në tre vjet.
- (3) Kryerësit të veprës penale nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni gjykata mund t'ia shqiptojë vërejtjen gjyqësore, nëse kryerësi ka qenë i provokuar nga sjellja çnjerëzore ose e vrazhdë e palës së dëmtuar.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet kundër personit me të cilin kryerësi është në marrëdhënie familjare, kryerësi dënohet me së paku tre muaj deri në tre vjet

burgim për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej gjashtë muajsh deri në tre vjet për veprën penale nga paragrafi 2.

Neni 154

LËNDIMI I RËNDË TRUPOR

(1) Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me:

- 1) Rrezikim të jetës së personit tjetër;
- 2) Paaftësimin ose dobësimin e përhershëm ose të madh të një organi ose pjese të trupit të personit tjetër;
- 3) Dobësimin e përkohshëm ose të madh të një organi vital ose një pjese vitale të trupit të personit tjetër;
- 4) Paaftësimin e përkohshëm, zvogëlimin e përkohshëm dhe të madh ose zvogëlimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar;
- 5) Dëmtimin e përkohshëm ose të rëndë apo dëmtimin e përhershëm të shëndetit të personit tjetër

dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me:

- 1) Paaftësimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për çfarëdo lloj pune;
- 2) Shëmtimin e përhershëm të personit tjetër;
- 3) Dëmtimin e përhershëm ose të rëndë të shëndetit të personit tjetër ose
- 4) Paaftësimin e përhershëm të një organi vital ose të një pjese vitale të trupit të personit tjetër

kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 kryhet ndaj personit me të cilin kryerësi është në marrëdhënie familjare, kryerësi dënohet me burgim së paku një vit për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim së paku dy vjet për veprën penale nga paragrafi 2.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni rezulton me vdekjen e personit tjetër kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi

dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në dy vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet për veprën penale nga paragrafi 2.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafët 1, 2 ose 3 të këtij neni kryhet në gjendje të afektit mendor, i vënë pa fajin e tij në gjendje të tronditjes së rëndë mendore të shkaktuar nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e palës së dëmtuar, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet për veprën penale nga paragrafi 2.

Neni 155

PJESËMARRJA NË RRAHJE

(1) Kushdo që merr pjesë në rrahje, e cila rezulton me vdekje ose lëndime veçanërisht të rënda trupore të një ose më shumë personave, për pjesëmarrje në rrahje dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(2) Nuk do të konsiderohet penalisht përgjegjës personi nga paragrafi 1 i këtij neni nëse ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij ose thjesht për të mbrojtur veten apo për t'i ndarë pjesëmarrësit e tjerë në rrahje.

Neni 156

MOSDHËNIA E NDIHMËS

(1) Kushdo që nuk i ofron ndihmë personit jeta e të cilit ndodhet në rrezik të drejtpërdrejtë edhe pse këtë ka mundur ta bëjë pa e rrezikuar veten apo tjetrin dënohet me burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që personin tjetër e lë pa ndihmë, në gjendje apo në rrethana të kërcënimit të rrezikut për jetë të shkaktuara nga vetë kryerësi dënohet me burgim deri në tre vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me lëndimin e rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë shëndetësor të personit të rrezikuar, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni ka pasojë vdekjen e personit të rrezikuar, kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim.

Neni 157

BRAKTISJA E PERSONAVE TË PAAFTË

(1) Kushdo që e lë personin e paafte, që i është besuar të përkujdeset për të, pa ndihmë në rrethana të rrezikshme për jetën apo për shëndetin dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëmtim të rëndë shëndetësor të personit të braktisur, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të cilit nuk i është dhënë ndihma, kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim.

KAPITULLI XVI: VEPRAT PENALE KUNDËR LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

Neni 158

SHKELJA E STATUSIT TË BARABARTË TË BANORËVE TË KOSOVËS

- (1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i mohon ose i kufizon liritë a të drejtat e banorit të Kosovës të parapara në Kornizën Kushtetuese dhe në ligjin në fuqi mbi bazën e dallimit në racë, në ngjyrë, në gjini, në gjuhë, në besimin fetar ose në ateizëm, në mendimin politik ose në mendimin tjetër, në prejardhje sociale ose kombëtare, në pronë, në lindje, në arsim, në statusit shoqëror ose sipas karakteristikave të tjera personale, të lidhjes me bashkësinë etnike ose gjuhësore në Kosovë ose kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i jep qytetarit të Kosovës çfarëdo privilegji ose përparësie mbi bazën e një dallimi ose përkatësie të tillë dënohet me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet.
- (2) Kushdo që i mohon ose ia kufizon pjesëtarit të një bashkësie etnike, fetare ose gjuhësore në Kosovë të drejtën për shprehje të lirë të identitetit të tij ose për të gëzuar autonominë e tij dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Kushdo që, në kundërshtim me ligjin për përdorimin e gjuhës dhe të shkrimit, ia mohon banorit të Kosovës të drejtën që lirshëm të përdor gjuhën ose shkrimin e tij dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (4) Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrave të tij, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në shtatë vjet për veprën penale nga paragrafin 1 ose 2 ose me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet për veprën penale nga paragrafi 3.

Neni 159

RRËMBIMI I PERSONIT

- (1) Kushdo që e rrëmben personin me qëllim që atë apo personin tjetër ta detyrojë të kryejë ose të moskryejë një vepër a të pajtohet me një vepër dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kur vepra penale kryhet si anëtar i grupit ose kryerësi e kërcënon personin e rrëmbyer me vdekje ose me shkaktim të dëmtimit të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (3) Nëse kryerësi vullnetarisht e liron personin e rrëmbyer para se t'i jenë realizuar kërkesat e tij për shkak të të cilave e ka kryer rrëmbimin, gjykata mund ta dënojë kryerësin më butë ose ta lirojë nga dënimi.

Neni 160

SHTRËNGIMI

- (1) Kushdo që e detyron personin tjetër me dhunë ose kanosje serioze të kryejë ose të mos kryejë një vepër ose të pajtohet me një vepër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
- (2) Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni ndaj fëmijës ose personit me të cilin kryerësi është në marrëdhënie familjare dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i një grupi, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.
- (4) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni fillon sipas propozimit.

Neni 161

KANOSJA

- (1) Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër se do ta dëmtojë me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (2) Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë dëmtim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria, se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet ndaj fëmijës ose personit me të cilin kryerësi është në marrëdhënie familjare, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit për veprën penale nga paragrafi 1 apo me gjobë ose me burgim deri në dy vjet për veprën penale nga paragrafi 2.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën a me pozitën e tij ose ndaj disa personave, nëse vepra penale shkakton shqetësim të madh ndaj tyre, nëse personi i kërcënuar, së këndejmi, për një kohë të gjatë është vënë në pozitë të rëndë ose nëse vepra penale është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtarve i grupit, kryerësi dënohet me burgim prej me 3 muaj deri në tre vjet.
- (5) Procedura penale për veprën penale nga paragrafet 1, 2 ose 3 i këtij neni fillohet sipas propozimit.

Neni 162

PRIVIMI I KUNDËRLIGJSHËM NGA LIRIA

- (1) Kushdo që personin tjetër e burgos në mënyrë të kundërligjshme, e mban të mbyllur ose në ndonjë mënyrë tjetër e privon nga liria dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (2) Tentativa për të kryer veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.
- (3) Nëse privimi i kundërligjshëm nga liria zgjat më shumë se tridhjetë ditë ose vepra penale është kryer në mënyrë mizore ose rezulton me dëmtime të rënda për shëndetin e personit të ndaluar kundërligjshëm apo me pasoja të tjera të rënda, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni kryhet ndaj fëmijës ose personit me të cilin kryerësi është në marrëdhënie familjare, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 3.
- (5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.
- (6) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni rezulton me vdekjen e personit të privuar nga liria në mënyrë të kundërligjshme, kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim.

Neni 163

MARRJA E DEKLARATAVE ME ANË TË SHTRËNGIMIT

- (1) Personi zyrtar, i cili gjatë ushtrimit të detyrës, e përdorë dhunën, kanosjen ose mjete ose përdor mënyra të tjera të ndaluara me qëllim të detyrimit të të dyshuarit, të të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit ose personit tjetër për të pohuar apo për të dhënë ndonjë deklaratë tjetër dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet me përdorimin e dhunës së rëndë ose nëse të dyshuarit ose të pandehurit i janë shkaktuar pasoja të rënda në procedurën penale si rezultat i deklaratës së marrë nga ai me detyrim, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 164

KEQTRAJTIMI GJATË USHTRIMIT TË DETYRAVE

- (1) Personi zyrtar, i cili gjatë ushtrimit të detyrës së tij e keqtrajton, e frikëson ose e fyen personin tjetër dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.
- (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Neni 165
TORTURA

- (1) Personi zyrtar ose personi i cili vepron me qëllim të shtytjes ose me pëlqim apo pranim të personit zyrtar, i cili kryen aktin e torturës, dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- (2) Akt i torturës do të thotë kryerja ose moskryerja e një akti me anë të të cilit me qëllim shkaktohet dhembja e rëndë ose vuajtja qoftë fizike ose mendore e personit me qëllim të marrjes së informacionit a deklaratës nga personi i tillë ose nga personi i tretë e cila ka për qëllim dënimin e personit të tillë për një vepër të cilën ai ose personi i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer apo për frikësimin o detyrimin e personit ose të personit të tretë. Akti i torturës nuk përfshin cilindo akt ose mungesën e tij që rrjedh vetëm nga aktet e pashmangshme apo karakteristike të sanksioneve të ligjshme.

Neni 166
CËNIMI I PAPREKSHMËRISË SË BANESAVE

- (1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme hyn në banesë ose në objektin e mbyllur të personit tjetër apo nuk largohet nga objektet e tilla sipas kërkesës së personit të autorizuar dënohet me burgim deri në tre vjet.
- (2) Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.

Neni 167
KONTROLLIMI I KUNDËRLIGJSHËM

Personi zyrtar, i cili gjatë ushtrimit të detyrës në mënyrë të kundërligjshme e bën kontrollimin e banesës, lokaleve apo të personit dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.

Neni 168
CENIMI I FSHEHTËSISË SË KORRESPONDENCËS DHE I BAZAVE TË TË DHËNAVE KOMPJUTERIKE

- (1) Kushdo që pa autorizim e hap letrën, telegramin, faksimilin ose ndonjë dokument tjetër të mbyllur a dërgesë të personit tjetër ose në ndonjë mënyrë tjetër e cënon fshehtësinë e materialeve të tilla apo mban, fsheh, asgjëson ose i dorëzon personit tjetër letrën, telegramin, faksimilin o dërgesën e personit tjetër dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (2) Kushdo që pa autorizim depërton në bazën e të dhënave kompjuterike të personit tjetër ose ato të dhëna i shfrytëzon apo ia vë në dispozicion personit tjetër, dënohet me gjobë a me burgim deri në gjashtë muaj.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër apo për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës, kryerësi dënohet për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni prej tre muajve deri në tre vjet, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 3 i këtij neni dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 169

ZBULIMI I PAAUTORIZUAR I INFORMACIONIT TË BESUESHËM

(1) Avokati, mbrojtësi, mjeku apo personi tjetër, i cili, pa autorizim, zbulon informacionin e besueshëm, për të cilin është vënë në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit të vet dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse ai e ka zbuluar informatën në interes të përgjithshëm, nëse interesi i tillë peshon më shumë se sa moszbulimi i informacionit të besueshëm.

(3) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni fillohet sipas propozimit.

Neni 170

PËRGJIMI DHE INCIZIMI TONIK I PAAUTORIZUAR

(1) Kushdo që me anë të pajisjeve të posaçme pa autorizim përgjon apo bën përgjimin tonik ose incizon bisedën a deklaratën, e cila nuk i është drejtuar atij ose i mundëson personit tjetër të jetë në dijeni për bisedën apo deklaratën e cila është përgjuar tonikisht apo është incizuar pa autorizim dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet.

(3) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni ndërmerret sipas propozimit.

(4) Pajisjet e veçanta për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni konfiskohen.

Neni 171

FOTOGRAFIMI DHE INCIZIMET E TJERA TË PAAUTORIZUARA

(1) Kushdo që e bën fotografimin, incizimin filmik, incizimin me video ose ndonjë incizim tjetër të personit tjetër në banesën e tij personale pa pëlqimin e tij dhe në këtë mënyrë thelbësisht cenon jetën e tij private ose kushdo që fotografimin, incizimin filmik a incizimin me video e jep ose i mundëson qasje personit të tretë ndaj tyre dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrave kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.
- (3) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni fillohet sipas propozimit.

Neni 172

SHKELJA E URDHËRAVE PËR MASAT E FSHEHURA OSE TEKNIKE TË VËZHGIMIT OSE HETIMIT

- (1) Nëpunësi i policisë i cili zbaton një urdhër gjyqësor ose hetimor për masat e fshehura teknike të vëzhgimit ose hetimit në kundërshtim me nenet përkatëse në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (2) Personi i cili nxjerr informacionin që do të dëmtojë efikasitetin e zbatimit të një urdhri për masat e fshehta ose teknike të vëzhgimit dhe të hetimit dënohet me burgim deri në tre vjet.
- (3) Personi përgjegjës për punën me telekomunikimet, rrjetat kompjutorike ose shërbimet postare apo punonjësi i një institucioni financiar i cili nuk ndërmerr veprimet e duhura për të lehtësuar zbatimin e urdhrit për ndërprerjen e telekomunikimeve, për ndërprerjen e komunikimeve me anë të rrjetit kompjutorik, kontrollit të dërgesave postare, regjistrimin e thirrjeve telefonike ose zbulimin e të dhënave financiare kryen vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Neni 173

PARANDALIMI OSE PENGIMI I TUBIMIT PUBLIK

- (1) Kushdo që me përdorimin e dhunës, kanosjes serioze, mashtrimit ose në ndonjë mënyrë tjetër parandalon ose pengon caktimin apo mbajtjen e tubimit publik në të cilin personat kanë të drejtë sipas ligjit dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen personi zyrtar duke e keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryerësi dënohet me burgim deri në dy vjet.

Neni 174

PARANDALIMI I USHTRIMIT TË SË DREJTËS PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE JURIDIKE

- (1) Kushdo që me përdorimin e dhunës ose kanosjes serioze e pengon personin tjetër që të paraqesë ankesën ose për të shfrytëzuar çfarëdo mjete tjetër juridik dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen personi zyrtar duke e keqpërdoruar pozitën apo autorizimet e veta, kryerësi dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Neni 175

PARANDALIMI I SHTYPJES OSE I SHPËRNDARJES SË MATERIALEVE TË SHTYPURA

Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme e pengon shtypjen, shitjen apo shpërndarjen e librave, revistave ose materialeve të tjera të shtypura dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Neni 176

PARANDALIMI I USHTRIMIT TË SË DREJTËS SË VOTIMIT

Kushdo që gjatë ushtrimit të detyrave që i besohen atij lidhur me votimet në Kosovë dhe me qëllim të pengimit të ushtrimit të së drejtës së votimit të personit tjetër në mënyrë të paligjshme nuk e regjistron personin e tillë në listën e regjistrimit të votuesve ose në ndonjë mënyrë tjetër e pengon personin tjetër nga ushtrimi i të drejtës së votës dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Neni 177

CENIMI I PËRCAKTIMIT TË LIRË TË VOTUESVE

Kushdo që me përdorimin e dhunës, kanosjes serioze, rryshfetit ose duke keqrdorur varësinë ekonomike apo profesionale të votuesit ndikon në votuesit në Kosovë që të votojnë në mënyrë të caktuar ose të mos votojnë në zgjedhje dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet.

Neni 178

KEQPËRDORIMI I TË DREJTËS SË VOTIMIT

Kushdo që në zgjedhjet e mbajtura në Kosovë voton në emër të personit tjetër ose voton, apo megjithëse ka votuar, sërish tenton të votojë, dënohet me dënim me gjobë a me burgim deri në një vit.

Neni 179

CENIMI I FSHEHTËSISË VOTIMIT

(1) Kushdo që në zgjedhje të mbajtura në Kosovë cenon fshehtësinë e votimit dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

(2) Kushdo që me përdorimin e dhunës, kanosjes serioze ose në ndonjë mënyrë tjetër kërkon nga personi të tregojë se për cilin ka votuar dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(3) Nëse veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose cilido person tjetër gjatë ushtrimit të detyrës së tij gjatë zgjedhjeve avotimit, kryerësi dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 180

MASHTRIMI NË VOTIME

Kushdo që i falsifikon rezultatet e zgjedhjeve apo të votimeve në Kosovë duke shtuar, hequr apo shlyer votat a nënshkrimet, duke i numëruar në mënyrë jo të saktë, duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore apo këtë e kryen në ndonjë mënyrë tjetër ose i publikon rezultatet e zgjedhjes a të votimit që nuk i përgjigjen votimit të kryer dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 181

ASGJËSIMI I DOKUMENTEVE TË VOTIMIT

(1) Kushdo që në zgjedhjet e mbajtura në Kosovë fsheh, dëmton apo e merr ndonjë dokument lidhur me zgjedhjet dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Nëse veprën nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen personi zyrtar në ushtrimin e detyrës në lidhje me zgjedhjet, kryerësi dënohet me burgim deri në dy vjet.

KAPITULLI XVII: VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 182

CENIMI I TË DREJTAVE NGA MARRËDHËNIET E PUNËS

Kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive mbi punësimin apo pushimin e marrëdhënies së punës, për pagën apo të ardhurat e tjera, për kohëzgjatjen e orarit të punës, për pushim apo mungesë në punë, mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me paafësi apo për punën jashtë orarit ose për punën e natës dhe në këtë mënyrë punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Neni 183

CENIMI I TË DREJTAVE TË PUNËSIMIT APO PAPANËSISË

(1) Kushdo që ia mohon ia apo kufizon personave të tjerë të drejtën në punësim të lirë në kushte të njëjta, ashtu siç që është përcaktuar me ligj, dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që nuk e respekton ligjin mbi të drejtat e personave të papunësuar dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtat që iu takojnë atyre dënohet me dënimin e njëjtë nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 184

CENIMI I TË DREJTAVE TË PUNËTORËVE NË PJESËMARRJEN NË QEVERISJE

Kushdo që, duke e cënuar ligjin, pengon apo i pamundëson punëtorit realizimin e të drejtës në pjesëmarrje në qeverisje apo ato të drejta i keqpërdor dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Neni 185

CENIMI I TË DREJTAVE NGA SIGURIMI SOCIAL

Kushdo që me vetëdije nuk e respekton ligjin apo kontratën kolektive nga lëmi i sigurimit shëndetësor, pensional dhe invalidor dhe format e tjera të sigurimit social dhe me këtë ia mohon apo ia kufizon të drejtën që i takon punëtorit dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit.

Neni 186

RREZIKIMI I SIGURISË NË PUNË

(1) Kushdo që në minierë, në fabrikë, në ndërtimtari apo në ndonjë kantier ndërtimi i asgjëson, i dëmton a i heq pajisjet dhe kështu shkakton rrezik për jetën e njerëzve dënohet me burgim deri në tre vjet.

(2) Kushdo që është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës në minierë, në fabrikë, në kantier ndërtimi apo në ndonjë vend tjetër të punës dhe që nuk bën instalimin e pajisjeve të sigurisë apo nuk i mirëmbanë pajisjet e tilla ose nuk vepron sipas rregullave teknike mbi masat e sigurisë dhe kështu shkakton rrezik për jetën e njerëzve dënohet me burgim deri në dy vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në një vit.

(4) Nëse vepra nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni ka shkaktuar lëndim të rëndë të një apo më shumë personave, për veprën nga paragrafi 1 dhe 2 kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet, ndërsa për veprën nga paragrafi 3 dënohet me burgim deri në tre vjet.

(5) Nëse vepra nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni ka shkaktuar vdekjen e një apo më shumë personave, për veprën nga paragrafët 1 ose 2 kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 3.

KAPITULLI XVIII: VEPRAT PENALE KUNDËR NDERIT DHE AUTORITETIT

Neni 187

FYERJA

- (1) Kushdo që e fyen personin tjetër dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre muaj.
- (2) Personi nuk është penalisht përgjegjës nga paragrafi 1 i këtij neni:
 - 1) Nëse e përshkruan individin tjetër në mënyrë fyese në veprën shkencore, letrare apo artistike, në një shqyrtim serioz gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, gjatë ushtrimit të profesionit të gazetarisë, gjatë veprimtarisë politike apo të ndonjë veprimtarie shoqërore ose në mbrojtjen e ndonjë të drejte apo të interesave të arsyeshme dhe
 - 2) Nëse sipas mënyrës së përshkrimit apo të rrethanave të tjera përkatëse, është e qartë se vepra nuk është kryer me qëllim të përçmimit.
- (3) Nëse personi i fyer i është përgjegjur fyerjes me fyerje, gjykata mund ta dënojë apo ta lirojë nga dënimi njëren palë ose të dy palët në fjalë.

Neni 188

SHPIFJA

- (1) Kushdo që për personin tjetër nxjerr apo përhap pohime të pavërtetë që mund të dëmtojnë nderin dhe autoritetin e tij, megjithëse e di se pohimet e tilla janë të pavërteta, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre muaj.
- (2) Personi nuk është penalisht përgjegjës nga paragrafi 1 i këtij neni nëse pohimet e nxjerra apo të përhapura janë të vërteta ose nëse ai ka pasur arsye të bazuar për të besuar në vërtetësinë e pohimit të tillë.

Neni 189

ZBULIMI I RRETHANAVE PERSONALE DHE FAMILJARE

- (1) Kushdo që nxjerr apo përhap informacion të fshehtë në lidhje me jetën personale apo familjare të ndonjë personi që mund ta dëmtojë autoritetin e tij dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre muaj.
- (2) Vërtetësia apo pavërtetësia e informacionit, që nxirret apo përhapet lidhur me jetën personale apo familjare të ndonjë personi nuk mund të hetohet në gjykatë, përveç në rastin e paraparë në paragrafin 5 të këtij neni.
- (3) Personi nuk është penalisht përgjegjës nga paragrafi 1 i këtij neni:
 - 1) Nëse veprimi është bërë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, politike ose ndonjë aktiviteti tjetër politik në mbrojtje të një të drejte ose të një interesi të drejtë dhe

- 2) Nëse pohimet e nxjerra apo të përhapura janë të vërteta ose nëse personi i tillë ka pasur arsye të bazuar për të besuar në vërtetësinë e informacionit të tillë.

Neni 190

NDJEKJA E VEPRAVE PENALE KUNDËR NDERIT DHE AUTORITETIT

- (1) Procedura penale për veprat penale nga nenet prej 187 deri te neni 189 i këtij Kodi fillohet në bazë të padisë private.
- (2) Nëse veprat penale nga neni 187 deri te neni 189 të këtij Kodi janë kryer ndaj personit të vdekur, procedura penale fillohet në bazë të padisë private të bashkëshortit, fëmijëve, prindërve, prindërve adoptues ose vëllezërve a motrave të personit të vdekur.

Neni 191

PUBLIKIMI I AKTGJYKIMEVE

Me rastin e shqiptimit të dënimit për veprën e shpifjes të kryer me anë të shtypit apo me mjeteve të tjera të informimit dhe komunikimit publik, gjykata, me kërkesën e palës së dëmtuar, mund të urdhërojë publikimin e aktgjykimit në tërësi ose të një pjese të tij në shpenzime të personit të dënuar.

KAPITULLI XIX: VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL

Neni 192

PËRKUFIZIMET NË LIDHJE ME VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL

Sipas këtij kapitulli,

- (1) Shprehja “pëlqim” do të thotë pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare për të kryer aktin seksual. Nuk ekziston pëlqimi nëse:
 - 1) Personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë;
 - 2) Pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës;
 - 3) Pajtimi i personit të tillë është marrë me mashtrim, me frikë ose me kërcënim nëse mjetet e tilla nuk përfshijnë përdorimin e dhunës, kërcënimin ose shfrytëzimin siç është paraparë në nenin 193(2) ose
 - 4) Personi i tillë është i paaftë për pajtimin për akt seksual për shkak të dehjes me alkool, me drogë ose me substanca të tjera.
- (2) Asgjë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk duhet të interpretohet si kufizim i rrethanave në të cilat nuk ekziston pëlqimi.

- (3) Shprehja “akt seksual” do të thotë penetrim i organit seksual në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim në hapjen anale a gjenitale të personit me ndonjë objekt ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit.
- (4) Shprehja “detyrim i personit tjetër në kryerjen e aktit seksual” do të thotë kryerja e aktit seksual mbi personin tjetër nga kryerësi ose cytje e personit në kryerjen e aktit seksual me kryerësin a me personin e tretë ose cytja e personit të tretë për kryerjen e aktit seksual në personin tjetër.
- (5) Shprehja “prekje” do të thotë kontakt direkt ose indirekt, pa penetrim, midis trupit të personit me cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër apo me ndonjë objekt.
- (6) Shprehja “pornografi me fëmijët” do të thotë material pornografik që vizuelisht paraqet personin nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare në kryerjen e një sjelljeje të qartë seksuale, personin i cili duket të jetë nën moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare në kryerjen e një sjelljeje të qartë seksuale ose pamje realiste që paraqesin personin nën moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare në kryerjen e sjelljes së qartë seksuale.
- (7) Shprehja “prostitucion” do të thotë ofrimi ose dhënia e shërbimeve seksuale në këmbim me të holla, me mallra ose me shërbime.

Neni 193
DHUNIMI

- (1) Kushdo që e detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë dënohet me burgim prej dy vite deri në dhjetë vjet.
- (2) Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual:
- 1) Me forcë;
 - 2) Me kërcënim të rrezikimit të atqasshëm të jetës ose trupit të personit të tillë a të personit tjetër ose
 - 3) Duke shfrytëzuar një situatë në të cilën personi është i pambrojtur dhe siguria e tij është në rrezik;
- dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet në një ose me më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet kur:
- 1) Veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;
 - 2) Kryerësi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin fizik a mendor të personit;
 - 3) Kryerësi përdor armë ose mjet tjetër të rrezikshëm;

- 4) Kryerësi me dashje e ka shkaktuar dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave të tjera;
 - 5) Vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
 - 6) Kryerësi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për arsye të moshës së vjetër, çrregullimit fizik a mendor, paaftësisë a shtatzanisë;
 - 7) Kryerës është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku, gjyshi ose gjyshja, daja, tezja, vëllai ose motra më e vjetër e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare;
 - 8) Kryerësi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në njëzet vjet.
- (5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës, kryerësi dënohet me së paku 10 vjet burgim apo me burgim afatgjatë.

Neni 194

KRYERJA E AKTIT SEKSUAL ME KËRCËNIM TË NDERIT OSE TË AUTORITETIT

Kushdo që e detyron personin tjetër për të kryer akt seksual duke përdorur kanosjen për zbulimin një fakti që do të dëmtonte rëndë nderin ose autoritetin e personit të tillë ose të një personi në lidhje të ngushtë me atë person dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 195

SULMI SEKSUAL

- (1) Kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryerësin ose personin e tretë me qëllim seksual pa pëlqimin e personit tjetër të tillë dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (2) Kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryerësin a personin e tretë me qëllim seksual:
 - 1) Me forcë;
 - 2) Me kërcënim të rrezikimit të drejtëpërdrejtë të jetës a të trupit të personit të tillë ose të personit tjetër ose
 - 3) Duke shfrytëzuar një situatë në të cilën personi tjetër i tillë është i pambrojtur dhe siguria e viktimës është në rrezik

dënohet me burgim prej një deri në shtatë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet kur:

- 1) Veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar apo është përcjellur nga një akt i torturës ose i trajtimit çnjerëzor;
- 2) Kryerësi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë të shëndetit mendor dhe fizik të personit;
- 3) Kryerësi përdorë armë ose ndonjë mjet të rrezikshëm;
- 4) Kryerësi me dashje e ka shkakuar dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës ose substancave të tjera;
- 5) Vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
- 6) Kryerësi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për arsye të moshës së vjetër, çrregullimit fizik ose mendor, paaftësisë ose shtatzanisë;
- 7) Kryerësi është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku, gjyshi ose gjyshja, daja, tezja, vëllai ose motra më e vjetër e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetëvjeçare;
- 8) Kryerësi është në marrëdhënie të përbashkët familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës, kryerësi dënohet me burgim së paku dhjetë vjet apo me burgim afatgjatë.

Neni 196

DEGRADIMI I INTEGRITETIT SEKSUAL

(1) Kushdo që e cyt personin tjetër t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryejë një akt tjetër seksual që e degradon integritetin seksual të personit të tillë pa pëlqimin e personit e tij dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë muajve deri në një vit.

(2) Kushdo që e cyt personin tjetër t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryejë një akt tjetër që e degradon integritetin seksual të personit:

- 1) Me forcë;
- 2) Me kërcënim të rrezikimit të drejtpërdrejtë të jetës a të trupit të personit të tillë ose të personit tjetër;

- 3) Duke shfrytëzuar një situatë në të cilën personi është i pambrojtur dhe siguria e tij është në rrezik dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tre vjet kur:
- 1) Veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur me torturë ose me trajtim çnjerëzor;
 - 2) Kryerësi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë të shëndetit mendor dhe fizik të personit;
 - 3) Kryerësi përdor armë ose ndonjë mjet të rrezikshëm;
 - 4) Kryerësi me dashje e ka shkakuar dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës ose substancave të tjera ;
 - 5) Kryerësi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për arsye të moshës së vjetër, çrregullimit fizik ose mendor, paaftësisë ose shtatzanisë;
 - 6) Kryerës është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku, gjyshi ose gjyshja, daja, tezja, vëllai ose motra më e vjetër e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare;
 - 7) Kryerësi është në marrëdhënie të përbashkët familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Neni 197

KEQPËRDORIMI SEKSUAL I PERSONAVE ME ÇRREGULLIME MENDORE A EMOCIONALE OSE ME PAAFTËSI MENDORE

- (1) Kushdo që e detyron personin me çrregullime mendor a emocionale ose me paaftësi në akt seksual me kryerësin a personin e tretë duke shfrytëzuar çrregullimin dhe paaftësinë e personit të tillë dënohet me burgim prej një deri në dhjet vjet.
- (2) Kushdo që e prek për qëllime seksuale personin me çrregullim mendor a emocional ose të paaftë apo e cyt personin e tillë për të prekur kryerësin ose personin e tretë me qëllim seksual duke e shfrytëzuar çrregullimin ose paaftësinë e personit të tillë dënohet me burgim deri në pesë vjet.
- (3) Kushdo që e cyt personin me çrregullim mendor a emocional ose të paaftë t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të tij, të masturbojë ose të kryejë një akt i cili e degradon integritetin e tij seksual duke shfrytëzuar çrregullimin ose paaftësinë e personit të tillë dënohet me burgim deri në një vit.

(4) Nëse vepra penale nga neni 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 ose me burgim deri në tre vjet për veprën penale nga paragrafi 3 kur:

- 1) Veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura a trajtimi çnjerëzor;
- 2) Kryerësi i shkakton personit lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë të shëndetit mendor dhe fizik;
- 3) Kryerësi përdor armë ose ndonjë mjet të rrezikshëm;
- 4) Kryerësi me dashje e ka shkakuar dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës ose substancave të tjera;
- 5) Vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
- 6) Kryerës është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku, gjyshi ose gjyshja e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare;
- 7) Kryerësi është në marrëdhënie të përbashkët familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare;
- 8) Personi i është besuar kryerësit për trajtim këshillues profesional ose për përkujkujdesje.

(5) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e personit, kryerësi dënohet me burgim prej së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë.

Neni 198

KEQPËRDORIMI SEKSUAL I PERSONAVE NËN MOSHËN GJASHTËMBËDHJETË VJET

- (1) Kushdo që e detyron personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet për të kryer akt seksual dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (2) Kushdo që për qëllime seksuale e prek personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet ose e cyt personin nën gjashtëmbëdhjetë vjet që të prekë kryerësin ose personin e tretë për qëllime seksuale dënohet me burgim deri në pesë vjet.
- (3) Kushdo që e cyt personin nën moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare t'i ekspozojë pjesët intime të trupit të tij, të masturbojë apo të kryejë ndonjë akt tjetër që e degradon integritetin e tij seksual dënohet me burgim deri në një vit.
- (4) Nëse vepra nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet me marrëveshjen e dy personave që i kanë mbushur 14 vjet dhe diferenca ndërmjet moshave të tyre nuk i kalon 2 vjet, ose nëse diferenca në moshat e tyre është më e madhe se 2 vjet kur nuk ekziston një dallim i dukshëm në nivelin e pjekurisë midis dy personave, akti i tillë nuk përbën vepër penale.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në njëzet vjet, për veprën nga paragrafi 1 ose 2 deri në tre vjet ose me burgim deri në pesë vjet për veprën penale nga paragrafi 3 kur:

- 1) Veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose është përcjellur me tortura ose trajtim çnjerëzor;
- 2) Kryerësi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë të shëndetit mendor dhe fizik të personit;
- 3) Kryerësi përdorë armë ose ndonjë mjet të rrezikshëm;
- 4) Kryerësi me dashje e ka shkakuar dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës ose substancave të tjera;
- 5) Vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;
- 6) Kryerës është arsimitar, punëtor shëndetësor ose person të cilit i është besuar rritja, edukimi ose kujdesi i personit të tillë;
- 7) Kryerës është prind adoptues, prind birësues, njeri, gjysh ose gjyshe, dajë, tezja ose vëlla a motra më e vjetër e viktimës;
- 8) Kryerësi është në marrëdhënie të përbashkët familjare me viktimën.

(6) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës, kryerësi dënohet me burgim prej së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë.

(7) Kushdo që me anë të premtimit të rrejshëm për martesë e cyt personin në moshën prej gjashtëmbëdhjetë deri tetëmbëdhjetëvjeçare në akt seksual dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.

(8) Periudha e parashkrimit për ndjekjen e veprës penale nga ky nen fillon të rrjedh në ditën kur viktima e arrinë moshën tetëmbëdhjetëvjeçare.

(9) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 7 i këtij neni fillohet me anë të propozimit.

Neni 199

NXITJA E AKTEVE SEKSUALE OSE PREKJA SEKSUALE NGA PERSONAT NËN MOSHËN GJASHTËMBËDHJETË VJET

(1) Kushdo që ndërmjetëson, siguron ose i mundëson personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet të kryejë akt seksual me personin e tretë që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjet dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që ndërmjetëson, siguron apo i mundëson personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet të prekë personin e tretë i cili ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjet me qëllim seksual ose që t'i lejojë personit të tretë që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjet për ta prekur personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet me qëllim seksual dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet.

Neni 200

SHPËRDORIMI SEKSUAL DUKE KEQPËRDORUR POZITËN, AUTORITETIN APO PROFESIONIN

(1) Kushdo që e detyron personin tjetër të kryejë akt seksual:

- 1) Duke shpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, arsimimin ose të rrethanave të tjera të personit të tillë apo të personit të tretë;
- 2) Duke shpërdorur pozitën ose autoritetin mbi viktimën e cila mbahet e paraburgosur ose e ndalur dhe e cila i është besuar kryerësit për rritjen, arsimimin, mbikëqyrjen ose kujdesin ose
- 3) Duke shpërdorur pozitën ose autoritetin e tij mbi viktimën e cila është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet dhe e cila i është besuar kryerësit për rritjen, edukimin dhe kujdesin

dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryerësin a personin e tretë me qëllim seksual:

- 1) Duke shpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, të arsimimit ose të rrethanave të tjera të personit të tillë apo të personit të tretë;
- 2) Duke shpërdorur pozitën apo autoritetin mbi viktimën e cila mbahet e paraburgosur ose e ndalur dhe e cila i besohet kryerësit për rritjen, arsimimin, mbikëqyrjen a kujdesin ose
- 3) Duke shpërdorur pozitën a autoritetin e tij mbi viktimën e cila është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet dhe e cila i është besuar kryerësit për rritjen, edukimin dhe kujdesin

dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet.

(3) Afati i parashkrimit të ndjekjes së veprës penale nga ky nen fillon të rrjedhë ditën kur viktima i mbush tetëmbëdhjetë vjet.

Neni 201

MUNDËSIMI I PROSTITUCIONIT

- (1) Kushdo që me dije rekruton, organizon ose ndihmon një person tjetër apo ia lëshon lokalet një personi tjetër për qëllime të prostitucionit dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 kryhet brenda një rrethi prej 350 metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Kushdo që me dhunë, me kërcënim se do ta përdorë dhunën ose duke mbajtur personin tjetër në situatë të varësisë personale a ekonomike e detyron personin tjetër të merret me prostitucion dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet kundër personit të moshës mes gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.
- (5) Afati i parashkrimit të ndjekjes së veprës penale nga paragrafi 4 fillon të rrjedhë ditën kur viktimia i mbush tetëmbëdhjetë vjet.

Neni 202

KEQPËRDORIMI I FËMIJËVE NË PORNOGRAFI

- (1) Kushdo që prodhon pornografi për fëmijë, përdor ose përfshin fëmijën për krijimin ose për prodhimin e shfaqjeve të gjalla dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (2) Kushdo që shpërndan, shet, promovon, shfaq, transmeton ose e vë në dispozicion pornografinë për fëmijë dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Kushdo që siguron për vetveten ose për personin apo posedon pornografi për fëmijë dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.
- (4) Afati i parashkrimit të ndjekjes së veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni fillon të rrjedhë ditën kur viktimia i mbush tetëmbëdhjetë vjet.

Neni 203

TREGIMI I MATERIALIT PORNOGRAFIK PERSONAVE NËN MOSHËN GJASHTËMBËDHJETË VJET

Kushdo që shet, ofron të shesë ose i jep një personi nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet fotografi, material audioviziv a sende të tjera me përmbajtje pornografike ose me dije e lejon personin e tillë të shohë një shfaqje të gjallë me përmbajtje pornografike, apo me dashje e çon personin e tillë në një shfaqje të tillë dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

Neni 204

MARRËDHËNIET SEKSUALE BRENDA FAMILJEVE

- (1) Kushdo që kryen akt seksual me paraardhës ose pasardhës të familjes i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjet ose me motër apo vëlla që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjet dënohet me gjobë ose me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Kur prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku ose njerka, gjyshi apo gjyshja, tezja ose halla kryen akt seksual me fëmijën e tij, me fëmijën e birësuar, me thjeshtin e tij, me nipin ose me mbesën e vajzës a të djalit, me nipin ose me mbesën e motrave dhe të vëllezërve mes moshave gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeçare dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Nëse vëllai apo motra më e madhe kryen akt seksual me vëllanë apo motrën, me vëllanë ose motrën e adoptuar, me njerkun ose të njerkën, me vëllanë apo motrën e njerkut, që është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeçare, motra apo vëllai më i madh dënohet me dënimin nga paragrafi 2 i këtij neni.
- (4) Afati i parashkrimit të ndjekjes së veprës penale nga paragrafi 2 ose 3 fillon të rrjedhë ditën kur viktima i mbush tetëmbëdhjetë vjet.

KAPITULLI XX: VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS DHE FAMILJES

Neni 205

BIGAMIA

- (1) Kushdo që lidh martesë të re, derisa është i martuar, dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që lidh martesë me personin për të cilin e di se është i martuar dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.
- (3) Nëse pas kryerjes së veprës penale nga ky nen martesë e mëparshme është prishur ose nuk është më e vlefshme, ndjekja për veprën nga ky nen nuk fillohet e nëse ndjekja është filluar ajo duhet të ndërpritet.

Neni 206

MUNDËSIMI I LIDHJES SË MARTESËS SË KUNDËRLIGJSHME

Personi i autorizuar zyrtar para të cilit lidhet martesë, i cili gjatë ushtrimit të detyrës së tij zyrtare lejon lidhjen e martesës, ndonëse është në dijeni për pengesat të cilat e ndalojnë martesën dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Neni 207

MARTESA E DETYRUAR

- (1) Kushdo që e detyron personin tjetër që të lidhë kontratë martesore dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet kundër fëmijës, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet.

Neni 208

BASHKËJETESA ME PERSONA NËN MOSHËN GJASHTËMBËDHJETËVJEÇARE NË NJË BASHKËSI JASHTËMARTESORE

- (1) Personi madhor i cili bashkëjeton në një bashkësi jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër që ushtron autoritet prindor, që i lejon ose e cjt personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet të bashkëjetojë në një bashkësi jashtëmartesore me personin tjetër dënohet me dënimin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tri vjet.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 ose 3 i këtij neni kryhet me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Neni 209

NDRYSHIMI I STATUSIT FAMILJAR TË FËMIJËS

- (1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme e zëvendëson një fëmijë për një tjetër ose në ndonjë mënyrë tjetër ndryshon statusin familjar të fëmijës dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Tentativa për të kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.

Neni 210

RRËMBIMI I KUNDËRLIGJSHËM I FËMIJËS

- (1) Kushdo që fëmijën e mban në mënyrë të kundërligjshme apo e rrëmben nga prindi, prindi adoptues, kujdestari, personi tjetër i cili ushtron autoritet prindor apo nga enti të cilit fëmija i është besuar apo pengon ekzekutimin e vendimit të detyrueshëm të organit kompetent mbi dhënien në besim të fëmijës personit tjetër ose entit dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse kryerës i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni është prindi ndaj të cilit organi kompetent ka shqiptuar vendimin e detyrueshëm me të cilin i janë mohuar të drejtat prindore personit të tillë apo fëmija i është besuar për edukim dhe mbikëqyrje prindit a personit tjetër, kryerësi dënohet me burgim deri në një vit.

(3) Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni për interesa materiale apo për motive të tjera të ulëta dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 211

KEQTRAJTIMI APO BRAKTISJA E FËMIJËS

(1) Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindor mbi fëmijën i cili e keqtrajton fëmijën e tillë duke përdorur masa fizike a mentale apo e shkel detyrimin e vet për përkujdesje dhe edukim duke mos e përfillur fëmijën me pakujdesi të madhe dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.

(2) Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër i cili ushtron autoritet prindor mbi fëmijën i cili e braktis fëmijën e tillë në një mënyrë e cila e rrezikon jetën apo e dëmton rëndë shëndetin e tij dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(3) Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër që ushtron autoritet prindor mbi fëmijën, i cili e detyron fëmijën e tillë të punojë në mënyrë të tepruar ose të bëjë punë që nuk është e përshtatshme për moshën e fëmijës, e detyron fëmijën e tillë të lypë për para ose për dobi tjetër materiale ose e detyron fëmijën e tillë të bëjë veprime që e dëmtojnë zhvillimin e fëmijës dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(4) Nëse nga vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 e këtij neni rezulton me lëndim të rëndë të shëndetit mendor apo fizik të fëmijës, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 212

SHKELJA E DETYRIMEVE FAMILJARE

(1) Kushdo që duke i shkelur vrazhdë detyrimet e veta familjare ligjore e lë në gjendje të rëndë anëtarin e familjes i cili në një gjendje të dëshpëruar nuk është në gjendje të kujdeset për vete dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e anëtarit të familjes apo me dëmtimin e rëndë të shëndetit të tij, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(3) Nëse gjykata shqipton dënimin me kusht ajo mund të urdhërojë si kusht që kryerësi rregullisht t'i përmbush detyrimet e tij të kujdesit, arsimimit dhe sigurimit të mjeteve të jetesës.

Neni 213

SHMANGIA NGA SIGURIMI I MJETEVE TË JETESËS

- (1) Kushdo që i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin për të cilin është i obliguar të kujdeset në bazë të vendimit të gjykatës që ka hyrë në fuqi, marrëveshjes së arritur para gjykatës që ka hyrë në fuqi ose vendimit nga një organ tjetër kompetent dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse gjykata e shqipton dënimin me kusht ajo mund të urdhërojë si kusht që kryerësi të paguajë mjetet e jetesës si dhe detyrimet e papaguara.
- (3) Nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni i ka përmbushur detyrimet e veta para shqiptimit të aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 214

PENGIMI DHE MOSEKZEKUTIMI I MASAVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

- (1) Kushdo që e pengon ekzekutimin e masave edukative dhe masave të tjera të përcaktuara nga gjykata ose nga një organ tjetër kompetent përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që si person përgjegjës në punë, në organe apo në ente për mbrojtje, arsimimin ose aftësim profesional për fëmijët ushtron haptazi detyrat e tij në mënyrë të papërgjegjshme dhe me këtë e dëmton rëndë shëndetin apo zhvillimin e fëmijës, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

KAPITULLI XXI: VEPRAT PENALE KUNDËR SHËNDETIT PUBLIK

Neni 215

PËRHAPJA E SËMUNDJEVE NGJITËSE

- (1) Kushdo që duke mos vepruar sipas dispozitave apo urdhrave të organit publik kompetent në fushën e shëndetësisë, që cakton kontrollime, dezinfektive ose veçimin e personave të sëmurë apo masa të tjera me qëllim të parandalimit a të luftimit të sëmundjeve ngjitëse te njerëzit dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjes ngjitëse dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që duke mos iu përmbajtur dispozitave a urdhërave nga paragrafi 1 i këtij neni, me qëllim të parandalimit ose të luftimit të sëmundjeve ngjitëse te shtazët, e me këtë shkakton përhapjen e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit, dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë

vjet, e nëse vepra penale rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore ose me dëmtim të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim deri në tre vjet, e nëse vepra penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 216

MOSVEPRIMI SIPAS DISPOZITAVE SHËNDETËSORE GJATË KOHËS SË EPIDEMISË

Kushdo që gjatë kohës së epidemisë, të ndonjë sëmundjeje ngjitëse nuk vepron sipas urdhërave apo vendimeve të tjera të nxjerra në bazë të dispozitave të organit kompetent me të cilat caktohen masat që kanë për qëllim luftimin apo parandalimin e saj dënohet me burgim deri në një vit.

Neni 217

PËRHAPJA E SËMUNDJEVE VENERIKE

(1) Kushdo që duke ditur se është infektuar me virusin HIV apo me ndonjë sëmundje venerike dhe me dije e fsheh këtë fakt duke e infektuar tjetrin dënohet me burgim deri në një vit.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni ka shkaktuar dëmtim të rëndë dhe të përhershëm të shëndetit apo vdekjen e personit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(3) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni fillohet sipas propozimit.

Neni 218

PUNËSIMI I PERSONAVE TË SËMURË NGA SËMUNDJET NGJITËSE

(1) Kushdo që në kundërshtim me ligjet e shëndetësisë, në spital, në maternitet të spitalit, në shkollë, në restoran apo në punëtori ku përpunohen artikujt ushqimorë apo ku kryen shërbime higjienike, në organizatë biznesi apo në ndonjë vend të ngjashëm pune, e punëson apo e mban në punë personin për të cilin e di se lëngon nga sëmundja ngjitëse dhe me këtë shkakton përhapjen e sëmundjes dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni shkakton lëndime të rënda trupore ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim deri në tri vjet për veprën nga paragrafi 2.

(4) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni ka rezultuar me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 2.

Neni 219

TRAJTIMI I PANDËRGJEGJSHËM MJEKËSOR

(1) Mjeku i cili me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose nuk përdor masa përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Punonjësi shëndetësor i cili me rastin e dhënies së ndihmës ose të trajtimit shëndetësor vepron në mënyrë të pandërgjegjshme dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në një vit.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni shkakton lëndim të rëndë trupor apo çfarëdo dëmtimi të rëndë të shëndetit të personit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 ose me burgim deri në tre vjet për veprën nga paragrafi 3.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2, ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 3.

Neni 220

MOSDHËNIA E NDIHMËS MJEKËSORE

Mjeku i cili nuk ia ofron ndihmën e nevojshme mjekësore personit të cilit ndihma e tillë i është e nevojshme edhe pse është i vetëdijshëm apo ka mundur dhe është dashur të jetë i vetëdijshëm se mosveprimi i tillë mund të shkaktojë dëmtim të rëndë të shëndetit të personit apo vdekjen e tij dënohet me burgim deri në tri vjet.

Neni 221

USHTRIMI I KUNDËRLIGJSHËM I VEPRIMTARISË MJEKËSORE

(1) Kushdo që pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizime ligjore kryen trajtime mjekësore ose angazhohet në disa aktivitete të tjera mjekësore për të cilat ligji kërkon kualifikime të posaçme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

Neni 222

PËRGATITJA DHE DHËNIA E PANDËRGJEGJSHME E BARNAVE

- (1) Farmacisti apo personi tjetër që është i autorizuar të përgatisë apo të shpërndajë barna, i cili i përgatit në kundërshtim me standardet profesionale apo jep barna në mënyrën të gabuar dhe me këtë rrezikon shëndetin apo jetën e personit dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni shkakton lëndime të rënda trupore ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim deri në tre vjet për veprën nga paragrafi 2.
- (4) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni ka rezultuar me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet burgim për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 2.
- (5) Barnat e përgatitura konfiskohen.

Neni 223

PRODHIMI DHE VËNIA NË QARKULLIM E PRODUKTEVE TË DËMSHME MJEKËSORE

- (1) Kushdo që prodhon barna të dëmshme ose produkte të tjera mjekësore që janë të dëmshme për shëndetin me qëllim që t'i shesë ato apo në ndonjë mënyrë tjetër t'i vë në qarkullim dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 1, ose me burgim deri në tri vjet për veprën nga paragrafi 2 i këtij neni.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet për veprën nga paragrafi 1 ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 2.
- (5) Prodhimet mjekësore dhe mjetet për prodhimin e tyre konfiskohen.

Neni 224

PRODHIMI DHE VËNIA NË QARKULLIM E ARTIKUJVE TË DËMSHËM USHQIMORË

- (1) Kushdo që prodhon me qëllim të shitjes, shet a ofron për shitje apo në ndonjë mënyrë tjetër vë në qarkullim artikuj ushqimorë, pije apo prodhime të tjera për të cilat personi e di se janë të dëmshme për shëndetin e njerëzve dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni shkakton lëndime të rënda trupore ose ndonjë dëmtim të rëndë të shëndetit të personit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 1 ose me burgim deri në tri vjet për veprën nga paragrafi 2 i këtij neni.
- (4) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 2.
- (5) Artikujt dhe sendet e dëmshme konfiskohen.

Neni 225

KONTROLLIMI I PANDËRGJEGJSHËM I MISHIT TË DESTINUAR PËR KONSUMIM

- (1) Veterinari ose punëtori tjetër i autorizuar i veterinarisë i cili gjatë kontrollit të kafshëve për therrje apo për mishit të destinuar për ushqim vepron në kundërshtim me standardet profesionale ose në kundërshtim me dispozitat në fuqi të standardeve të praktikës veterinare ose nuk e kryen kontrollin dhe me këtë mundëson që të vëhet në qarkullim mishi i dëmshëm për shëndetin e njerëzve dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (3) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëmtim të rëndë të shëndetit të personit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 1 ose me burgim deri në tri vjet për veprën nga paragrafi 2.
- (4) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet për veprën nga paragrafi 1 ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 2.

Neni 226

NDOTJA E UJIT TË PIJSHËM

- (1) Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme e ndot ujin të cilin njerëzit e përdorin si ujë të pijshëm dhe kështu rrezikon jetën apo shëndetin e njerëzve dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre muaj.
- (3) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëmtim të rëndë të shëndetit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim deri në tre vjet për veprën nga paragrafi 2.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet për veprën nga paragrafi 1 ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 2.
- (5) Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme e ndot ujin të cilin kafshët e përdorin për pije dhe kështu rrezikon jetën apo shëndetin e kafshëve dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (6) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni rezulton me ngordhjen e kafshëve me vlerë që tejkalon 10.000 euro apo me ngordhjen e një numri të madh të kafshëve, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.

Neni 227

NDOTJA E ARTIKUJVE USHQIMORË TË DESTINUAR PËR PËRDORIM PËR NJERËZ APO PËR KAFSHË

- (1) Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme i ndot artikujt ushqimorë dhe në këtë mënyrë rrezikon jetën apo shëndetin e njerëzve dënohet me burgim deri në tre vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre muaj.
- (3) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën nga paragrafi 1 ose me burgim deri në tri vjet për veprën nga paragrafi 2.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezultojnë me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 1 ose me burgim prej një deri në tetë vjet për veprën penale nga paragrafi 2.
- (5) Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme e ndot ushqimin e kafshëve, të cilat janë të destinuara për ushqimin e njerëzve dhe me këtë rrezikon jetën apo shëndetin e njerëzve dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni rezulton me ka shkaktuar ngordhjen e kafshëve me vlerë që tejkalon 10.000 euro apo të një numri të madh të kafshëve, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.

Neni 228

SHËRBIMI I PERSONAVE NËN MOSHËN GJASHTËMBËDHJETË VJET ME PIJE ALKOOLIKE

(1) Kushdo që në lokalin hotelier, në bar apo në ndonjë dyqan tjetër ku shiten pije alkoolike e shërben personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet me pije alkoolike dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre muaj.

Neni 229

BLERJA, POSEDIMI, SHPËRNDARJA DHE SHITJA E PAAUTORIZUAR E NARKOTIKËVE TË RREZIKSHËM DHE E SUBSTANCAVE PSIKOTROPIKE

(1) Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim shitje, shpërndarje ose ofron për shitje substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë dhe substanca psikotropike dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

(3) Kushdo që paautorizim eksporton ose importon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope dënohet me gjobë dhe burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2, ose 3 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet kur:

- 1) Kryerësi vepron si anëtar i një grupi;
- 2) Kryerësi është anëtar i forcave policore ose përgjegjës për zbatimin e ligjit;
- 3) Kryerësi është person zyrtar i cili vepron gjatë ushtrimit të detyrave të tij;
- 4) Kryerësi përdor ose kërcënon se do ta përdorë dhunën ose armën gjatë kryerjes së veprës;
- 5) Vepra kryhet duke e shfrytëzuar fëmijën ose në dëm të personit të tillë;
- 6) Vepra është kryer kundër personit posaçërisht të ndjeshëm si rezultat i moshës, sëmundjes, paaftësisë fizike apo mendore ose çrregullimit apo shtatzanisë, gjë që ka qenë një fakt i njohur ose i dukshëm për kryerësin;

- 7) Dërgesa, ngarkesa, kontejneri ose mjete i planifikuar për një operacion humanitar është përdorur për transportimin e paligjshëm të narkotikëve ose të substancave psikotropike;
 - 8) Personi ka përzier substancat narkotike dhe psikotropike me substanca të tjera, me ç'rast ka shtuar rrezikun për shëndetin e njeriut dhe
 - 9) Personi e intoksikon personin tjetër me substanca narkotike ose psikotropike pa dijeninë e tij.
- (5) Narkotikët dhe substancat psikotropike konfiskohen.

Neni 230

PRODHIMI DHE PËRPUNIMI I PAAUTORIZUAR I NARKOTIKËVE TË RREZIKSHËM DHE I SUBSTANCAVE PSIKOTROPIKE

- (1) Kushdo që pa autorizim kultivon, prodhon, përpunon, ekstraktin ose përgatit substanca a preparate që janë shpallur të rrezikshme si narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim për shitje, shpërndarje ose ofrim për shitje dënohet me gjobë dhe burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (2) Kushdo që pa autorizim shet substancën analoge ose e përpunon substancën analoge me qëllim të shitjes, shpërndarjes ose ofrimit për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet.
- (3) Kushdo që pa autorizim shet ose furnizon pajisje a materiale duke e ditur se janë përdorë ose do të përdoren për kultivimin e paligjshëm, prodhimin, përpunimin apo trafikimin e cilësdo substance ose preparati që është shpallur i rrezikshëm si narkotik ose substance psikotropike a analoge dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tre vjet.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet në një ose në më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në trembëdhjetë vjet ose me gjobë dhe me burgim, nëse:
 - 1) Kryerësi vepron si anëtar i një grupi;
 - 2) Kryerësi është pjesëtar i forcave policore apo është përgjegjës për zbatimin e ligjit;
 - 3) Kryerësi është person zyrtar i cili vepron gjatë ushtrimit të detyrës së tij;
 - 4) Vepra është kryer duke përdorur fëmijën ose në dëm të personit të tillë;
 - 5) Personi ka përzier narkotikët ose substancat e rrezikshme psikotropike me substanca të tjera, me ç'rast ka shtuar rrezikun për shëndetin.
- (5) Narkotikët, substancat psikotropike, analogët ose mjetet e prodhimit të tyre konfiskohen.

(6) Sipas këtij neni dhe nenit 231 shprehja “analoge” është cilado substancë e cila nuk është e lejuar dhe struktura kimike e së cilës është dukshëm e ngjashme me atë të drogave ose substancave apo preparateve që janë shpallur të rrezikshme si narkotikë ose substanca psikotropike efektet e të cilave i riprodhon.

Neni 231

LEHTËSIMI I SIGURIMIT APO PËRDORIMIT TË NARKOTIKËVE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPIKE APO ANALOGËVE TË RREZIKSHME

(1) Kushdo që adminstron me narkotikë, me substanca psikotropike ose analoge dhe, për shkak të detyrës që ka, lehtëson sigurimin ose përdorimin e tyre në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(2) Drejtuesi ose pronari i lokalit apo i hapësirës tjetër të mbyllur të cilën e përdor publiku i cili lejon apo toleron përdorimin e narkotikëve, substancave psikotropike ose substancave të rrezikshme analoge dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

KAPITULLI XXII: VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË

Neni 232

CENIMI I BARAZISË NË USHTRIMIN E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kushdo që duke keqpërdorur detyrën zyrtare apo autorizimet e kufizon qarkullimin e lirë të kapitalit në territorin e Kosovës, mohon apo kufizon të drejtën e organizatës së biznesit ose të personit tjetër juridik që në territorin e Kosovës të merret me qarkullimin e mallit ose të shërbimeve apo e vë organizatën e biznesit a personin tjetër juridik në pozitë të pabarabartë ndaj organizatës së biznesit ose personit tjetër juridik lidhur me kushtet për punë apo për kryerjen e qarkullimit të mallit apo të shërbimit apo që kufizon këmbimin e lirë të mallit ose të shërbimeve, dhe nga kjo realizohet fitim i konsiderueshëm për atë organizatë të biznesit ose për personin juridik ose shkaktohet dëm i madh për tjetrin, dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Neni 233

VEPRIMTARIA E PANDËRGJEGJSHME EKONOMIKE

(1) Personi përgjegjës në organizatën e biznesit ose në personin juridik i cili duke shkelur me vetëdije ligjin apo dispozitën tjetër të afarizmit vepron në mënyrë të pandërgjegjshme dhe me këtë i shkakton dëm të konsiderueshëm material asaj organizate të biznesit apo atij personi juridik dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me likuidim të detyrueshëm ose falimentim të asaj organizate të biznesit apo të personit juridik, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 234

SHKAKTIMI I FALIMENTIMIT

Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili, duke ditur paaftësinë paguese të organizatës së biznesit ose të personit juridik, me shpenzimin joracional të mjeteve apo transferin e tyre me çmim tejet të ulët, me ngarkim të tepruar me borxh, me marrjen përsipër të detyrimeve joproporcionale, me përfundimin ose përtëritjen e paarsyeshme të kontratave me personat e paaftë për pagesë ose me mosrealizimin në kohë të kërkesave shkakton falimentimin dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 235

DËMTIMI I KREDITORËVE

(1) Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik që e di se organizata e biznesit apo personi juridik, i cili me pagimin e borxhit apo në mënyrë tjetër e vë ndonjë kreditor në pozitë më të volitshme dhe në mënyrë të konsiderueshme i dëmton kreditorët tjerë dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili e di se organizata e biznesit apo personi juridik ka falimentuar dhe me qëllim që të mashtrrojë apo t'i shkaktojë dëm kreditorit pranon kërkesën e pavërtetë, lidh kontrata të rreme apo me veprim tjetër mashtrues e dëmton kreditorin e organizatës së biznesit ose personit juridik dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me dëmin që kalon shumë më 250.000 euro apo kur pala e dëmtuar si pasojë e kësaj është detyruar t'i nënshtrohet riorganizimit ose procedurës së falimentimit, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 236

KEQPËRDORIMI I AUTORIZIMEVE NË EKONOMI

(1) Personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo në personin juridik i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit ose personin juridik në të cilin është i punësuar apo organizatën tjetër të biznesit ose për personin juridik dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet nëse ai kryen ndonjërin prej veprave të mëposhtme:

- 1) Krijon apo mban fonde të palejuara në Kosovë ose në çfarëdo juridiksioni tjetër;
- 2) Me përpilimin e dokumenteve me përmbajtje të rrejshme, me bilance të rreme, me vlerësime apo inventarizim apo me prezentim tjetër të rremë a me fshehjen e fakteve në mënyrë të rreme e prezenton lëvizjen e mjeteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e biznesit apo në personin juridik gjatë vendimmarrjes lidhur me punët e qeverisjes;
- 3) Nuk i paguan mjetet nga detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera fiskale në Kosovë të përcaktuara me ligj;

- 4) Mjetet me të cilat disponon i shfrytëzon në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë ose
 - 5) Në mënyrë tjetër e cenon rëndë ligjin apo rregullat e afarizmit lidhur me rregullimin, përdorimin apo administrimin e pasurisë.
- (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me fitim material në shumën që kalon 100,000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 237

LIDHJA E KONTRATËS SË DËMSHME

- (1) Personi i autorizuar a përfaqësuesi i organizatës së biznesit apo personit juridik që ushtron veprimtari ekonomike dhe lidh kontratë për të cilën e di se është e dëmshme për organizatën e biznesit ose për personin juridik apo lidh kontratë në kundërshtim me autorizimet e tij dhe me këtë i shkakton dëm organizatës së biznesit apo personit juridik dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 i këtij neni merr rryshfet apo nëse shkakton dëm në shumën e cila tejkalon 100,000 euro dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 238

KUMTIMI I PAAUTORIZUAR I SEKRETIT TË PUNËS

- (1) Kushdo që në kundërshtim me detyrat e tij për ruajtjen e sekretit të punës ia kumton apo ia dorëzon personit tjetër të dhënat lidhur me sekretin e punës ose në ndonjë mënyrë tjetër ia bën të mundshme personit tjetër qasjen a mbledhjen e të dhënave të tilla me qëllim që t'ia dorëzojë personit të paautorizuar dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (2) Kushdo që me qëllim të përdorimit në mënyrë të paautorizuar arrin në mënyrë të kundërligjshme deri te të dhënat të cilat ruhen si sekrete të tregtisë dënohet me dënimin e njëjtë nga paragrafi 1 i këtij neni.
- (3) Nëse të dhënat nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni janë të një rëndësie të posaçme ose nëse të dhënat e këtilla i dorëzon me qëllim që këto të dhëna t'i nxjerrë jashtë Kosovës apo nëse vepra është kryer me qëllim të përfitimit material, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 3 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në një vit.
- (5) Sipas këtij neni fjala “sekret i punës” do të thotë të dhëna që janë cilësuar si të tilla me ligj ose me dispozita të organizatës së biznesit ose të personi tjetër juridik dhe të cilat paraqesin sekretin e prodhuesit, rezultatin e punës hulumtuese ose të disenjimit si dhe të dhëna të tjera zbulimi i të cilave për ndonjë person të paautorizuar mund të kishte pasoja të dëmshme për interesin ekonomik të organizatës së biznesit apo të personit juridik.

Neni 239

FALSIFIKIMI I PULLAVE POSTARE DHE LETRAVE ME VLERË

- (1) Kushdo që prodhon pulla fiskale, pulla postare me vlerë ose pulla të tjera të rreme me vlerë ekonomike të cilat janë të emituara në bazë të ligjeve në Kosovë, e ndryshon ndonjëherë nga këto pulla me qëllim që t'i përdorë ato si të vërteta apo që tjetrit t'ia japë për t'i përdorur ose i përdor pullat e tilla të rreme si të vërteta dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin pulla me vlerë që tejkalon 10.000 euro, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (3) Kushdo që prodhon letra të rreme me vlerë të emituara në bazë të ligjeve në Kosovë ose ndryshon ndonjëherë nga këto letra me vlerë me qëllim që t'i përdorë si të vërteta apo që t'ia jep tjetrit për t'i përdorur ose letrat e tilla të rreme i përdor si të vërteta dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (4) Kushdo që e shlyen pullën e vulosur nga pulla me vlerë nga paragrafi 1 i këtij neni ose në ndonjë mënyrë tjetër dhe me qëllim të përdorimit të vazhdueshëm mundohet që këtyre pullave t'u jep pamjen sikur nuk janë përdorur asnjëherë përpara ose përdor shenjën e përdorur apo e shet atë si të vlefshme dënohet me burgim jo më shumë se tri vjet.
- (5) Tentativa e veprës penale nga paragrafi 1, 2 ose 4 i këtij neni është e dënueshme.
- (6) Pullat me vlerë të rreme dhe letrat me vlerë konfiskohen.

Neni 240

CENIMI I TË DREJTËS SË PATENTËS

- (1) Kushdo që në kuadër të një veprimtarie ekonomike e përdor pa autorizim patentën e regjistruar ose të mbrojtur me ligj apo topografinë e regjistruar të një qarku të mbyllur të një gjysmëpërçuesi dënohet me gjobë ose me gjobë dhe me burgim deri në tre vjet.
- (2) Sendet nga paragrafi 1 i këtij neni të prodhuara për përdorim të paautorizuar konfiskohen.

Neni 241

PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I FIRMËS, I MARKËS APO I MODELIT TË HUAJ

- (1) Kushdo që gjatë angazhimit në veprimtarinë ekonomike dhe me qëllim të mashtrimit të blerësit apo shfrytëzuesit të shërbimeve përdor firmën e huaj, markën e huaj, markën e mallit apo markën e shërbimit të huaj apo markën e huaj lidhur me prejardhjen gjeografike a shenjat e tjera të posaçme të mallit apo pjesëve të tij në firmën e vet, në markën e vet apo në shenjat e veta të posaçme të mallit dënohet me burgim deri në dy vjet.
- (2) Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësit e përdor në prodhim pa autorizim mostrën a modelin e huaj apo i vë në qarkullim artikujt e prodhuar në këtë mënyrë dënohet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

- (3) Sendet nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni konfiskohen.

Neni 242

MASHTRIMI I BLERËSVE

(1) Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve vë në qarkullim prodhime me shenjën në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit, vë në qarkullim produkte të cilat për nga pesha apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla apo vë në qarkullim produkte pa shenja që tregojnë për përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

(2) Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve shpall rrejshëm se është zbritur çmimi i mallit apo se pritet rritja e çmimeve ose në ndonjë mënyrë tjetër përdor haptaz reklamë të rreme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Neni 243

ORGANIZIMI I SKEMAVE PIRAMIDALE DHE I BIXHOZIT TË PALIGJSHËM

(1) Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit apo të veprimtarisë, tek të cilat pjesëmarrësit i paguajnë shuma të caktuara parash pjesëmarrësve të tjerë të cilët para atyre janë kyçur në lojë apo në veprimtari dhe presin pagesën e shumës së caktuar të të hollave nga pjesëmarrësit të cilët pas tyre pritët të kyçen në bixhozin ose në veprimtarinë e tillë dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo tjetrit përfitim material të kundërligjshëm organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove ose lojërave të fatit për të cilën nuk ka qenë e dhënë më parë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent dënohet me dënimin e njëjtë nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me dëm më të madh se 25.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

(4) Sipas këtij neni,

1) Shprehja “lojëra të llojit kazino” do të thotë loja ose veprimtaria e cila përfshin fatin, e që tradicionalisht zhvillohet në kazino, ku paratë ose gjësendet tjera me vlerë transferohen në bazë të epilogut të lojës ose veprimtarisë dhe përfshin ruletin por nuk kufizohet me rulet, lojë me zare, poker, automate monedhash, njëzetëshe, bingo dhe makina elektronike, mekanike ose video të cilat i ofrojnë këto lojra.

2) Shprehja “lojra të fatit” do të thotë veprimtari afariste e cila i ofrohet opinionit të gjerë e cila përfshin rastin dhe fatin dhe përfshin por nuk kufizohet vetëm me lotarinë, tiketat e fatit, lojërat bingo, automatet me monedha, vënien e basteve, lojërat me numra, lojërat e fatit për mallra dhe kartelat gërvishtëse në të cilat ndahen çmimet në para dhe çmimet e tjera në bazë të rezultatit i cili caktohet sipas fatit.

Neni 244

FALSIFIKIMI I PARASË

- (1) Kushdo që prodhon para të falsifikuara me qëllim për t'i vënë në qarkullim si të vërteta ose e ndryshon paranë e vërtetë me qëllim për ta vënë në qarkullim, apo kushdo që paranë e tillë të falsifikuar e vë në qarkullim dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (2) Kushdo që prokuron para të falsifikuara me qëllim që t'i vë në qarkullim si të vërteta dënohet sipas paragrafit 1 të këtij neni.
- (3) Kushdo që e vë në qarkullim paranë e falsifikuar, duke e ditur se paraja e tillë është e falsifikuar ose ka dijeni për prodhimin a qarkullimin e parave të falsifikuara dhe këtë nuk e lajmëron dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (4) Paraja e falsifikuar si dhe pajimet për prodhimin e saj konfiskohen.

Neni 245

PRODHIMI DHE SHFRYTËZIMI I SHENJAVE TË ETIKETAVE, MASAVE DHE PESHAVE TË RREME

- (1) Kushdo që me qëllim të përdorimit si të vërteta prodhon shenja të rreme për etiketimin e mallit, si dhe vula apo pulla për vulosjen e arit, argjendit, bagëtisë, drurit apo ndonjë malli tjetër apo shenjat e tilla të vërteta i ndryshon ose shenjat e rreme i përdor si të vërteta dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.
- (2) Kushdo që bën falsifikimin e masave dhe të peshave dënohet sipas paragrafit 1 të këtij neni.
- (3) Kushdo që pa autorizim furnizon, shet apo jep në përdorim mjete për prodhimin e vulave për shenjimin e mallit ose të masave të rreme dhe të peshave dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (4) Shenjat e rreme të etiketave, vulat, masat dhe peshat si dhe pajimet për prodhimin e tyre konfiskohen.

Neni 246

TREGTIA E NDALUAR

- (1) Kushdo që pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallit a të sendeve, qarkullimi i të cilave është i ndaluar apo i kufizuar, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 i këtij neni ka organizuar rrjetin e stërshitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumë 15.000 euro dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Malli dhe sendet e tregtisë së ndaluar konfiskohen.

Neni 247

PRODHIMI I NDALUAR

- (1) Kushdo që pa autorizim prodhon apo përpunon mallin, prodhimi apo përpunimi i të cilit është i ndaluar, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.
- (2) Malli dhe mjetet për prodhimin ose për përpunim e tyre konfiskohen.

Neni 248

LËSHIMI I ÇEQEVE PA MBULESË OSE TË RREMË DHE KEQPËRDORIMI I KARTELAVE TË BANKËS APO TË KREDITIT

- (1) Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes ose tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme e jep apo e vë në qarkullim çekun për të cilin e di se nuk ka mbulesë të mjeteve, çekun e rremë ose kartelën e falsifikuar të kredisë dhe kështu realizon dobi pasurore dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (2) Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme e përdor kartelën e bankës në automatën e bankës për tërheqjen e parave të gatshme për të cilën e di se nuk ka mbulesë në llogari rrjedhëse apo e përdor kartelën e kredisë për të cilën e di se në kohën e pagesës nuk do të jetë në gjendje të sigurojë shumën përkatëse dhe kështu realizon dobi pasurore dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni rezulton me dobinë pasurore që tejkalon 15.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 249

SHMANGIA NGA TATIMI

- (1) Kushdo i cili me qëllim që ai apo personi tjetër t'i shmanget pjesërisht apo tërësisht pagimit të tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera të përcaktuara me ligj jep të dhëna të pavërteta për të ardhurat e veta apo nuk i përfshin informatat lidhur me të ardhurat e tij, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të këtilla dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tri vjet.
- (2) Nëse shuma e detyrimit nga paragrafi 1 i këtij neni, pagimi i të cilit shmanget është më e lartë se 15.000 euro, kryerësi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 250

PRANIMI I PAARSYETUESHËM I DHURATAVE

- (1) Kushdo i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kërkon apo pranon dhuratë, shpërbllim apo ndonjë përfitim tjetër jorproporcional me qëllim të lënies anash të interesave të organizatës së tij të biznesit ose të personit juridik a të shkaktimit të dëmit në të me rastin e lidhjes së kontratës apo pajtohet për kryerjen e ndonjë shërbimi dënohet me gjobë a me burgim deri në tri vjet.

- (2) Kushdo që duke kryer veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni kërkon apo pranon dhuratë o shpërblim apo ndonjë fitim joproportional për vete ose për cilindo person të tretë që ka si kundërshtërbim arritjen e ndonjë kontrate ose marrëveshjeje që të kryhet ndonjë shërbim dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (3) Kushdo që duke kryer veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni kërkon apo pranon dhuratën, shpërblimin a ndonjë përfitim tjetër pas lidhjes së kontratës apo pas kryerjes së shërbimit dënohet me burgim deri në një vit.
- (4) Dhurata e pranuar apo shpërblimi konfiskohet.

Neni 251

DHËNIA E PAARSYETUESHME E DHURATAVE

- (1) Kushdo që jep, tenton të jep apo premtion dhuratë a shpërblim joproportional ose ndonjë fitim tjetër për personin i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të lënies anash të interesave të organizatës së biznesit ose të personit juridik ose të shkaktimit të dëmit organizatës së tillë të biznesit a personit juridik me rastin e lidhjes së kontratës ose kryerjes së ndonjë shërbimi dënohet me burgim deri në tre vjet.
- (2) Kushdo që i jep, tenton t'i jepë, i premtion t'i jepë dhuratë apo shpërblim disproporcional apo çfarëdo përfitim personit i cili ushtron veprimtari ekonomike me qëllim të arritjes së ndonjë përparësie të paarsyetueshme për lidhjen e kontratës apo për kryerjen e ndonjë shërbimi dënohet me burgim deri në një vit.
- (3) Nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni jep dhuratë apo shpërblim me kërkesë dhe nëse veprën e lajmëron para së të jetë zbuluar apo para se ai të jetë njoftuar se është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.
- (4) Dhurata apo shpërblimi i dhënë konfiskohet, pos në rastin nga paragrafi 3 i këtij neni kur mund t'i kthehet atij që e ka dhënë.

KAPITULLI XXIII: VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË

Neni 252

VJEDHJA

- (1) Kushdo që tjetrit ia merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.
- (2) Tentimi për të kryer veprën nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.
- (3) Nëse kryerësi ia kthen personit të dëmtuar pasurinë e vjedhur para se të jetë njoftuar se ndaj tij është filluar ndjekja penale, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 253

VJEDHJA E RËNDË

- (1) Kushdo që kryen vjedhje nga neni 252(1) dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, nëse vepra është kryer në mënyrën e mëposhtme:
 - 1) Duke thyer me forcë ndërtesat e mbyllura, dhomat, arkat ose sanduqet a hapësira të tjera të mbyllura përmes përdorimit të forcës ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme;
 - 2) Duke vepruar në mënyrë posaçërisht të rrezikshme dhe të vrazhdë;
 - 3) Duke shfrytëzuar gjendjen e krijuar si rezultat i zjarrit, vërshimit, tërmetit apo fatkeqësive të tjera ose
 - 4) Duke shfrytëzuar paaftësinë ose gjendjen tjetër të rëndë të personit tjetër.
- (2) Kushdo që kryen vjedhje nga neni 252(1) dënohet sipas paragrafit 1 të këtij neni:
 - 1) Nëse pasuria e vjedhur është me vlerë që tejkalon 15.000 euro, ndërsa kryerësi ka vepruar me qëllim të përvetësimit të sendit me vlerë të tillë;
 - 2) Nëse pasuria e vjedhur shërben për qëllime fetare ose është vjedhur nga ndërtesa fetare apo nga ndërtesa të tjera ku mbahen ceremoni fetare;
 - 3) Nëse është vjedhur vlera kulturore apo pasuria me rëndësi të posaçme shkencore, artistike, teknike apo nëse është pjesë e koleksionit publik, e koleksionit privat të mbrojtur apo e ekspozitës publike.
- (3) Kushdo që kryen vjedhje nga neni 252(1) i këtij Kodi si anëtar i grupit derisa me vete mban ndonjë armë apo mjet të rrezikshëm me qëllim sulmi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 254

VJEDHJA GRABITQARE

(1) Kushdo që, i zënë në befasi në kryerjen e aktit të vjedhjes dhe me qëllim që pasurinë e vjedhur ta mbajë, e përdor dhunën apo kanosjen se do të sulmojë jetën apo trupin e personit tjetër dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit ose duke përdorur ndonjë armë a mjet të rrezikshëm, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjet.

Neni 255

GRABITJA

(1) Kushdo që e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tjetër me qëllim që t'i sjellë vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdorur dhunën apo kanosjen kundër personit tjetër se do ta sulmojë atqashtëm jetën apo trupin e personit tjetër dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni ka të bëjë me sendin e vjedhur me vlerë që tejkalon 10,000 euro dhe nëse kryerësi ka për qëllim ta përvetësojë sendin me vlerë të tillë, kryerësi dënohet me së paku tre vjet burgim.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga kryerësi duke vepruar si anëtar i grupit ose duke përdorur ndonjë armë a mjet të rrezikshëm, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjet.

Neni 256

RASTET E RËNDA TË VJEDHJES GRABITQARE APO TË GRABITJES

(1) Nëse kryerja e vjedhjes grabitçare apo grabitjes rezulton me lëndim të rëndë trupor ose është kryer nga një grup i armatosur apo nëse është përdorur ndonjë armë a mjet i rrezikshëm, kryerësi dënohet me së paku pesë vjet burgim.

(2) Nëse kryerja e vjedhjes grabitçare apo e grabitjes rezulton me privimin ga jeta e personit me qëllim, kryerësi dënohet me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë.

Neni 257

SHPËRDORIMI

(1) Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër e cila i është besuar atij, dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Nëse veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen kujdestari, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre vjet.

- (3) Nëse vlera e pasurisë së përvetësuar e tejkalon shumë prej 15.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (4) Nëse pasuria e përvetësuar ka vlerë të posaçme shkencore, kulturore apo historike, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.
- (5) Kushdo që përvetëson në mënyrë të kundërligjshme pasurinë e luajtshme të personit tjetër, të cilën ai e ka gjetur ose i ka rënë në dorë rastësisht, me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (6) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1, 2 ose 5 i këtij neni fillohet sipas propozimit.

Neni 258

MARRJA E PASURISË SË LUAJTSHME

- (1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër që ta mbajë në posedim të vetin pa qëllim të përvetësimit, dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (2) Tentimi i kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet nëse ka të bëjë me marrjen e automjetit nga personi tjetër.
- (3) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni fillohet në bazë të padisë private, apo nëse pasuria është në pronësi ose nën administrimin e një organi publik sipas propozimit.

Neni 259

PUSHTIMI I PALIGJSHËM I PRONËS SË PALUAJTSHME

- (1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse prona e paluajtshme e pushtuar është pjesë e pyllit të mbrojtur, parkut të mbrojtur apo pyllit tjetër me destinim të posaçëm apo është tokë ndërtimore, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Neni 260

DËMTIMI I PASURISË SË LUAJTSHME

- (1) Kushdo që e dëmton, e asgjëson apo e bën të papërdorshme pasurinë e luajtshme të personit tjetër dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni motivohet nga paragjykimi lidhur me përkatësinë etnike apo nacionale, racore, fetare, të gjinisë, të orientimit seksual apo të gjuhës, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Neni 261

MASHTRIMI

(1) Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet dhe me këtë e shtyt personin e tillë që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë së tij ose të pasurisë së ndonjë personi tjetër, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëm i cili e tejkalon shumën prej 15,000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 262

MASHTRIMI LIDHUR ME SUBVENCIONET

Kushdo që i jep informacion të pasaktë ose jo të plotë një organi kompetent që është thelbësore për të dhënë subvencion nga organi kompetent, e fsheh informacionin e tillë në kundërshtim me detyrimin për t'ia zbuluar informacionin e tillë autoritetit kompetent ose e shpërdoron një subvencion të tillë dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Neni 263

KEQPËRDORIMI I SIGURIMIT

(1) Kushdo që me qëllim të arkëtimit të parave të sigurimit nga siguruesi e asgjëson, e dëmton apo e fsheh pasurinë e siguruar nga asgjësimi, dëmtimi, humbja apo vjedhja dhe pastaj e lajmëron asgjësimin, dëmtimin, humbjen apo vjedhjen e tillë dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Kushdo i cili me qëllim që nga siguruesi të arkëtojë paratë e sigurimit për rastet e lëndimit trupor apo të dëmtimit të shëndetit i shkakton vetes lëndim apo dëmtim të shëndetit dhe pastaj e lajmëron lëndimin apo dëmtimin dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Tentativa për vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet.

(4) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni fillohet sipas propozimit.

(5) Nëse kryerësi heq dorë nga kërkesa për kompenzimin e dëmit para se të jetë njoftuar se mashtrimi është zbuluar, gjykata mund ta lirojë kryerësin nga dënimi.

Neni 264

HYRJA NË SISTEMET KOMPJUTERIKE

- (1) Kushdo që në mënyrë të paautorizuar dhe me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të paligjshme apo t'i shkaktojë dëme personit tjetër ndryshon, publikon, shlyen, asgjëson a shkatërrohet të dhëna kompjuterike, programe kompjuterike apo në çfarëdo mënyre tjetër hyn në sistemin kompjuterik dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi të madhe pasurore apo me dëm të madh pasuror që tejkalon 15.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Ndjekja penale për veprën penale nga ky nen fillohet sipas propozimit.

Neni 265

VEPRAT E VJEDHJES SË IMTË, SHPËRDORIMIT APO MASHTRIMIT

- (1) Kushdo që kryen veprë të vjedhjes së imtë, shpërdorimit apo mashtrimit dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (2) Vepra e vjedhjes së imtë, e shpërdorimit apo e mashtrimit ekziston nëse vlera e pasurisë së vjedhur ose të shpërdoruar apo dëmi i shkaktuar me mashtrim nuk kalon shumë prej 25 euro, ndërsa qëllimi i kryerësit ka qenë përvetësimi i sendit apo shkaktimi i dëmit me vlerë të tillë.
- (3) Ndjekja penale për veprën nga paragrafi 1 i këtij neni fillohet në bazë të padisë private.

Neni 266

LIRIMI NGA DËNIMI

Nëse kryerësi i veprës penale nga neni 257, 258, 265 ose 269 i këtij Kodi e kthen pasurinë e vjedhur të cilën ai e ka poseduar ose përvetësuar para se të njoftohet për fillimin e procedurës penale, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 267

DETYRIMI

- (1) Kushdo i cili me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme përdor forcën apo kërcënimin e rëndë për ta detyruar personin tjetër që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë së vet a të pasurisë së personit tjetër dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit duke përdorur ndonjë armë ose mjet të rrezikshëm apo rezulton me dobi të madhe pasurore, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 268

SHANTAZHI

(1) Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme i kanoset personit tjetër se kundër tij apo personave të tij të afërt do të zbulojë diç që do ta dëmtojë nderin apo autoritetin e tyre dhe me këtë e detyron atë person të veprojë ose të mosveprojë në dëm të pasurisë së tij a pasurisë së ndonjë personi tjetër dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtarë i grupit duke përdorur ndonjë armë ose mjet të rrezikshëm apo rezulton me dobi të madhe pasurore, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 269

KEQPËRDORIMI I BESIMIT

(1) Kushdo që gjatë përfaqësimit të interesave pronësore të personit tjetër ose kujdesjes për pasurinë e tij nuk i përmbush detyrimet e tij ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes ose personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo ta dëmtojë personin interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen kujdestari apo avokati, kryerësi dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

Neni 270

KONTRAKTIMI I PËRFITIMIT JOPROPORCIONAL

Kushdo që në emër të vet ose në emër të personit tjetër merr o negocion haptas përfitim joproporcional për shërbimin që ia kryen personit tjetër duke e shfrytëzuar gjendjen e vështirë financiare, kushtet e rënda të banimit, mjerimin, mospërvijën apo paaftësinë e gjykimit të atij personi dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

Neni 271

DËMTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONIT TJETËR

(1) Kushdo që me qëllim të pengimit të realizimit të kërkesës pasurore bart, shkatërron apo e largon ndonjë send në pronësi të tij ose pronë në të cilën personi tjetër ka interes në bazë të hipotekës a të drejtës për të shfrytëzuar dhe me këtë i shkakton dëme atij personi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që me qëllim të pengimit të pagimit të borxhit të kreditorit gjatë ekzekutimit të dhunshëm bart, shkatërron apo fsheh pjesë të pasurisë dhe me këtë dëmton kreditorët, dënohet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 272

PRANIMI I MALLRAVE TË VJEDHURA

- (1) Kushdo që blen, pranon si kolateral, si hipotekë apo në ndonjë mënyrë tjetër e siguron ose e fsheh sendin të cilin ai e di se është përfituar me kryerjen e veprës penale ose sendin i cili është përfituar për atë send nëpërmjet shitjes apo këmbimit dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Kush blen, pranon si hipotekë apo në ndonjë mënyrë tjetër e prokuron ose e fsheh sendin për të cilin ai mund të ketë ditur se është siguruar me kryerjen e veprës penale ose sendin i cili është përfituar për atë send nëpërmjet shitjes a këmbimit dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.
- (3) Tentativa për të kryer veprë penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është e dënueshme.

Neni 273

KONTRABANDIMI I MALLRAVE

- (1) Kushdo që pa autorizim ose pa leje bën tregti apo në ndonjë mënyrë tjetër bart mallrat brenda a jashtë territorit të Kosovës dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.
- (2) Mallrat e kontrabanduara konfiskohen.

Neni 274

KRIMI I ORGANIZUAR

- (1) Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 euro dhe me burgim së paku shtatë vjet.
- (2) Kushdo që aktivisht merr pjesë në aktivitete kriminale ose në aktivitete të tjera të një grupi kriminal të organizuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar dënohet me burgim së paku pesë vjet.
- (3) Kushdo që organizon, formon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobën deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.
- (4) Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafi 2 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë nëse veprimtaria e grupit të organizuar rezulton me vdekje.
- (5) Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin i cili kryen veprë penale nga paragrafi 2 ose 3 i këtij neni nëse personi i tillë, para se grupi të kryejë veprën, e lajmëron policinë apo prokurorin publik në hollësi lidhur me ekzistimin, përbërjen dhe informacionet e grupit të organizuar për t'i mundësuar policisë arrestimin e grupit apo prokurorit publik ndjekjen e atij grupi.

(6) Kushdo që është dënuar me dënime plotësuese nga neni 57 i këtij Kodi për kryerjen e veprës penale nga ky nen dhe i shkel kushtet e atyre dënimeve plotësuese, dënohet me burgim deri në një vit.

(7) Sipas këtij neni,

- 1) Shprehja “krim i organizuar” do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare;
- 2) Shprehja “grup kriminal i organizuar” do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtëpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare;
- 3) Shprehja “krim i rëndë” do të thotë veprë penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet dhe
- 4) Shprehja “grup i strukturuar” do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë veprë penale dhe nuk do të thotë formalisht t’i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

Neni 275

NDJEKJA NË RASTIN KUR KRYERËSI ËSHTË NË MARRËDHËNIE FAMILJAREME VIKTIMËN

Nëse vepra penale nga neni 252, 253, 257(1), 258(1) ose (2), 260, 261, 269(1) ose 271 i këtij Kodi kryhet kundër personit me të cilin kryerësi ka lidhje familjare, procedura penale fillohet sipas propozimit.

KAPITULLI XXIV: VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE

Neni 276

NDOTJA OSE SHKATËRRIMI I MJEDISIT

- (1) Kushdo që duke e shkelur ligjin bën ndotjen ose degradimin e mjedisit apo shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore dhe me këtë shkakton rrezik për mjedisin dhe jetën a shëndetin e një numri të madh të njerëzve dënohet me burgim deri në dy vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me dëmtimin e shëndetit të një të numri të madh të njerëzve apo me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm apo me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike ose në masë kritike apo dëmtimin kritik të mjedisit, kryerësi për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim deri në pesë vjet, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni dënohet me burgim deri në dy vjet.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me dëmtim apo me shkatërrim të papërmirësueshëm të mjedisit ose me rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore, kryerësi për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë ose me gjobë dhe me burgim deri në tetë vjet, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Neni 277

MBAJTJA E PALIGJSHME E SUBSTANCAVE DHE E MBETURINAVE TË RREZIKSHME

- (1) Kushdo që duke shkelur ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit hedh, trajton, depoziton, transporton, eksporton ose importon substanca të rrezikshme a mbeturina që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose keqësimin thelbësor të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim prej një deri në tre vjet.
- (2) Kushdo që duke shkelur ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit hedh, trajton, depoziton, transporton, eksporton ose importon substanca apo mbeturina radioaktive që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose keqësimin thelbësor të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë dënohet me gjobë ose me gjobë dhe me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit për veprën penale nga paragrafin 1 ose me gjobë ose me burgim deri në dy vjet për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni.

(4) Nëse vepra nga ky nen rezulton me vdekjen ose lëndim të rëndë trupor të personit ose me dëmtim të pasurisë, kafshëve, bimëve apo me keqësimin e cilësisë së ajrit, tokës ose ujit, kryerësi për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 3 i këtij neni dënohet me burgim deri në tetë vjet.

Neni 278

VEPRIMI I PALIGJSHËM ME INSTALIMET E RREZIKSHME

(1) Kushdo që duke shkelur ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit, udhëheq ose drejton një fabrikë apo një stabiliment në të cilin kryhet aktivitet i rrezikshëm dhe i cili shkakton vdekjen ose lëndimin e rëndë të ndonjë personi ose dëmtimin thelbësor të cilësisë së ajrit, tokës, ujit apo shkakton dëmtim të kafshëve, bimëve ose pasurisë dënohet me gjobë ose me gjobë dhe me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Neni 279

PRODHIMI, SHITJA DHE VËNIA NË QARKULLIM E MATERIEVE TË DËMSHME PËR MJEKIMIN E SHTAZËVE

(1) Kushdo që prodhon me qëllim që t'i shesë apo t'i vë në qarkullim materiet për mjekimin apo për parandalimin e sëmundjeve të shtazëve apo shpendëve, kur materiet e tilla janë të dëmshme për jetën a për shëndetin e tyre dënohet me gjobë ose me gjobë dhe me burgim deri në një vit.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të shpendëve, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 280

DHËNIA E NDIHMËS VETERINARE NË MËNYRË TË PANDËRGJEGJSHME

(1) Veterinari apo ndihmësi i autorizuar i veterinarit i cili me rastin e dhënies së ndihmës veterinarë cakton ose aplikon haptas mjetin e papërshtatshëm apo mënyrën jo të rregullt të mjekimit ose në përgjithësi shkel rregullat e profesionit të veterinarisë gjatë procesit të mjekimit dhe me këtë shkakton sëmundjen, keqësimin e sëmundjes apo ngordhjen e shtazës dënohet me burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që nga pakujdesia kryen veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 281

MOSRESPEKTIMI E URDHRAVE PËR LUFTIMIN E SËMUNDJEVE TË SHTAZËVE DHE TË BIMËVE

- (1) Kushdo që gjatë kohës së ndonjë epidemie të kafshëve, e cila mund të rrezikojë blegtorinë, nuk respekton urdhrin apo vendimin e lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që gjatë periudhës së rrezikut ndaj botës bimore nga sëmundja ose murtaja nuk respekton urdhrin apo vendimin e organit kompetent me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes ose të murtajës në pajtim me ligjin dënohet me dënimin e paraparë nga pika 1 e këtij neni.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me dëm thelbësor, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.
- (4) Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Neni 282

NDOTJA E USHQIMIT DHE E UJIT TË SHTAZËVE

- (1) Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme e ndot ushqimin apo ujin e shtazëve në lumenj, në përroje, në burime, në puse, në cisterna apo në ndonjë ujë tjetër i cili shërben për t'i dhënë ujë bagëtisë, shpezëve apo egërsirave dhe me këtë e rrezikon jetën a shëndetin e shtazëve dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që me ndonjë materie të dëmshme e ndot ujin në hurdha peshqish, në liqene, lumenj dhe përroje dhe me këtë shkakton rrezik për ekzistencën e shtazëve në ujë dënohet me dënimin e paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me ngordhjen e një numri të madh të shtazëve apo të peshqve me vlerë që tejkalon 10.000 euro , kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Neni 283

SHKATËRRIMI I BOTËS BIMORE ME MJETE TË DËMSHME

Kushdo që me përdorimin e ndonjë materie të dëmshme shkakton shkatërrimin e bimëve, pemëve ose vegjetacionit tjetër dhe me këtë sjell dëm thelbësor dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 284

SHKRETËRIMI I PYJEVE

- (1) Kushdo që në kundërshtim me ligjin ose me urdhrin e organit kompetent bën prerjen ose shkatërrimin e pyllit ose kush pren trungjet a në ndonjë mënyrë tjetër shkretëron pyjet dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
- (2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyje të tjera me destinim të posaçëm dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Neni 285

VJEDHJA E PYLLIT

- (1) Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll, kurse sasia e drunjve të prerë tejkalon dy metra kub, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer me qëllim që drunjte e prerë të shiten apo nëse sasia e drunjëve të prerë është mbi pesë metra kub, ose nëse vepra penale është kryer në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur a në pyllin tjetër me destinim të posaçëm, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Tentativa e kryerjes së veprës nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet.

Neni 286

GJUETIA E KUNDËRLIGJSHME

- (1) Kushdo që gjuan ose mbyt një kafshë të egër ose e zë të gjallë pa leje ose ndonjë autorizim dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
- (2) Sipas rregullores së gjuetisë, nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer ndaj gjahut me vlerë që tejkalon 10.000 euro ose me rëndësi të konsiderueshme apo gjatë sezonit të mbyllur ose në grup, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
- (3) Kushdo që gjuan lloje të rrezikuara ose të rralla të gjahut, gjuetia e të cilit është e ndaluar, ose gjuan lloje të posaçme pa pasur lejen e veçantë për atë lloj gjahu apo gjuan me metodat e asgjësimit masiv apo me përdorimin e mjetit motorik apo të dritës së fortë dënohet me gjobë ose me burgim prej tre muaj deri në tri vjet.
- (4) Egërsirat e gjuajtura dhe pajimet e gjuetisë konfiskohen.

Neni 287

SHITJA OSE NXJERRJA JASHTË KOSOVËS E TROFEVE TË KAFSHËVE TË EGRA

- (1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme shet apo nxjerr jashtë Kosovës trofenë nga kafshët e egra dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
- (2) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme shet apo nxjerr jashtë Kosovës trofenë nga kafshët e egra të kryera me anë të veprës penale nga paragrafët 1 deri në 3 të nenit 286 të këtij Kodi dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.
- (3) Trofetë e kafshëve të egra konfiskohen.

Neni 288

PESHKIMI I KUNDËRLIGJSHËM

- (1) Kushdo që peshkon duke përdorur eksploziv, rrymë elektrike, helm ose mjete helmuese dhe me këtë shkakton ngordhjen e peshqve ose peshkon në mënyrë të dëmshme për shumimin e peshqve dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (2) Peshqit dhe pajimet e peshkimit konfiskohen.

Neni 289

DËMTIMI, SHKATËRRIMI DHE NXJERRJA E PAAUTORIZUAR E MONUMENTEVE OSE OBJEKTEVE TË MBROJTURA JASHTË KOSOVËS

- (1) Kushdo që dëmton ose shkatërron monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror dënohet me burgim deri në dy vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer ndaj monumentit ose objektit të mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror me vlerë të posaçme apo rezulton me dëmtimin e rëndë, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (3) Kushdo që pa autorizimin përkatës të organit kompetent dhe duke shkelur të drejtën ndërkombëtare nxjerrë jashtë Kosovës monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror dënohet me burgim deri në një vit.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni ka të bëjë me monumentin ose objektin e mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror me vlerë të posaçme, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (5) Sipas këtij neni “monument ose objekt i mbrojtur kulturor, historik, fetar, shkencor apo natyror” do të thotë objekt nderimi i një komuniteti fetar i cili ndodhet në pronën e caktuar për shërbime fetare, gur varri, monument publik, monument natyror, objekt artistik, shkencor apo artizanat icili ruhet në koleksione publike ose në ekspozita publike, objekt i cili shërben për ndonjë nevojë publike ose zbukuron rrugën publike, sheshin apo parkun, atraksionin natyror apo një lloj të rrezikuar të kafshës ose të bimëve.

Neni 290

PUNIMET E PAAUTORIZUARA DHE PËRVETËSIMI I MONUMENTEVE KULTURORE

(1) Kushdo që pa autorizimin përkatës të organit kompetent kryen punë të konzervimit, restaurimit apo punime hulumtuese në ndonjë monument kulturor ose, përkundër ndalimit ose joautorizimit të organit kompetent kryen gërmime a hulumtime arkeologjike dhe me këtë e shkatërron ose e dëmton rëndë monumentin kulturor apo karakteristikat e tij dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer ndaj monumentit kulturor me vlerë apo me rëndësi të posaçme ose rezulton me dëm të madh, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muavej deri në tri vjet.

(3) Kushdo që gjatë hulumtimeve arkeologjike apo të hulumtimeve të tjera përvetëson ose merr objektin e gërmuar a objektin e gjetur në ndonjë mënyrë tjetër i cili paraqet monument të kulturës dënohet me dënimin e paraparë nga paragrafi 2 i këtij neni.

KAPITULLI XXV: VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË

Neni 291

SHKAKTIMI I RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM

(1) Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë energji tjetër të çfarëdo lloji shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë e një rëndësie thelbore dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(2) Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili në kundërshtim me dispozitat për detyrat e punës së tij nuk i vendos pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, vërshimi, eksplozimi, helmimit ose për mbrojtjen nga gazrat helmuese apo nga rrezatimi jonizues, nga forcat mekanike, nga energjia elektrike ose nga ndonjë energji tjetër të çfarëdo lloji, apo këto pajisje nuk i mirëmban në gjendje të rregullt a nuk i vë në përdorim ose në përgjithësi nuk vepron sipas rregullave ose rregulloreve teknike mbi masat mbrojtëse dhe me këtë shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë me vlerë thelbësore dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer në vendin ku është grumbulluar numër i madh i njerëzve, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi apo me dëm material thelbësor, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet, e kur vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 4 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet, ndërsa kur vepra penale rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 292

ASGJËSIMI, DËMTIMI OSE HEQJA E INSTALIMEVE PUBLIKE

(1) Kushdo që asgjëson, dëmton, i heq pajisjet apo instalimet e përçuesve elektrik, të gazit, të ujit, të ngrohjes, të pajisjeve telekomunikuese, të pajisjeve të kanalizimit, të pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit ose të naftësjellësve, të kablllove nënujore, të pendave ose të pajisjeve të tjera të ngjashme duke shkaktuar çrregullime në furnizimin e popullsisë apo të ekonomisë dënohet me burgim deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet, e kur vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më tepër personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet, e kur vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 293

DËMTIMI, ASGJËSIMI DHE HEQJA E PAJISJEVE MBROJTËSE

(1) Kushdo që asgjëson a dëmton në minierë, në fabrika, në punëtori apo në ndonjë vend tjetër të punës, ose i heq pajisjet mbrojtëse dhe me këtë rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë me një vlerë të madhe dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(2) Personi përgjegjës në minierë, në fabrikë, në punëtori apo në ndonjë vend tjetër të punës, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e detyrimeve në vendin e punës, nuk i instalon pajisjet mbrojtëse apo nuk i mirëmban në gjendje të rregullt për punë apo në rast nevojë nuk i vë në përdorim a në përgjithësi nuk vepron sipas dispozitave apo rregullave teknike mbi masat mbrojtëse dhe në këtë mënyrë shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve ose për pasurinë me vlerë të madhe dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.

(4) Kur gjykata shqipton dënim me kusht për veprën penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni, ajo mund t'i vë kusht kryerësit që në afatin e caktuar t'i instalojë pajisjet mbrojtëse.

(5) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëmtim thelbor material, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet, ndërsa kur vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një ose të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

(6) Nëse vepra nga paragrafi 3 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëm të konsiderueshëm material, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet dhe nëse është shkaktuar vdekja e një ose e më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim nga një deri në tetë vjet.

Neni 294

PUNIMET NDËRTIMORE TË KUNDËRLIGJSHME

(1) Personi përgjegjës i cili me rastin e projektimit, mbikëqyrjes apo kryerjes së ndonjë ndërtimi apo të punëve të ndërtimit vepron kundër ligjit apo standardeve të përgjithshme profesionale të pranuar ose kundër kushteve të lejes për ndërtim dhe me këtë rrezikon jetën apo trupin e njerëzve ose të pasurisë me vlerë të madhe dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij ligji rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 295

TRANSPORTIMI I KUNDËRLIGJSHËM I LËNDËVE EKSPLOZIVE OSE TË NDEZSSHME

Kushdo që që në kundërshtim me ligjin mbi vënien në qarkullim dhe dërgimin e lëndëve eksplozive apo lehtë të ndezsshme shpërndan lëndë eksplozive ose lehtë të ndezsshme për t'u transportuar me mjetet e transportit publik ose vetë e bën transportimin e lëndëve të tilla, duke i shfrytëzuar mjetet e transportit publik, dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Neni 296

MOSEVITIMI I RREZIKUT

(1) Kushdo që nuk ndërmerr masa për evitimin e zjarrit, vërshimit, eksplozimit, fatkeqësisë në trafik apo të ndonjë rreziku tjetër për jetën ose sigurinë fizike të njerëzve apo të pasurisë me përmasa të mëdha, duke njoftuar me kohë autoritetet kompetente ose në

ndonjë mënyrë tjetër, edhe pse këtë ka mundur ta bëjë pa e rrezikuar veten apo ndonjë person tjetër dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që parandalon apo pengon në çfarëdo mënyre tjetër personin tjetër nga ndërmartja e masave për evitimin e zjarrit, vërshimit, eksplozimit, fatkeqësisë së trafikut apo të ndonjë rreziku tjetër për jetën apo për sigurinë fizike ose për pasurinë me përmasa të mëdha dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

KAPITULLI XXVI: VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK

Neni 297

RREZIKIMI I TRAFIKUT PUBLIK

(1) Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik dhe rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha dhe me këtë i shkakton lëndime të lehta trupore personit apo dëm thelbësor material që tejkalon vlerën mbi 1.000 euro dënohet me gjobë apo me burgim deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që rrezikon trafikun hekurudhor, uJOR, me tramvaje, me trolejbus, me autobus ose me teleferik dhe në këtë mënyrë rrezikon jetën ose sigurinë fizike a pasurinë me përmasa të mëdha dënohet me burgim deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të personit apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me të paktën një vit burgim.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 298

RREZIKIMI I TRAFIKUT PUBLIK PËR SHKAK TË DEHJES

(1) Personi i cili e drejton automjetin nën ndikim të alkoolit apo të mjeteve të tjera dehëse dhe si rezultat i kësaj është e qartë se është i paafët për vozitje të sigurt, sepse në këtë mënyrë e rrezikon trafikun publik, jetën e njeriut, sigurinë fizike apo pasurinë me përmasa të mëdha dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në një vit.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet,

e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim së paku një vit.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 299

RREZIKIMI I TRAFIKUT PUBLIK ME VEPRIM APO ME MJETE TË RREZIKSHME

(1) Kushdo që asgjëson, heq ose dëmton rëndë instalimet, pajisjet, shenjat apo sinjalizimet që shërbejnë për sigurinë e trafikut, jep shenja ose sinjale të gabueshme, vë pengesa në rrugët publike apo në ndonjë mënyrë tjetër e rrezikon trafikun dhe kështu vë në rrezik jetën e njeriut, sigurinë fizike apo pasurinë në përmasa të mëdha dënohet me burgim deri në tri vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në një vit.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm material thelbor, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet dhe nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me së paku një vit burgim.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 300

MBIKËQYRJA E PANDËRGJEGJSHME E TRAFIKUT PUBLIK

(1) Personit përgjegjës, të cilit i është besuar mbikëqyrja e gjendjes dhe e mirëmbajtjes së rrugëve dhe e objekteve në to, e mjeteve të transportit, plotësimi i kushteve të përcaktuara të punës për shoferë, ose personi përgjegjës të cilit i është besuar menaxhimi i vozitjes, i cili me ushtrimin e pandërgjegjshëm të detyrës së vet rrezikon jetën e njeriut, sigurinë fizike ose pasurinë në përmasa të mëdha dënohet me burgim deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që është person përgjegjës për dhënien e urdhërave apo që lejon vozitjen edhe pse e di se shoferi për shkak të lodhjes, sëmundjes, ndikimit të alkoolit apo të shkaqeve të tjera nuk është në gjendje që në mënyrë të sigurt të drejtojë automjetin, ose automjeti nuk është në gjendje të rregullt dhe me këtë rrezikon jetën e njeriut, sigurinë fizike ose pasurinë me përmasa të mëdha dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer nga pakujdesia, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.

(4) Nëse vepra nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me të paktën një vit burgim.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 301

MOSDHËNIA E NDIHMËS PERSONIT TË LËNDUAR NË FATKEQËSITË E TRAFIKUT PUBLIK

(1) Shoferi i automjetit ose i mjetit tjetër të transportit që nuk i ofron ndihmë personit të lënduar me atë mjet të transportit ose lëndimin e të cilit e ka shkaktuar shoferi dënohet me burgim deri në një vit.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor apo me vdekjen e personit, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

Neni 302

KEQPËRDORIMI I SINJALEVE TË TELEKOMUNIKACIONIT

Personi i cili me keqdashje ose pa qenë e nevojshme dërgon sinjalin e shfrytëzuar ndërkombëtarisht të fatkeqësisë apo sinjalin e rrezikut, ose përmes sinjalit të telekomunikimit mashtron popullatën se nuk ka rrezik ose keqpërdor sinjalin e pranuar ndërkombëtarisht dënohet me burgim prej tre muajve deri në tre vjet.

KAPITULLI XXVII: VEPRA TË PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË

Neni 303

MOSLAJMËRIMI I PËRGATITJES SË VEPRAVE PENALE

(1) Kushdo që, duke qenë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së një veprë penale, e cila dënohet me së paku pesë vjet burgim nuk e lajmëron këtë fakt në kohën kur kryerja e veprës penale ende ka mund të evitohet, ndërsa vepra penale është kryer ose është tentuar që të kryhet dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që nuk lajmëron përgatitjet për kryerjen e veprës penale, e cila dënohet me burgim afatgjatë dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(3) Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse ai është në lidhje me kryerësin e veprës penale si bashkëshort, partner jashtëmartesor, i afërmë i gjakut i shkallës së parë, vëlla ose motër, prind adoptues ose fëmijë i adoptuar, bashkëshortë ose partner me të cilin bashkëjeton.

Neni 304

MOSLAJMËRIMI I VEPRAVE PENALE APO MOSLAJMËRIMI I KRYERËSIT TË SAJ

- (1) Kushdo që duke qenë në dijeni për identitetin e kryerësit të veprës penale ose për kryerjen e veprës së tillë penale, e cila dënohet me burgim afatgjatë, nuk lajmëron faktin e tillë edhe pse zbulimi i kryerësit të veprës penale varet nga ky lajmërim dënohet me burgim deri në tre vjet.
- (2) Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili nuk e lajmëron veprën penale të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij nëse vepra e tillë është e dënueshme me së paku tre vjet burgim dhe ndiqet sipas detyrës zyrtare.
- (3) Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është në marrëdhënie me kryerësin e veprës penale si bashkëshort, partner jashtëmartesor, i afërm i gjakut i shkallës së parë, vëlla ose motër, prind adoptues ose fëmijë i adoptuar, bashkëshortë ose partner me të cilin bashkëjetohej.

Neni 305

DHËNIA E NDIHMËS KRYERËSVE PAS KRYERJES SË VEPRAVE PENALE

- (1) Kushdo që strehon kryerësin e veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit të veprës përmes fshehjes së mjeteve, provave a në çfarëdo mënyre tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmer veprime për pengimin e ekzekutimit të dënimit a urdhrin për trajtim të detyrueshëm dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që ndihmon kryerësin e veprës penale për të cilën është paraparë dënim me burgim mbi pesë vjet dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Kushdo që ndihmon kryerësin e veprës penale të dënueshme me burgim afatgjatë dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (4) Dënimi për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë më i rëndë as sipas llojit e as sipas lartësisë së dënimit i përcaktuar për vepër penale të kryer nga personi të cilit i jepet ndihma.
- (5) Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas këtij neni nëse ai është në marrëdhënie me kryerësin e veprës penale si bashkëshort, partner jashtëmartesor, i afërm i gjakut i shkallës së parë, vëlla ose motër, prind adoptues ose fëmijë i adoptuar, bashkëshortë ose partner me të cilin bashkëjetohej.

Neni 306

LAJMËRIMET E RREJSHME

- (1) Kushdo që lajmëron se një person i caktuar ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, duke qenë në dijeni se ai person nuk është kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(2) Kushdo që vë prova të rrejshme për veprën penale ose në çfarëdo mënyre tjetër shkakton fillimin e procedurës penale për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare kundër personit për të cilin ai e di se nuk e ka kryer veprën penale dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Kushdo që lajmëron veten se ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse nuk e ka kryer veprën e tillë, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre muaj.

(4) Kushdo që lajmëron se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse ai e di se ajo vepër nuk është kryer, dënohet me dënimin nga paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 307

DEKLARIMET E RREJSHME

(1) Dëshmitari, eksperti në cilësi të dëshmitarit, përkthyesi apo interpreti i cili në procedurën gjyqësore, në procedurën për kundërvajtje, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore jep deklaratë të rreme dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Nëse deklarata e rreme merret si bazë për vendimin përfundimtar në procedurë, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me pasoja të rënda për personin e akuzuar, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(4) Nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni vullnetarisht e tërheq deklaratën e tij para marrjes së vendimit përfundimtar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 308

DEKLARATAT E RREME TË DËSHMITARËVE BASHKËPUNUES

(1) Dëshmitari bashkëpunues, i cili jep dëshmi të rreme në cilëndo pjesë relevante ose i cili qëllimisht nuk ia tregon tërë të vërtetën prokurorit publik, policisë, gjyqtarit të procedurës paraprake ose gjykatës gjatë marrjes në pyetje ose gjatë shqyrtimit gjyqësor dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni, e pastaj e tërheq dëshminë dhe dëshmon të vërtetën para përfundimit të dëshmisë së tij, dënohet me gjobë deri në 500 euro ose me gjobë dhe me burgim deri në tre muaj, por gjykata mund ta lirojë nga dënimi nëse ekzistojnë rrethana lehtësuese.

Neni 309

PENGIMI I TË PROVUARIT

(1) Kushdo që nxit dëshmitarin apo ekspertin që të jepë deklaratë të rrejshme me dhunë, me kanosje për përdorimin e dhunës ose në formë tjetër detyrimi duke i premtuar dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër në procedurën gjyqësore, kundravajtëse apo administrative ose në procedurën pranë noterit publik apo në procedurën disiplinore dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që me qëllim të parandalimit ose vështirësimit të mbledhjes së provave në procedurën gjyqësore, në procedurën kundërvajtëse, në procedurën administrative, në procedurën para noterit publik ose në procedurën disiplinore fsheh, asgjëson, dëmton ose bën të papërdorueshme, në tërësi ose pjesërisht, pronën e personit tjetër ose dokumentet që mund të përdoren si prova dënohet me gjobë ose burgim deri në tri vjet.

(3) Kushdo që me qëllim të parandalimit ose vështirësimit të mbledhjes së dëshmive në procedurën gjyqësore ose administrative largon, zhvendos ose ndërron vendin e shenjave të kufijve administrativë, shenjën e tokës ose çfarëdo shenje tjetër që shenjon pronësinë a pasurinë e paluajtshme ose të drejtën për shfrytëzimin e ujit, ose për të njëjtin qëllim vendos shenja të tilla me qëllim të mashtrimit dënohet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 310

FRIKËSIMI GJATË PROCEDURËS PENALE PËR KRIMIN E ORGANIZUAR

Kushdo që përdor dhunë, kërcënim për përdorimin e dhunës ose ndonjë mënyrë tjetër të detytrimit duke i premtuar dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rrejshme, ose të mos jep informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit publik apo gjyqtarit, kur informacionet e tilla ndërliken me kryerjen e krimit të organizuar nga neni 274 dënohet me gjobë deri në 125.000 euro dhe burgim prej katër deri në shtatë vjet.

Neni 311

SHKELJA E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS

Kushdo që pa autorizim tregon informata për të cilat është njoftuar në procedurën gjyqësore, në procedurën kundravajtëse, administrative ose në procedurën parlamentare hetimore të Kuvendit të Kosovës, që, sipas ligjit, nuk duhet zbuluar apo ato me vendim të gjykatës a të organit kompetent janë shpallur si fshehtësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Neni 312

REBELIMI I PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA

(1) Kushdo që nga institucioni ku gjendet në paraburgim në bazë të vendimit të ligjshëm mbi privimin nga liria organizon rebelimin e personave të privuar nga liria, me qëllim që të lirohen me dhunë ose së bashku të sulmojnë personat zyrtarë në atë institucion apo me dhunë ose kanosje serioze se do të përdorin dhunë me qëllim që t'i detyrojnë personat e tillë zyrtarë të veprojnë apo të mos veprojnë në kundërshtim me detyrën e tyre dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tri vjet.

- (2) Pjesëmarrësi në rebelim nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim prej tre muajve deri në një vit.
- (3) Nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni heq dorë vullnetarisht nga rebelimi para se të ketë ushtruar dhunën apo kanosjen serioze, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.
- (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer me përdorimin e dhunës, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 313

ARRATISJA E PERSONIT TË PRIVUAR NGA LIRIA

Kushdo që duke përdorur dhunën apo kanosjen se menjëherë do ta sulmojë jetën a trupin e ndonjë personi, arratiset nga institucioni ndëshkues apo qendra e paraburgimit dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

Neni 314

MUNDËSIMI I ARRATISJES SË PERSONIT TË PRIVUAR NGA LIRIA

- (1) Kushdo që duke përdorur dhunën, kanosjen për përdorimin e dhunës, mashtrimin apo në çfarëdo mënyre tjetër mundëson arratisjen e personit i cili në bazë të ligjit është privuar nga liria dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.
- (2) Nëse veprën nga paragrafi 1 i këtij neni e kryejnë së bashku më shumë se një person, ata dënohen me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 315

MUNDËSIMI I KUNDËRLIGJSHËM I USHTRIMIT TË PROFESIONIT, AKTIVITETIT OSE DETYRËS

Kushdo që i mundëson ndonjë personi ushtrimin e profesionit, aktivitetin ose detyrën edhe pse është në dijeni se me aktgjykim të plotëfuqishëm i është shqiptuar dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të profesionit, aktivitetit apo detyrës së tillë dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

KAPITULLI XXVIII: VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK DHE VEPRIMEVE JURIDIKE

Neni 316

PENGIMI I PERSONIT ZYRTAR NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE

- (1) Kushdo që me dhunë apo me kanosje për përdorim të atqasshëm të dhunës, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushëveprimtarinë e kompetencave të tij ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyra zyrtare, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin fyerjen ose keqpërdorimin e personit zyrtar apo kanosjen për përdorimin e armës ose rezulton me lëndim të lehtë trupor, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tri vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik, të sigurisë së Kosovës apo të ruajtjes së rendit publik, burgosjes së kryerësit të veprës penale apo të ruajtjes së personit të privuar nga liria, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.
- (4) Tentativa për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni dënohet.
- (5) Nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1 deri te paragrafi 3 i këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo brutal i personit zyrtar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 317

SULMI NDAJ PERSONIT ZYRTAR GJATË KRYERJES SË DETYRAVE ZYRTARE

- (1) Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar ose personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare të sigurimit publik, të sigurisë së Kosovës apo të ruajtjes së rendit publik dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo të ndihmësit të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të personit zyrtar ose të ndihmësit të tij, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (4) Nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni është provokuar nga veprimi i kundërligjshëm apo brutal i personit zyrtar ose i ndihmësit të tij, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Neni 318

PJESËMARRJA NË GRUPIN QË PENGON PERSONAT ZYRTAR NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE

(1) Kushdo që merr pjesë në grupin e njerëzve që me veprim të përbashkët pengon apo tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose në mënyrë të ngjashme e detyron të ekzekutojë detyra zyrtare dënohet për pjesëmarrje me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

(2) Udhëheqësi i grupit që kryen veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Neni 319

THIRRJA PËR REZISTENCË

Kushdo që nxit të tjerët me përdorim të dhunës ose me kanosjes serioze për të ndaluar ekzekutimin e vendimeve apo masave të ligjshme të lëshuara nga organi kompetent apo zyrtarët gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dënohet me jo më shumë se tri vjet burgim.

Neni 320

PJESËMARRJA NË GRUP QË KRYEN VEPËR PENALE

(1) Kushdo që merr pjesë në një turmë të mbledhur, e cila me veprime kolektive e privon personin nga jeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, dëmton pasurinë në përmasa të mëdha ose kryen vepra të tjera të shkeljeve të rënda apo tenton të kryejë vepra të tilla dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(2) Organizuesi i turmës të cekur në paragrafin 1 të këtij neni dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 321

MOSPJESËMARRJA NË MËNJANIMIN E RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM

Kushdo që në kundërshtim me urdhrat e organit kompetent refuzon pa arsye të marrë pjesë në mënjanimin e rrezikut për jetën e njerëzve apo të pasurisë me përmasa të mëdha dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Neni 322

HEQJA APO DËMTIMI I VULAVE ZYRTARE OSE I SHENJAVE

(1) Kushdo që heq ose dëmtom vulën zyrtare a shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ose të lokaleve, apo kushdo që hap objektet e siguruara ose hyn në lokalet e tilla pa e hequr ose pa e dëmtuar vulën apo shenjën, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(2) Tentativa për vepër penale nga paragrafi 1 dënohet.

Neni 323

MARRJA APO ASGJËSIMI I VULAVE ZYRTARE OSE I SHKRESAVE ZYRTARE

Kushdo që merr, fsheh, asgjëson, dëmton apo në çfarëdo mënyre tjetër të kundërligjshme e bën të papërdorshme vulën zyrtare, regjistrin, shkresat apo dokumentet që i përkasin ose janë prone e organit publik a personit tjetër juridik i cili ushtron autorizimet publike dënohet me gjobë apo me burgim deri tre vjet.

Neni 324

ASGJËSIMI APO FSHEHJA E MATERIALIT ARKIVOR

Kushdo që asgjëson, fsheh, bën të papërdorshme materialet arkivore apo nxjerr materialet e tilla jashtë Kosovës pa lejen paraprake të organit kompetent dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Neni 325

PREZENTIMI I RREMË

(1) Kushdo që me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin ose me qëllim për t'i shkaktuar dëm personit tjetër prezantohet rrejshëm si person zyrtar apo ushtarak apo mban pa autorizim shenja të personit zyrtar ose ushtarak dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

(2) Kushdo që ndërmerr veprime të cilat janë të autorizuar t'i ndërmarrin vetëm peronat e caktuar zyrtarë ose ushtarakë, dënohet sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 326

USHTRIMI ARBITRAR I TË DREJTAVE

(1) Kushdo që ushtron në mënyrë arbitrare të drejtat të cilat personi mendon se i takojnë në vend se t'i drejtohet organit kompetent dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

(2) Kushdo që me anë të përdorimit të dhunës apo kanosjen për përdorim të dhunës ushtron një të drejtë të cilën personi mendon se i takon në vend se t'i drejtohet organit kompetent dënohet me burgim deri në dy vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtar i grupit, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tri vjet.

(4) Procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni fillohet me padi private, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni procedura penale fillohet sipas propozim.

Neni 327

FURNIZIMI, TRANSPORTI, PRODHIMI, KËMBIMI OSE SHITJA E PAAUTORIZUAR E ARMËVE

- (1) Kushdo që furnizon, transporton, prodhon, këmben ose shet armë pa autorizim dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni përfshin sasi të madhe armësh, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (3) Armët konfiskohen.

Neni 328

MBAJTJA NË PRONËSI, NË KONTROLL, NË POSEDIM OSE NË SHFRYTËZIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE

- (1) Kushdo që përdor apo vringëllon armët me frikësim, kërcënim ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar apo urdhëron personin tjetër të veprojë në mënyrë të njëjtë dënohet me gjobë deri në 10,000 euro ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (2) Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni përfshin një sasi të madhe armësh, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.
- (4) Kushdo që nuk e njofton Policinë e UNMIK-ut për çfarëdo ndryshimi të pronësisë, posedimit ose kontrollit të armës së autorizuar dënohet me gjobë deri në 7,500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet.
- (5) Armët e paautorizuara ose armët e autorizuara që përdoren apo mbahen në kundërshtim me rrethanat dhe kushtet e lejes për mbajtjen e autorizuar të armëve konfiskohen.

Neni 329

MOSRESPEKTIMI I KUSHTEVE TË LEJES PËR MBAJTJEN E AUTORIZUAR TË ARMËVE

- (1) Kushdo që jep informata të rreme gojarisht apo në formë të shkruar në cilëndo fazë të procedurës së aplikimit për lejen e mbajtjes së autorizuar të armëve, prodhon, posedon, shet ose blen leje falso për mbajtjen e autorizuar të armëve dënohet me gjobë deri në 5.000 euro ose burgim deri në tri vjet.
- (2) Nëse poseduesi i lejes për mbajtjen e autorizuar të armëve nuk ia tregon lejen menjëherë policisë ose KFOR-it me rastin e kërkimit ose, nëse ajo nuk është në posedim të tij, nuk e informon policinë për vendndodhjen e saj dënohet me gjobë deri në 2,500 euro ose me burgim deri në tre muaj.

(3) Nëse poseduesi i lejes për mbajtjen e autorizuar të armëve nuk e njofton Policinë e UNMIK-ut për ndryshimin e vendbanimit, që duhet lajmëruar brenda 15 ditëve nga ndryshimi i tillë, dënohet me gjobë deri në 2,500 euro ose me burgim deri në tre muaj.

Neni 330

PRODHIMI DHE FURNIZIMI I ARMËVE DHE I INSTRUMENTEVE TË PROJEKTUARA PËR KRYERJEN E VEPRAVE PENALE

(1) Kushdo që prodhon, furnizon ose i mundëson tjetrit të të sigurojë armë ose helme a pajisje të nevojshme për prodhimin e tyre, duke qenë në dijeni se ato destinohen për kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

(2) Kushdo që prodhon, furnizon ose i mundëson tjetrit të sigurojë çelës të falsifikuar, kallauz ose instrument tjetër për t'u përdorur për vjedhjen me thyerje, duke qenë në dijeni se është destinuar për kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim deri në një vit.

Neni 331

KEQPËRDORIMI I SHENJAVE TË RREZIKUT DHE TË FATKEQËSIVE

Kushdo që i keqpërdor shenjat e rrezikut apo të fatkeqësive ose bën thirrje të pabazuar për ndihmë nga personat zyrtarë ose zjarrëfikësit me qëllim të angazhimit të tyre në aksion dënohet me gjobë apo me burgim deri në gjashtë muaj.

Neni 332

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

(1) Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin original me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si original ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si orgjinal dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit.

(2) Tentativa për veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistri tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Neni 333

RASTET E POSAÇME TË FALSIFIKIMIT TË DOKUMENTEVE

Personi do të konsiderohet se ka kryer veprë penale të falsifikimit të dokumenteve dhe do të dënohet me dënimin nga paragrafi 3 i nenit 332 nëse:

- 1) Pa autorizim plotëson ndonjë letër, formular të zbrazët ose ndonjë send tjetër në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër dhe plotëson deklaratën përmes së cilës krijon marrëdhënie juridike;

- 2) Mashtron personin tjetër lidhur me përmbajtjen e ndonjë dokumenti dhe e vë nënshkrimin e vet në këtë dokument, duke menduar se nënshkruan ndonjë dokument tjetër ose dokument me ndonjë përmbajtje tjetër;
- 3) Lëshon dokumentin në emër të ndonjë personi tjetër pa autorizimin e tij ose në emër të personit që nuk ekziston;
- 4) Lëshon një dokument dhe pohon me nënshkrimin e vet se ka ndonjë pozitë, thirrje apo gradë edhe pse nuk ka pozitë, thirrje apo gradë të tillë, ndërsa kjo ka ndikim thelbor për vlerën e dokumentit ose
- 5) Lëshon një dokument duke përdorur vulën apo shenjën e vërtetë pa autorizim paraprak.

Neni 334

LEGALIZIMI I PËRMBAJTJES SË PAVËRTETË

- (1) Kushdo që e vë në lajthim organin kompetent për të vërtetuar një çështje të pavërtetë, e paraparë të shërbejë si provë në një çështje ligjore në një dokument publik, në një regjistër ose libër dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.
- (2) Kushdo që përdor dokumentin, regjistrin ose librin e tillë, që e din se është i rremë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 335

DHËNIA DHE PËRDORIMI I CERTIFIKATËS SË RREME TË MJEKUT APO TË VETERINARIT

- (1) Mjeku i cili lëshon certifikatë të rreme mjekësore ose veterinarë i cili lëshon certifikatë të rreme veterinarë, ndonëse ai e di se ajo është e rreme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
- (2) Kushdo që përdor certifikatë të rreme mjekësore ose veterinarë, ndonëse e di se është e rreme, dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 336

DHËNIA E KUNDËRLIGJSHME E NDIHMËS JURIDIKE

- (1) Kushdo që jep ndihmë juridike pa autorizim ose pa kualifikim profesional të paraparë me ligjin për shpërblim dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni duke pohuar se posedon kualifikimin profesional dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet.

Neni 337

PENGIMI I CEREMONIVE FETARE

- (1) Kushdo që me qëllim dhe pa bazë ligjore pengon ose ndalon kryerjen e ceremonive fetare dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që kryen veprë penale nga paragrafi 1 i këtij neni me përdorimin e dhunës apo kanosjen serioze për përdorimin e dhunës dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Neni 338

DËMTIMI I VARREVE APO I KUFOMAVE

- (1) Kushdo që gërmon, rrënon, dëmton ose përdhos pa autorizim varrin apo ndonjë vendvarrim dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (2) Kushdo që nxjerr nga varri, zhvendos, dëmton, shkatërron ose fsheh kufomën, një pjesë të saj ose hirin e të vdekurit dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

KAPITULLI XXIX: VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE

Neni 339

SHPËRDORIM I POZITËS ZYRTARE OSE I AUTORIZIMIT

- (1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkaktimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëm i cili tejkalon shumën 2.500 euro apo me shkelje të rëndë të të drejtave të personit tjetër, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

Neni 340

PËRVETËSIMI GJATË USHTRIMIT TË DETYRËS

- (1) Personi zyrtar që përvetëson para, letra me vlerë ose pasuri tjetër të luajtshme që i është besuar personit në bazë të detyrës së tij ose pozitës brenda një organi publik ose personi juridik me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që e tejkalon shumën 2.500 euro, kryerësi dënohet me burgim një deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumë 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 341

MASHTRIMI NË DETYRË

(1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër bën prezentimin e rremë të raportit të llogarive apo i cili në mënyrë tjetër e vë në lajthim personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumë 2,500 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 342

PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I PASURISË

Kushdo që pa autorizim përdor paratë, letrat me vlerë ose pasurinë tjetër të luajtshme të besuar personit në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo të cilat i janë vënë në disponim nga shërbimi, puna apo kushdo që jep pasurinë e këtillë për shfrytëzim të paautorizuar dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.

Neni 343

MARRJA E RRYSHFETIT

(1) Personi zyrtar i cili kërkon ose merr dhuratë a përfitim tjetër për vete ose personin tjetër ose që pranon premtimin për dhuratë ose për ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë ose të mos e kryej një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai duhet ose ka mundur ta kryejë dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(2) Personi zyrtar i cili kërkon ose pranon dhuratë ose përfitim tjetër për vete ose për personin tjetër apo që pranon premtimin për dhuratë ose në ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai është dashur ta kryejë ose të mos e kryejë një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

(3) Personi zyrtar i cili pas kryerjes ose moskryerjes së një veprimi nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni kërkon apo pranon dhurata ose ndonjë përfitim për vete apo për personin tjetër në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e tillë dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

(4) Dhurata apo përfitimi tjetër që është marrë konfiskohen.

Neni 344

DHËNIA E RRYSHFETIT

- (1) Kushdo që i jep ose premtion se do t'i jep dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, që ai person të kryejë një veprim zyrtar apo veprim tjetër në kuadër të kompetencave të tij zyrtare, të cilin veprim ai nuk është dashur ta kryejë ose nuk e kryen një veprim zyrtar a veprim tjetër të cilin ai është dashur ta kryejë, ose kushdo që shërben si ndërmjetësues për t'ia dhënë rryshfetin personit zyrtar, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Kushdo që jep ose premtion se do t'i jep dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, që ai person të kryejë një veprim zyrtar apo veprim tjetër në kuadër të kompetencave të tij zyrtare, të cilin veprim ai është dashur ta kryejë, ose të mos e kryejë një veprim zyrtar ose tjetër të cilin ai duhet ta kryejë, ose kushdo që shërben si ndërmjetësues për t'ia dhënë rryshfet personit zyrtar dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit.
- (3) Nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni e ka dhënë rryshfetin me kërkesën e personit zyrtar dhe ka njoftuar për veprën e kryer para se ajo të jetë zbuluar ose para se të ketë kuptuar se vepra është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.
- (4) Dhurata ose dobia tjetër konfiskohen ose i kthehen personit i cili e ka dhënë ate në rastin e veprës nga paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 345

USHTRIMI I NDIKIMIT

- (1) Kushdo që kërkon, merr ose pranon një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të paduhur nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e një personi personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
- (2) Kushdo që premtion, ofron ose i jep në mënyrë direkte apo indirekte çfarëdo përparësie të padrejtë personit tjetër i cili ushtron ose konfirmon se ai është në gjendje të ushtrorë një ndikim të paduhur mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Neni 346

NXJERRJA E KUNDËRLIGJSHME E VENDIMEVE GJYQËSORE

Gjykatësi, gjykatësi laik ose gjykatësi për kundërvajtje i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër ose për t'ia shkaktuar dëm personit tjetër nxjerr vendim të kundërligjshëm dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Neni 347

ZBULIMI I FSHEHTËSIVE ZYRTARE

- (1) Personi zyrtar i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informacionin i cili përbën një fshehtësi zyrtare ose siguron informacionin e tillë me qëllim të përcjelljes te një personi i paautorizuar dënohet me burgim deri në tri vjet.
- (2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer për përfitim personal ose me qëllim të publikimit a shfrytëzimit të informacionit jashtë Kosovës, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.
- (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- (4) Dispozitat nga paragrafet 1 deri te paragrafi 3 i këtij neni zbatohen ndaj personit i cili e ka zbuluar sekretin zyrtar edhe pasi që statusi i tij zyrtar ka pushuar.
- (5) Sipas këtij neni shprehja “fshehtësi zyrtare” do të thotë informata ose dokumente të shpallura me ligj, dispozita të tjera ose me vendim të organit kompetent të nxjerra në bazë të ligjit e që konsiderohen fshehtësi zyrtare, zbulimi i të cilave ka shkaktuar ose mund të shkaktojë pasoja të dëmshme.

Neni 348

FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE ZYRTARE

- (1) Personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili në dokumentin zyrtar ose afarist, në regjistrin zyrtar ose në shkresë shënon informacion të rremë ose nuk shënon informacionin thelbër apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar a afarist, vërteton regjistrin zyrtar ose shkresën e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.
- (2) Personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili shfrytëzon dokumentin e rremë zyrtar apo afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën sikur të ishin të vërteta në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh, dëmton apo në çfarëdo mënyrë tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar ose afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 349

ARKËTIMI DHE PAGESA E PALIGJSHME

Personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili arkëton nga tjetri diçka që personi i tillë nuk është i detyruar të paguajë ose arkëton më shumë se sa personi i tillë është i detyruar të paguajë apo që gjatë pagesës ose dërgesës, paguan ose dërgon më pak se sa është dashur dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Neni 350

LIRIMI I KUNDËRLIGJSHËM I PERSONIT TË PRIVUAR NGA LIRIA

Personi zyrtar i cili në mënyrë të kundërligjshme e liron personin e privuar nga liria dhe i cili i është besuar ose e ndihmon arratisjen e tij apo i mundëson një lidhje të kundërligjshme o korrespondencë, qëllimi i së cilës është përgatitja e arratisjes dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet.

Neni 351

PËRVETËSIMI I KUNDËRLIGJSHËM I PASURISË ME RASTIN E BASTISJES APO EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR

Personi zyrtar i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit ose gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

KAPITULLI XXX: DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 352

Veprat penale në lidhje me pasurinë në pronësi shoqërore duhet të parashihen veçan me ligj.

Neni 353

Të gjitha sanksionet penale për veprat të cilat edhe me këtë Kod janë të ndëshkueshme dhe të shqiptuara me aktgjykim të formës së prerë para hyrjes në fuqi të këtij Kodi vazhdojnë me kohëzgjatje dhe lartësi të njëjtë.

Neni 354

(1) Dispozitat në Rregulloret e UNMIK-ut që mbulojnë çështjet e trajtuara në këtë Kod pushojnë të jenë në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi pos nëse shprehimisht nuk është paraparë ndryshe me këtë Kod ose në Rregullore të UNMIK-ut.

(2) Dispozitat e Kodeve Penale në fuqi pushojnë të kenë fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi.

Neni 355

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë Urdhëresa Administrative për zbatimin e këtij Kodi.

Neni 356

Verzionet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe janë njësoj autentike. Në rast konflikti, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Neni 357

Ky Kod hyn në fuqi më 6 prill 2004.